4

MATEMATIKA PËR KLASËN E KATËRT

Tatjana Atanasova- Paçemska
Valdeta Alija
Violeta Popovska
Dobri Jovevski

(Botimi II)

Matematika për klasën e katërt

Botues
Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë së Veriut
rr. “Sh. Kirili dhe Metodij” nr.54, 1000 Shkup

Autorë
Tatjana Atanasova- Paçemska
Valdeta Alija
Violeta Popovska
Dobri Jovevski

Recesentë
Mazhanna Severis Kuzmanovska
Irina Petkovska Kërsteva
Vanço Petrushevski

Ilustrese
Anastasija Dimitrova

Përkthimi nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe
Dalibor Sandev

Lektore
Arbresha Klokoci

Redaksia profesionale
Mersim Fejza

Redaktues
Dalibor Sandev

Rregullimi grafik dhe teknik
Leon Xhingo, Elena Stefanovska – ARS STUDIO

Shtyp
Evropa 92 – Koçan

Tirazhi: 6.808

Vendi dhe viti i botimit: Shkup, 2023
Me vendim për miratimin e librit mësimor në lëndën Matematika e klasës së 4-të, me nr.26-527/1 të datës 18.08.2022, të miratuar nga Komisioni Nacional i Librave Shkollorë

Titulli i origjinalit:
Математика за четврто одделение
Татјана Атанасова-Пачемска
Валдета Алија
Виолета Поповска
Добри Јовевски

Të nderuar lexues, nxënës, mësues dhe prindër,
Mirësevini në faqet e materialeve mësimore për lëndën e Matematikës së klasës së IV.
Përmes temave do t'ju udhëheqin aktivitetet kërkimore-zbuluese për zgjidhjen e detyrave problemore nga jeta e përditshme. Këto detyra do të nxisin kuriozitetin sa i përket të menduarit, diskutimit dhe prezantimit të zgjidhjeve.
Njohuritë matematikore që do të përfitohen, do të kontribuojnë për t'u pasuruar me koncepte matematikore, arritje më të larta dhe të menduarit logjik.

Si do të mësohet

MATEMATIKA

Matja

Vlerëso, mat, përdor njohuritë paraprake dhe zgjidh situatat problemore nga jeta e përditshme.

Gjeometria

Vizato një poligon (shumëkëndësh) me 5 kënde të njëjta.
Dizajno sheshin e lojërave në oborrin e shkollës.

Puna me të dhënat

Hulumto, merr pjesë në projektet e nxënësve, bashkëpuno me bashkënxënësit dhe mësuesin, prezanto të dhënat.

Operacione me numra

Analizo detyrën, mendo, krijo shprehje numerike dhe gjeje zgjidhjen.

Numrat dhe numërimi

Zbulo rregullën e krijimit të vargjeve.

PËRMBAJTJA

1 NUMRAT DHE NUMËRIMI

NUMRA DERI NË 1000 11
NUMËROJMË NGA 1000 DERI NË 10000 NGA E PARA DHE NGA PRAPA 16
FORMIMI, SHKRIMI DHE LEXIMI I NUMRAVE DERI NË 10000 20
VENDVLERA E NUMRAVE DHE ZBËRTHIMI I TYRE 25
PARAQITJA E NUMRIT TRESHIFROR DHE KATËRSHIFROR NË BOSHTIN NUMERIK 30
VARGU I NUMRAVE 35
RRUMBULLAKIMI I NUMRAVE TRESHIFRORË NË DHJETËSHEN MË TË AFËRT 38
RRUMBULLAKIMI i NUMRAVE KATËRSHIFRORË NË QINDËSHEN MË TË AFËRT 42
KRAHASIMI I ÇIFTEVE TË NUMRAVE TRESHIFRORË 45
KRAHASIMI I ÇIFTEVE TË NUMRAVE KATËRSHIFRORË 48
KRAHASIMI I ÇIFTEVE TË NUMRAVE TRESHIFRORË DHE KATËRSHIFRORË 51
RENDITJA E NUMRAVE DERI NË 10000 SIPAS MADHËSISË ME SHENJAT < = > 54
RENDITJA E NUMRAVE DERI NË 10000 SIPAS MADHËSISË 56
KRAHASIMI I ÇIFTEVE TË NUMRAVE TRESHIFRORË OSE KATËRSHIFRORË 60
NUMRAT NEGATIVË, NUMRAT MË TË VEGJËL SE ZERO 64
NUMRA NEGATIVË - VAZHDIMI I VARGUT TË NUMRAVE 67
THYESAT E RREGULLTA 71
THYESAT E RREGULLTA, PJESË E FORMAVE DHE NUMRAVE 74
KRAHASIMI DHE RENDITJA E THYESAVE 77
THYESAT E BARABARTA 80
PARAQITJA E THYESAVE TË RREGULLTA NË BOSHTIN NUMERIK 84
PARAQITJA E THYESAVE DHE KRAHASIMI I THYESAVE TË BARA BARTA 86
NUMRA TË PËRZIER 87
NUMRA TË PËRZIER 91
NUMRA DHJETORË ME NJË DHJETORE (DECIMAL) 93
PËRSËRISIM NUMRAT DHJETORË 96
ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE 96

2 GJEOMETRIA

GJYSMËDREJTËZA 105
KËNDI 107
KËNDI I DREJTË 108
LLOJET E KËNDEVE 110
KRAHASOJMË KËNDET – ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE 112
EMËRTIMI I FORMAVE 2D 114
VIZATIMI I FORMAVE 2D 119
PËRSHKRUAJMË DHE GRUPOJMË FORMAT 2D 122
SHUMËKËNDËSHA TË RREGULLT DHE TË PARREGULLT 123
SITUATA PROBLEMORE ME FORMAT 2D 124
FORMAT 3D ME SIPËRFAQE TË SHESHTA DHE TË LAKUARA 126
ELEMENTET E FORMAVE 3D ME FAQE TË SHESHTA: KULMI, I BRINJA DHE FAQJA 128
FORMA 3D ME FAQE TË SHESHTA DHE TË LAKUARA; ELEMENTET E FORMAVE 3D ME FAQE TË LAKUARA: KULMI, FAQJA, MBËSHTJELLËSI 131
LIDHJA NDËRMJET FORMAVE 2D DHE 3D 133
KRIJIMI I RRJETEVE TË FORMAVE 3D 134
LIDHJA NDËRMJET FORMAVE 2D DHE 3D 135
LIDHJA NDËRMJET FORMAVE 2D DHE 3D – VIZATIMI I FORMAVE 3D 137
SITUATAT PROBLEMORE ME FORMAT 3D 139
SIMETRIA 141

2

PËRCAKTIMI I POZICIONIT ME RROTULLIM NË DREJTIM TË LËVIZJES SË AKREPAVE TË ORËS 147
VIZATIMI I SHTEGUT TË LËVIZJES SIPAS UDHËZIMIT 150
SHËNIMI I POZICIONIT NË RRJETIN E KOORDINATAVE 152
VIZATIMI I FORMAVE SIMETRIKE NË RRJETIN E KOORDINATAVE 155
ÇFARË KEMI MËSUAR? 156

3

OPERACIONE ME NUMRA

MBLEDHJA DHE ZBRITJA E DHJETËSHEVE DHE QINDËSHEVE TË PLOTA 163
MBLEDHJA DHE ZBRITJA E MIJËSHEVE TË PLOTA 165
ÇIFTE TË MIJËSHEVE, SHUMA E TË CILAVE ËSHTË 10000 166
MBLEDHJA DHE ZBRITJA E NUMRIT KATËRSHIFROR ME DHJETËSHE TË PLOTË 167
MBLEDHJA DHE ZBRITJA E NUMRIT KATËRSHIFROR ME QINDËSHE TË PLOTË 169
MBLEDHJA DHE ZBRITJA E NUMRIT KATËRSHIFROR ME MIJËSHE TË PLOTË 171
MBLEDHJA DERI NË 10000 PA KALIME 173
ZBRITJA DERI NË 10000 PA KALIME 174
MBLEDHJA DERI NË 10000 ME KALIME 176
ZBRITJA DERI NË 10000 ME KALIME 179
MBLEDHJA DHE ZBRITJA E NUMRAVE AFËR DHJETËSHES DHE QINDËSHES SË PLOTË 181
MËNYRA TË TJERA PËR MBLEDHJE DERI NË 10000 183
MËNYRA PËR ZBRITJE DERI NË 10000 186
PËRSËRISIM, USHTROJMË 188
VETIA KOMUTATIVE DHE ASOCIATIVE E MBLEDHJES 189
ZBATIMI I VETISË KOMUTATIVE DHE ASOCIATIVE GJATË MBLEDHJES 191
VARËSIA E SHUMËS NGA MBLEDHËSIT TEK APO ÇIFT 192
VARËSIA E DIFERENCËS NGA I ZBRITSHMI OSE ZBRITËSI TEK APO ÇIFT 194
NJEHSIMI I NUMRIT TË PANJOHUR GJATË MBLEDHJES DHE ZBRITJES 196
SITUATA PROBLEMORE ME MBLEDHJEN DHE ZBRITJEN 199
DYFISHIMI I NUMRAVE ME MIJËSHE, QINDËSHE DHE DHJETËSHE TË PLOTA 202
ZGJIDHJA E PROBLEMEVE ME DYFISHIMIN 204
PËRGJYSMIMI I NUMRAVE ME MIJËSHE, QINDËSHE DHE DHJETËSHE TË PLOTA 206
ZGJIDHIM PROBLEME – DYFISHIMI DHE PËRGJYSMIMI 208
SHUMËZIMI I NUMRAVE NJËSHIFRORË DERI NË 100. SHUMËFISHAT 211
SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME NUMRIN 7 216
SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME NUMRIN 8 219
STRATEGJITË PËR SHUMËZIM MENDOR TË DHJETËSHEVE DHE QINDËSHEVE TË PLOTA ME NUMËR NJËSHIFROR 222
STRATEGJI TË TJERA PËR SHUMËZIM MENDOR 226
SHUMËZIMI I NUMRIT DYSHIFROR ME NUMËR NJËSHIFROR 229
SHUMËZIMI I NUMRAVE TRESHIFRORË ME 10 232
PJESËTIMI I NUMRAVE TRESHIFRORË ME 10 234
SA MËSUAM – SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI I NUMRIT TRESHIFROR ME 10 237
ZGJIDHIM DETYRAT PROBLEMORE 241
SHUMËZIMI I NUMRAVE ME NUMËR NJËSHIFROR ME ZBËRTHIM 243
PJESËTIMI I NUMRIT DYSHIFROR ME NUMËR NJËSHIFROR, PA MBETJE 245
PJESËTIMI I NUMRIT DYSHIFROR ME NUMËR NJËSHIFROR ME MBETJE 250
RAPORTI - PROPORCIONI 253
SHPREHJET NUMERIKE 257

3

NJEHSIMI I SHUMËZUESIT, TË PJESËTUESHMIT DHE PJESËTUESIT TË PANJOHUR 263
MBLEDHJA DHE ZBRITJA E THYESAVE ME EMËRUES TË NJËJTË 267
SHFRYTËZIMI I BARABARSHMËRISË SË THYESAVE PËR MBLEDHJEN DHE ZBRITJEN E THYESAVE TË RREGULLTA ME SJELLJEN E TYRE DERI NË NJË EMËRUES TË NJËJTË 271
GJETJA E NJË PJESE TË NUMRAVE DERI NË 100 274
NUMRAT DHJETORË 276
PJESËTIMI I NUMRAVE DERI NË 1000 ME 10 DERI NË NJË DHJETORE 276
SITUATAT PROBLEMORE NGA JETA E PËRDITSHME QË ZGJIDHEN PËRMES OPERIMIT ME NUMRA 279

4

MATJA

GJATËSIA, MASA, VËLLIMI, KOHA, PERIMETRI DHE SIPËRFAQJA E FORMAVE 2D 283
MATJA E GJATËSISË – METËR, CENTIMETËR 285
MATJA E GJATËSISË – DECIMETËR 287
MATTJA E GJATËSISË – MILIMETËR 288
MATTJA E GJATËSISË - KILOMETËR 289
MATJA E GJATËSISË - ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE ME GJATËSINË 290
MATJA E MASËS - GRAM 292
MATJA E MASËS - KILOGRAM 294
MATJA E MASËS – NJËSITË MATËSE PËR MASËN 296
MATJA E MASËS - ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE ME MASËN 298
MATJA E LËNGJEVE – LITËR 300
MATJA E LËNGJEVE – DECILITËR DHE CENTILITËR 301
MATJA E LËNGJEVE – MILILITËR 302
MATJA E LËNGJEVE – ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE GJATË MATJES SË LËNGJEVE 304
MATJA E KOHËS – ORA, MINUTA DHE SEKONDA 306
MATJA E KOHËS – DEKADA, SHEKULLIL 307
MATJA E KOHËS - ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE ME KOHËN. INTERVALE KOHORE 308
NJEHSIMI I INTERVALEVE KOHORE 310
MATJA DHE LEXIMI I KOHËS – ORARI DHE KALENDARI 311
MATJA E PERIMETRIT TË FORMAVE 2D 314
KUPTIMI I SYPRINËS - LLOGARISIM SYPRINËN ME RRJET KATROR 316
ZGJIDHIM PROBLEME ME PERIMETRIN DHE SYPRINËN 320
VARËSIA E PERIMETRIT DHE SYPRINËS 320
ÇFARË DHE SA KEMI MËSUAR 322

5

PUNA ME TË DHËNA

MBLEDHJA, ORGANIZIMI, PARAQITJA DHE INTERPRETIMI I TË DHËNAVE 327
PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË PROJEKTIT, MBLEDHJA E TË DHËNAVE, PREZANTINI DHE LEXIMI I TË DHËNAVE NGA DIAGRAMET DHE GRAFIKËT 333
LEXIMI I TË DHËNAVE NGA DIAGRAMI LINEAR 340
ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE 343
ASNJËHERË, GJITHMONË, NDOSHTA, KA GJASA 347
BËJMË EKSPERIMENTE DHE PARASHIKOJMË REZULTATE 352

TEMA 1

NUMRAT DHE NUMËRIMI

1 NUMRAT DERI NË 10000

2 KRAHASIMI I ÇIFTEVE TË NUMRAVE TRESHIFRORË

3 NUMRAT NEGATIVË

4 THYESAT

NUMRAT DHE NUMËRIMI

PËR TEMËN

Në këtë temë, do të zgjeroni njohuritë sa i përket numërimit, leximit dhe shkrimit të numrave deri në 10000; do të përcaktoni njohuritë lidhur me vendin dhe vlerën e shifrës në një numër të dhënë katërshifror; do të krahasoni çiftet e numrave treshifrorë dhe katërshifrorë sipas vendvlerës së shifrave në këta numra; do të krijoni varg të numrave sipas ndonjë rregulli dhe do të jeni në gjendje që ta shpjegoni këtë proces. Do të mësoni sesi të njihni numrat negativë në përditshmëri, të lexoni, të shkruani dhe të krahasoni thyesat, si dhe të shndërroni një thyese me emërues 10 në një numër dhjetor.

SFIDA TË MUNDSHME

Formimi dhe shkrimi i numrave shumëshifrorë është i vështirë nëse mbështetemi vetëm mbi numërimin. Nxënësve u duhet një pasqyrë e qartë mendore për formimin e tyre. Prandaj, është e nevojshme që të përdoren materiale konkrete, por edhe përmbajtje dixhitale për të forcuar vetëbesimin e tyre. Nxënësi/ja që nuk e kupton dallimin ndërmjet vendvlerës dhe shifrës, mund të shkruajë treqind e njëzet e pesë si 30025. Mund të jetë gjithashtu e vështirë të lexohen dhe të shkruhen numrat shumëshifrorë që përmbajnë numrin zero 7002, 5036... Ata duhet të konsolidojnë edhe kuptimet e tyre që kanë mbi numrin zero si një shifër dhe sipas vendvlerës së tij. Si sfidë paraqitet edhe krahasimi i numrave negativë. P.sh.,,nxënësi/ja, i/e cili/a nuk e kupton procedurën e përfaqësimit të një numri negativ në boshtin numerik, mund të pretendojë që -5 është më i madh se -2.
Te numrat dhjetorë, nxënësit mund të mendojnë se 1,9 është më i madh se 2, sepse 1,9 ka më shumë shifra gjatë shënimit.
Të kuptuarit që njësia është dhjetë herë më e madhe se e dhjeta, do t'u ndihmojë nxënësve që ta zgjidhin këtë problem.
Në vargun e numrave, ekziston një rregull për radhitjen e numrave. Përmes shembujve të ndryshëm, ne do të nxisim zbulimin e rregullave të ndryshme, duke përpiluar kështu vargje të shumta.

MATERIALE TË NEVOJSHME DHE INSTRUMENTE MATËSE:

Tabelë e qindësheve me numra, bosht numerik, letra me numra, letra me numra të shkruar treshifrorë dhe katërshifrorë, letra me fjalë dhe terma, shirita bosh dhe varg i letrave pa numra, shirita rrëshqitëse me numra, varg i numrave , numëratore, letra me thyesa dhe numra dhjetorë, rrotull me numra – pikado/, grafik me vendvlera, kuba me numra, "mur" me thyesa.







Fjalori
i termave të reja

- numri
- shifra
- sasia
- njëshe
- dhjetëshe
- qindëshe
- mijëshe
- numër shumëshifror
- vendvlera
- vargu i numrave
- më i madh se (>)
- më i vogël se (<)
- i barabartë me (=)
- numër negativ
- numër më i vogël se 0
- thyesë e rregullt
- emërues, numërues, vijë thyesore
- numër i përzier
- numër dhjetor me një shifër pas presjes dhjetore

TEMA 1

NUMRAT DERI NË 10000

NUMRAT DERI NË 1000

NUMËROJMË ME NGA 1 000 DERI NË 10 000 NGA PARA DHE NGA PRAPA

FORMIMI, SHKRIMI DHE LEXIMI I NUMRAVE DERI NË 10000

VENDVLERA DHE ZBËRTHIMI I NUMRAVE

PARAQITJA E NUMRAVE TRESHIFRORË

DHE KATËRSHIFRORË NË BOSHTIN NUMERIK

VARGU I NUMRAVE

RRUMBULLAKIMI NË DHJETËSHEN MË

TË AFËRT TË NUMRAVE TRESHIFRORË

RRUMBULLAKIMI NË DHJETËSHEN

MË TË AFËRT TË NUMRAVE KATËRSHIFRORË

KRAHASIMI I ÇIFTEVE TË NUMRAVE TRESHIFRORË

KRAHASIMI I ÇIFTEVE TË NUMRAVE KATËRSHIFRORË

KRAHASIMI I NUMRAVE TRESHIFRORË DHE KATËRSHIFRORË

RENDITJA E NUMRAVE DERI NË 10000 SIPAS MADHËSISË ME SHENJAT <, =, >

RENDITJA E NUMRAVE DERI NË 10000 SIPAS MADHËSISË

NUMRAT DERI NË 1000

Përsërisim, rikujtohemi

Çfarë mund të blesh me 1 denar? Kurse çfarë me 10, 100, 1000 denarë?
Çfarë mund të blesh me 110 denarë?
A mund të blesh kompjuter me 1000 denarë? Pse?

NUMRAT DERI NË 10000

MBANI MEND!

SHENJAT NË KËTO LULE I QUAJMË **SHIFRA!** LEXOJI!

ME SHIFRA I SHKRUAJMË **NUMRAT.**



1 A mund të zbulosh dhe të shkruash me numër se sa kube ka, duke ditur që një kub përfaqëson një njësi?









2 Cilat janë numrat që janë paraqitur në këto figura?
Si i përcaktove ato?



1 _____



2 _____

Rikujtohu se si formohen dhe si shkruhen numrat treshifrorë.



(me rrjetin e kubeve)

(me numëratore)

Numri 423 përmban shifrën 4 në klasën **qindëshe**, shifrën 2 në klasën **dhjetëshe** dhe shifrën 3 në klasën **njëshe**

Numri 423 në formë të zbërthyer shkruhet si

$$423 = 4 \cdot 100 + 2 \cdot 10 + 3 \cdot 1$$

ose

$$423 = 400 + 20 + 3$$

Nëse e dimë që 1 qindëshe = 10 dhjetëshe; 1 dhjetëshe = 10 njëshe, atëherë numri 423 përmban 4 qindëshe të plota, 42 dhjetëshe të plota dhe 423 njëshe.



4



2



3

400 + 20 + 3

3 Sa qindëshe, dhjetëshe dhe njëshe përmbajnë numrat 307, 551 dhe 660? Shkruaji ato në formë të zbërthyer.

307 _____

551 _____

660 _____

526 _____

928 _____

414 _____

4 Cilat numra janë paraqitur? Cili është më i madhi prej tyre?
Cili është më i vogli?
Renditi sipas madhësisë, duke filluar nga më i vogli.



5 Zgjedh nga një numër prej secilës kolonë dhe formo 5 numra të ndryshëm treshifrorë. Shkruaji numrat e formuar dhe më pas renditi ato duke filluar nga më i madhi.

Q	Dh	Nj
100	10	1
200	20	2
300	30	3
400	40	4
500	50	5
600	60	6
700	70	7
800	80	8
900	90	9

6 Duke përdorur letra me shifra, formo tri numra treshifrorë. Shifrat edhe mund të përsëriten. Pastaj numrat e formuar shkruaji me fjalë:

1	2	3
4	5	6
7	8	9
	0	

_____ → _____

_____ → _____

_____ → _____

Renditi numrat e formuar, duke filluar nga numri më i vogël treshifror:

_____

7 Y model kubi përmban _____kube të vegjël.
Le të themi se është paraqitur numri një mijë.
E shkruajmë **1000.**
Përmban 1 **mi**jëshe, 10 **q**indëshe, 100 **dh**jetëshe ose 1000 **nj**ëshe.

1 mijë = 1000 njëshe

klasa mijëshe	klasa qindëshe	klasa qindëshe	klasa qindëshe
1	0	0	0

NUMRAT DERI NË 10000

NUMËROJMË ME NGA 1 000 DERI NË 10000 NGA PARA DHE NGA PRAPA

1 Plotëso numrat që mungojnë dhe shkruaji ato.

0	1000				5000					10000

2 Vazhdo të numërosh prej 10 000 nga prapa me nga 1000. Shkruaji!

10000, 9000, _____, _____, _____, 5000, _____, _____, _____, _____, 0.

3 Numëro nga 0 deri në 10 000 kështu: 0, 2000, 4000, ..., ..., 10000. Por provo dhe nga prapa: 9000, 7000,... Çfarë vëren kur numëron nga para dhe çfarë kur numëron nga prapa?



4 Plotësoje boshtin numerik me numrat që mungojnë.

Pastaj, duke përdorur boshtin numerik, plotëso vendet bosh me mijëshen para dhe pas numrit të dhënë!

	4000			7000	
	9000			2000	

DHJETË MIJËSHE	MIJËSHE QINDËSHE	QINDËSHE	DHJETËSHE	NJËSHE
DHM	MQ	Q	Dh	Nj
	1	0	0	0

Tabela me vlerat vendore të mijësheve deri në 10 000.

5 Plotëso tabelën, duke ndjekur shembullin:

VENDVLERA	3		8		7
MIJËSHE		10000		6000	

6 Kujt i përket arka?
Ana, Durimi, Elifi dhe Ivani kanë kursyer para gjatë gjithë vitit. Ata i kanë këmbyer paratë e kursyera në kartëmonedha prej 1000 denarësh. Në arkën e Anës ka 2 kartëmonedha, në arkën e Durimit ka 4 kartëmonedha, në arkëne Elifit ka 8 kartëmonedha, kurse në arkën e Ivanit ka 5 kartëmonedha. Shkruani emrat e duhur nën arkat.

8000 den. _____



4000 den. _____



2000 den. _____



5000 den. _____

7 Në shitoren e pajisjeve kompjuterike janë furnizuar 10000 kompjuterë. Çdo muaj shiten nga 1000 kompjuterë. Shitja ka filluar në muajin shtator.

Sa kompjuterë do të mbeten të pashitur në fund të muajit dhjetor? Në cilin muaj shitorja duhet të furnizohet me kompjuterë të rinj për shitje, nëse të gjithë kompjuterët janë shitur më parë?

_____

_____

_____

8 Xhaxhi Tome kishte shitur komplete të ditëlindjeve (gota, pjata ëmbëlsirash...) në tregun afër . Shitja e tij prezantohet në këtë tabelë:

muaji i parë	muaji i dytë	muaji i tretë
1000 1000 1000	1000 1000 1000 1000	1000 1000 1000 1000 1000

Sa komplete ka shitur xhaxhi Tome gjatë secilit muaj?
Në cilin muaj ka shitur më pak?

9 Krahasoni numrat e dhënë. Përdorni shenjat < ose >.

400 ◯ 200 300 ◯ 600 100 ◯ 400

3000 ◯ 1000 5000 ◯ 6000 4000 ◯ 2000

3000 ◯ 6000 1000 ◯ 4000 7000 ◯ 10000

> <

NUMRAT DERI NË 10000



DhM	MQ	Q	Dh	Nj
	7	2	2	3

Numri i paraqitur i shkruar me shifra është 7223, kurse me fjalë **shtatë mijë e dyqind e njëzet e tre.**

FORMIMI, SHKRIMI DHE LEXIMI I NUMRAVE DERI NË 10000

Vlerësojmë dhe Hulumtojmë

Pika më e lartë e Malit Sharr është dy mijë e shtatëqind e dyzet e tetë metra. Si quhet? Gjej edhe informacione të tjera për majën.

Pika më e lartë e Malit Sharr është 2748 metra.

Në tabelën e vendvlerave , shënimi i numrit është si në vijim:

NjM	Q	Sh	Nj
2	7	4	8

MBAJ MEND

NUMRAT KATËRSHIFRORË I LEXOJMË NË ATË MËNYRË QË SË PARI I LEXOJMË MIJËSHET, PASTAJ QINDËSHET, PASTAJ DHJETËSHET DHE NJËSHET.

1 Shkruaj me fjalë numrat në vijim:

5670 _____

9206 _____

2001 _____

10000 _____

2 Shëno me shifra numrat në vijim si në shembullin e dhënë:

a) gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë e dy **6232**

b) tre mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë _____

c) nëntë mijë e shtatëqind e tre _____

ç) tetë mijë e pesëdhjetë e katër _____

3 Cili numër është paraqitur me këto letra? Rrethoje numrin.

1000	1000	100	100	100	10	10	10	10	10	10	10

2470 **2770** **2370** **7270** **2670**

4 Plotëso tabelën:

Shkruhet	Lexohet
5362	
9402	
	Dy mijë e tridhjetë e pesë
1607	
9999	
	Dhjetë mijë

5 Lidhi figurat me numrin që ato përfaqësojnë



6 Shkruaji numrat sipas kuptimit të simboleve

1 mijëshe

1 qindëshe

1 dhjetëshe

1 njëshe

	I shkruaj	I lexoj
	2112	Dy mijë e njëqind e dymbëdhjetë
	1001	
		Tre mijë e njëzet
	1110	

7 Arta ka shkruar një numër. Numri ka: 5 mijëshe, 3 dhjetëshe dhe 2 njëshe. Cilin numër e ka shkruar Arta?

_____

8 Cili është numri më i vogël katërshifror dhe cili është më i madhi?

_____

Si do të vlerësosh se cili numër katërshifror, cilës mijëshe i përket?

Shikoje tabelën dhe zbulo.

1, 2, 3, 4, 5, ...	999, 1000	**mijëshja e parë**
1001, 1002, ...	1999, 2000	**mijëshja e dytë**
2001, 2002, ...	2999, 3000	**mijëshja e tretë**
3001, 3002, ...	3999, 4000	**mijëshja e katërt**
4001, 4002, ...	4999, 5000	**mijëshja e pestë**
5001, 5002, ...	5999, 6000	**mijëshja e gjashtë**
6001, 6002, ...	6999, 7000	**mijëshja e shtatë**
7001, 7002, ...	7999, 8000	**mijëshja e tetë**
8001, 8002, ...	8999, 9000	**mijëshja e nëntë**
9001, 9002, ...	9999, 10000	**mijëshja e dhjetë**

Luaj me letrat me numra. Nga shifrat 7, 4, 9 dhe 0, formo 6 numra të ndryshëm katërshifrorë. Përcakto se cilës mijëshe i përkasin. Shpjego përgjigjen!

9 Lindi në tabelë i ka shkruar numrat 4321, 8007, 325, 1000, 4997, 8156. Ana i ka grupuar ato si në vijim:

1. mijëshen e parë – 325. 1000
2. mijëshen e katërt – 4321. 4997
3. mijëshen e tetë – 8156.8007

A i ka formuar grupet si duhet Ana apo ka gabuar? Shpjego.

VENDVLERA E NUMRAVE DHE ZBËRTHIMI I TYRE

Sa përmban?

1 dhjetëshe = 10 njëshe
1 qindëshe = 10 dhjetëshe
1 mijë = 10 qindëshe
1 dhjetë mijë = 10 mijëshe

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

NUMRA DERI NË 10000

Numri 2135 mund të shkruhet në formë të zbërthyer, duke përdorur vendvlerën e secilës shifër të numrit.

$$\begin{aligned} \mathbf{2135} = \; & 2000 \\ & + 100 \\ & + 30 \\ & + 5 \\ = \; & 2 \cdot 1000 \\ & + 1 \cdot 100 \\ & + 3 \cdot 10 \\ & + 5 \end{aligned}$$

Vendi ose pozicioni i shifrës në një numër na tregon madhësinë ose vlerën e tij. (Vlera e një shifre në një numër varet nga vendi – pozicioni i saj në atë numër. Shqyrto numrin 2374:

NJM	Q	Dn	Nj
2	3	7	4

2 e ka vlerën 2000 - Ka 2 mijëshe

4 e ka vlerën e 4 njësheve

3 është në pozicionin e qindësheve dhe ka vlerën 300

7 është në pozicionin e dhjetësheve dhe ka vlerë prej 700

Lexojmë numrin: **dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e katër.**

Në numrin 3045 zero tregon se nuk ka qindëshe në pozicionin e qindësheve. Lexojmë: **tre mijë e dyzet e pesë.**

1 Plotëso këto barazime numerike:

a) 3621 = 3000 + ____ + 20 + 1

b) 8516 = ____ + 500 + 10 + 6

c) 4259 = 4000 + ____ + 50 + 9

ç) 1857 = 1000 + ____ + ____ + 7

d) 6382 = ____ + 300 + ____ + 2

dh) 9174 = ____ + ____ + 70 + ____

e) 7813 = ____ + ____ + ____ + ____

2 Zbërthe numrat:

a) 3621 =

b) 8516 =

c) 4259 =

ç) 1857 =

ç) 6382 =

dh) 9174 =

T'i shqyrtojmë numrat 3469 dhe 9436.
Me cilat shifra janë shkruar ato?
A ka shifra 9 të njëjtën vlerë në të dy numrat?

T'i zbërthejmë numrat:

NjM	Q	Dh	Nj
3	4	6	9

3 ka vlerë 3000

6 ka vlerë 60

4 ka vlerë 400

9 ka vlerë të 9 njësheve

NjM	Q	Dh	Nj
9	4	3	6

9000 400 30 6

Numrin e parë e lexojmë 346**9** - tre mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë.
Numrin e dytë e lexojmë **9**436 - nëntë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë.

KONSTATOJMË SE: Vlera e shifrës në një numër varet nga vendi i saj në atë numër.
Shifra 9 ka një vlerë më të lartë në numrin 9436, sepse qëndron në vendin e mijësheve.

3 Përgjigju pyetjeve të mëposhtme duke shfrytëzuar shifrat e mëposhtme:

8, 4, 2, 5

Cili është numri më i vogël që mund ta përpilosh nga të gjitha shifrat?

Cili është numri më i vogël çift që mund ta përpilosh nga të gjitha shifrat?

Përpilo numrin më të madh me anë të shifrave të dhëna!

Përpiloni numrin më të madh tek me anë të shifrave të dhëna!

Shkruaj numrin më të vogël dhe më të madh katërshifror:

Aktivitet në çifte me ndihmën e letrave me shifra

Së bashku me shokun/shoqen, përzieni letrat me shifra dhe vendosini ato në pjesën e prapme para jush.

Tërhiqni letrat në mënyrë të alternuar.
Zgjidh ku do ta shkruash numrin tënd në tabelë.
Shkruaje numrin në vendin e saktë në tabelë.
Vazhdo derisa të përpilosh një numër katërshifror.
Shkruaj numrin tënd katërshifror në kolonën e fundit.
Ndërroji shifrat për të përpiluar një numër sa më të madh që është e mundur.

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

Sa herë që numri yt është më i madh se numri i shokut tënd, ti merr një pikë.

Lojtari me më shumë pikë është fituesi.

	Njësi mijëshe 1000	qindëshe 100	dhjetëshe 10	njëshe 1	Numër
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					
6.					
7.					
8.					
9.					
10.					

1. Kam menduar një numër nga mijëshja e pestë. Në vendin e qindësheve dhe dhjetësheve është shifra 6 dhe në vendin e njësheve është 0. A mund ta merrni me mend se cilin numër e kam menduar?

2. Shkruani disa numra nga mijëshja e tretë, qindëshja e dytë dhe në vend të njësheve ta kenë shifrën 8.

NUMRAT DERI NË 10000

PARAQITJA E NUMRIT TRESHIFROR DHE KATËRSHIFROR NË BOSHTIN NUMËRIK

Diana nxori tri nga letrat me shifra dhe përpiloi një numër treshifror.

Ajo ia tregoi numrin Donit. Ai duhej të gjente vendin e numrit në boshtin numerik, kurse Selma duhej të shkruante numrin sipas vendit të cilin e shënoi Doni. Doni e vendosi pikën në boshtin numerik si vijon:



Selma e shënoi numrin 250.

A e shkroi Selma saktë numrin në boshtin numerik?

Përsëriteni këtë aktivitet me shokët tuaj.



1 Në katrorët shënoji numrat e përcaktuar në boshtin numerik.



2 Lidhi numrat me vendin e tyre në boshtin numerik:



3 Shkruaji numrat 4500, 3200, 4000, 3700, 3100, 4800 duke filluar nga më i vogli.
Pastaj përcakto vendin e tyre në boshtin numerik!



4 Gjeni numrat e fshehur nën lule!



5 Gjeje vendin e numrave në boshtin numerik!



Shqyrto, mendo dhe shpjego se çfarë thuhet me procedurën e mëposhtme.
Përdor vendvlerën e shifrës në një numër ose bosht numerik.



Pastaj, sipas udhëzimeve, plotëso:

a) 4867 (+ 1000) _____ (- 100) _____ (+ 10) _____ (- 1) _____

b) 2541 (+ 100) _____ (- 100) _____ (+ 1) _____ (- 10) _____

c) 9999 (- 1000) _____ (- 100) _____ (+ 1) _____ (- 1000) _____

6 Numëro nga para dhe prapa dhe plotëso të dyja anët e tabelës në lidhje me numrat e dhënë. Ndiqe shembullin e rreshtit të parë.

-1000	-100	-10	numër	+10	+100	+1000
3519	4519	4619	**4629**	4639	4739	5739
			8223			
			6754			
			1430			
			2467			
			7210			
			5555			
			3456			

7 Numëro nga 1000.

2397, _____, _____, _____, _____, _____, _____, _____

Numëro nga 100.

1120, _____, _____, _____, _____, _____, _____, _____

Numëro nga 10.

9311 , _____, _____, _____, _____, _____, _____, _____

8 Plotëso fjalinë me fjalët "**paraardhës**" ose "**pasardhës**". Përdor boshtin numerik!

Numri 5678 është _____ i numrit 5679.

Numri 2390 është _____ i numrit 23895.

Numri 9999 është _____ i numrit 10000.

Numri 8621 është _____ i numrit 8620.

9 Shëno numrat që mungojnë:

243	244	245
560		562
	888	

3200	3300	
4510		4530
	6201	6301

5700		5702
	3021	
6793		

VARGU I NUMRAVE

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

Ja disa shembuj:

2, 4, 6, 8, 10, 12, ...
Për të gjetur numrin tjetër, përdoret rregulli "shto 2".

50, 45, 40, 35, 30, ...
Për të gjetur numrin tjetër, përdoret rregulli "zbrit 5".

Sipas një rregulle të caktuar, mund të futni numrat që mungojnë në boshtin numerik.

Shembulli 1: 368, 369, ___, 371, 372, ___, 374, ___.
Në këtë varg rregulli është "shto 1". Plotëso vargun.

NUMRA DERI NË 10000

Shiko, mendo dhe vlerëso se cilat numra do të jenë pasardhës në këtë varg:

1, 1, 1, 1, ...
2, 7, 12, 17, ...
3, 2, 1, 4, 3, 2, 1, 5, 4, ...
105, 115, 125, ...

Me interes të veçantë janë vargjet e numrave, në të cilat, secili numër pasardhës fitohet sipas një regulle.

1 Shkruaj vargjet e mëposhtme sipas rregullit të dhënë:

a) Shto 200. 1, 201, _____, _____, _____, _____, _____, _____.

b) Shto 1000. 1, _____, _____, _____, _____, _____, _____, _____.

c) Shto 5. 1, _____, _____, _____, _____, _____, _____, _____.

ç) Shto 20. 1, _____, _____, _____, _____, _____, _____, _____.

Shembulli 2: Shiko vargun: 1450, 2450, 3450, 4450, 5450, 6450, 7450.
Rregulli i këtij vargu është "shto 1000".

2 Përpilo vargje sipas rregullit "shto 500".

4450, _____, _____, _____, _____, _____.

5450, _____, _____, _____, _____.

6450, _____, _____, _____.

7450, _____, _____.

3 Zbulo rregullin dhe shkruaj disa numra në vargjet e mëposhtme.

a) 562, 572, 582, _____, _____, _____, _____, _____, _____.

Rregulli është _____.

b) 6409, 6309, 6209, _____, _____, _____, _____, _____, _____.
Rregulli është _____.

c) 6213, 5213, 4213, _____, _____, _____, _____, _____, _____.
Rregulli është _____.
Numrat në vargun e mëparshëm merren me zbritje dhe mbledhje.

Ti mund të përdorësh operacione të ndryshme si rregull për të marrë një varg numrash
(Për shembull: dyfishim ose përgjysmim, shumëzim ose pjesëtim).

4 Shiko këto vargje, zbulo se si fitohen numrat e mëposhtëm dhe shkruaj tre numrat vijues.

a) 1, 2, 4, 8, _____, _____, _____.

b) 10000, 1000, _____, _____, _____.

c) 8000, 4000, 2000, _____, _____, _____.

5 Shikoj këto vargje dhe shkruaj tre numrat vijues. Këto vargje kanë rregulla, duke përdorur më shumë operacione . Zbulo rregullin.

a) 1, 3, 7, 15, _____, _____, _____, _____, _____.

b) 1, 4, 10, 22, _____, _____, _____, _____, _____.

c) 1, 1, 2, 3, 5, _____, _____, _____, _____, _____.

NUMRAT DERI NË 10000

Semra i tërhoqi këto letra me numrat:

503	508
505	498
504	512

Këta numra, ajo i grupoi në mënyrën e mëposhtme:

Më afër me 500	Më afër me 510
498	505
503	508
504	512

Numrat e tërhequr, Semra i rrumbullakosi në dhjetëshen më të afërt në këtë mënyrë

498 – 500
503 – 500
504 – 500

505 – 510
508 – 510
512 – 510

Pse Semra e bëri këtë grupim në këtë mënyrë? Diskutoni me ndihmën e boshtit numerik.

RRUMBULLAKIMI NË DHJETËSHEN MË TË AFËRT TË NUMRAVE TRESHIFRORË

Shpeshherë, për të mbajtur mend ose për përpunim më të lehtë, ne i rrumbullakosim numrat shumëshifrorë në dhjetëshen, qindëshen, mijëshen më të afërt, ... Ne e bëjmë këtë si më poshtë: nëse numri i njësheve është 4 ose më i vogël se 4, (3, 2, 1), atëherë rrumbullakosim në dhjetëshen paraardhëse.

Nëse numri i njësheve është 5 ose më i madh se 5 (6, 7, 8, 9), atëherë ne rrumbullakosim në dhjetëshen pasardhëse.



1 Rrumbullako numrat e mëposhtëm në dhjetëshen më të afërt:

Numri	Rrumbullako numrin në dhjetëshen më të afërt.
567	
768	
355	
851	
621	
433	
127	
222	

2 Shëno me X numrin që nuk është i saktë gjatë rrumbullakimit të numrit të dhënë në dhjetëshen më të afërt:

567

560 570

981

980 990

355

350 360

3 Vlerëso ku duhet të qëndrojnë numrat e mëposhtëm në boshtin numerik: 235, 541, 868, 297, 662.

Shëno numrat në bosht. Pastaj, plotëso tabelën duke i rrumbullakuar numrat në dhjetëshen më të afërt:

Numri	Rrumbullako numrin në dhjetëshen më të afërt.
235	
551	
868	
297	
662	

4 Në pohimet e mëposhtme, rrumbullako secilin prej numrave në dhjetëshen më të afërt. Mund të përdorësh boshtin numerik.

a) Në ekipet e futbollit në shkollë marrin pjesë 98 nxënës. _____

b) Për të bërë biskota, nëna përdori 395 gramë miell. _____

c) Biblioteka e qytetit u pasurua me 878 libra të rinj _____

ç) Në shfaqjen teatrale ishin 535 fëmijë. _____

5 Gjyshit i duhen 68 m dhe 80 cm tel për të rrethuar oborrin. Teli shitet në metra. Rrumbullako, sa metra tel duhet të blejë gjyshi?

NUMRAT DERI NË 10000

Shembuj:

2345 rrumbullakohet në 2300

4568 rrumbullakohet në 4600

Themi se maja më e lartë e Malit Sharr është Maja e Titos me lartësi prej 2700 metrash.



Dhe tani, le t'i rrumbullakojmë numrat e Verës në qindëshen më të afërt:

6780 – 6800
6650 – 6700
6810 – 6800
6690 – 6700

RRUMBULLAKIMI NË QINDËSHEN MË TË AFËRT TË NUMRAVE KATËRSHIFRORË

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

Vera vizatoi një tabelë me vendvlera dhe shkroi numra katërshifrorë në të. Ajo donte t'i gruponte numrat sipas disa kritereve, kështu që i ndau në këtë mënyrë:

NjM	Q	Dh	Nj
6	7	8	0
6	6	5	0
6	8	1	0
6	6	9	0

Më afër me 6800

6780 dhe 6810

Më afër me 6700

6650 dhe 6690

Vera i rrumbullakoi numrat në qindëshen më të afërt.

RREGULLI!

Për të rrumbullakuar në qindëshen më të afërt, shikoje shifrën e dhjetësheve. Nëse shifra e dhjetësheve është 4 ose më e vogël se 4, atëherë shifra e qindësheve nuk ndryshohet dhe shkruhet 0 në vend të dhjetësheve dhe njësheve. Nëse shifra e dhjetësheve është 5 ose më e madhe se 5 (6, 7, 8, 9), atëherë rrumbullakohet në qindëshen pasardhëse, kurse në vend të dhjetësheve dhe njësheve shkruhet 0.

1 Rrumbullako numrat e mëposhtëm në qindëshen më të afërt:

Numri	Rrumbullako numrin në qindëshen më të afërt
3458	
6541	
8893	
5683	
2191	
3256	
7444	
5555	

2 Jepen numrat: 5000, 800, 4000, 30, 700, 40, 6000, 200, 80.

a) Formo tri numra katërshifrorë. Shkruaj numrat:

_____

b) Shëno numrat në boshtin numerik.

c) Rrumbullako në qindëshen më të afërt:

_____ i rrumbullakuar në qindëshen më të afërt _____

_____ i rrumbullakuar në qindëshen më të afërt _____

_____ i rrumbullakuar në qindëshen më të afërt _____

3 Kontrollo detyrat e Martës dhe Erës. Ata i rrumbullakuan numrat me katër shifra në qindëshen më të afërt. Shlyej rezultatet e pasakta.

Numri	Marta	Era
3458	3400	3500
6541	6500	6400
8893	8900	8800
5683	5700	5700
2191	2200	2100
3256	3200	3300
7444	7400	7500
5555	5600	5600

4400

1400

5800

2200

6400

KRAHASIMI I ÇIFTEVE TË NUMRAVE TRESHIFRORË

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

Ivani i vendosi në boshtin numerik numrat 170 dhe 750 në këtë mënyrë.



Të mendojmë!

Në cilën anë të boshtit gjendet numri 750 në raport me numrin 170?

Cili nga këta dy numra është më i madh?

Numri 750 është më i madh se numri 170.

Në këtë rast, vendvlera më e madhe e këtyre dy numrave është qindëshja. Meqenëse numri i dytë ka numrin 7 në vendin e qindësheve, themi se është më i madh.

NUMRAT DERI NË 10000



Nga dy numrat trefishrorë, më i madh është numri që ka shifër me vlerë numerike më të lartë në klasën e qindësheve.

1 Shëno numrat që janë më të mëdhenj se 560, por më të vegjël se 570.

2 Shënoni me numra rendorë, nga më i vogli te më i madhi, sipas shembullit.

Q	Dh	Nj	
5	7	8	
3	2	4	
8	6	7	
9	8	2	
2	3	1	
4	5	9	
1	4	6	1

MBAJ MEND!

NËSE NË DY NUMRA TRESHIFRORË, NUMRI I QINDËSHEVE ËSHTË I NJËJTË, ATËHERË AI QË KA NUMËR MË TË MADH NË VENDIN E DHJETËSHEVE ËSHTË MË I MADH. P.SH. **234 DHE 254 – NUMRI 254 ËSHTË MË I MADH**. NËSE NË DY NUMRA TRESHIFRORË, NUMRI I QINDËSHEVE E DHJETËSHEVE ËSHTË I NJËJTË, ATËHERË AI QË KA NUMËR MË TË MADH NË VENDIN E NJËSHEVE ËSHTË MË I MADH. P.SH. **447 DHE 441 – NUMRI 447 ËSHTË MË I MADH.**

3 Monika lexoi 232 faqe të një libri. Dea lexoi 223 faqe të të njëjtit libër, kurse Bela 322.

Cila lexoi më shumë faqe?
Cila lexoi më pak faqe?

4 Babi dhe mami kanë bërë pazar në supermarkete të ndryshme. Ata kanë blerë produktet e njëjta . Babi shpenzoi 993 denarë dhe mami 939 denarë. Cili prej tyre ka bërë pazar në supermarketin më të lirë?

5 Plotësoni fjalitë me: "më i madh", "më i vogël" ose me një numër të caktuar për të qenë të saktë:

a) Numri 356 është _____ se numri 756.

b) Numri _____ është më i madh se numri 756.

c) Numri 102 është më i vogël se numri _____ .

ç) Numri 989 është _____ se numri 998.

d) Numri 447 është më i madh se numri _____.

6 Rretho numrin më të madh:

568	879	365	899
203	230	302	320
554	545	555	454

132	231	223	233
476	467	746	764
393	383	392	329

NUMRAT DERI NË 10000

Cili numër është më i madh, 3491 apo 3487?

Si do të zbulosh?

Hapi 1:
Shëno numrat njërin mbi tjetrin.

Hapi 2:
Krahaso numrat duke filluar nga vendvlera më e madhe e shifrave.

Hapi 3:
Rretho numrat e parë të ndryshëm.

MENDO:
8 dhjetëshe janë më pak se 9 dhjetëshe, prandaj, numri 3491 është më i madh se 3487

Mijëshe të njëjta

Qindëshe të njëjta

3491
3487

Numër i ndryshëm dhjetëshesh – 8 është më e vogël se 9

KRAHASIMI I ÇIFTEVE TË NUMRAVE KATËRSHIFRORË

1 Rretho në secilin varg:

a) 1200 1202 1204 1206

b) 7322 7900 7294 7109

c) 2120 3513 6128 4276

ç) 1099 1039 1093 1001

Numrat më të vogla të vargjeve.

a) 3209 3202 3200 3206

b) 2257 5 714 7854 1396

c) 9824 9 492 9399 9951

ç) 8080 8082 8084 8086

Numrat më të mëdha të vargjeve.

2 Toni ka ecur 6350 metra deri në shkollë, Mejremi 5435 metra, Samiri 7890 metra dhe Exhja 2980 metra. Plotëso tabelën duke filluar me fëmijën që jeton më larg shkollës.

Emri i fëmijës	Largësia nga shkolla

3 Shkruaj numrat që janë më të vegjël se 5660 dhe më të mëdhenj se 5652.

4 Në panairin e shkollës, nxënësit fituan 5.700 denarë nga kuleçtë e shitur. Ata fituan 4.290 denarë nga kiflet e shitura, 1.320 denarë nga kosi dhe 8.140 denarë nga byrekët.

a) Nga cilat produkte kanë fituar 5700?

b) Rrumbullakoni shumën e parave të marra nga shitja e kifleve në qindëshen më të afërt, kurse nga byrekët në mijëshen më të afërt?

5 Me shifrat 3, 4, 5, 6 përpilo numra katërshifrorë dhe shkruaji ato duke filluar nga më i vogli.



6 Shkruaj numrin më të vogël dhe më të madh nga shifrat e letrave.

KRAHASIMI I ÇIFTEVE TË NUMRAVE TRESHIFRORË DHE KATËRSHIFRORË

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

NUMRAT DERI NË 10000

Mos harroni:
Për të krahasuar numrat përdorim shenja:

më i madh >
më i vogël <
i barabartë =

Aktivitet në çifte:
Ti dhe shoku yt tërhiqni secili nga tri letra nga letrat me shifra. Formoni nga një numër treshifror si në këtë figurë.

4	5	0

8	5	0

Përsërisni procedurën disa herë, duke e ndryshuar vendin e shifrave.

Përsërisni procedurën disa herë, duke e ndryshuar vendin e shifrave.

Në jetën e përditshme, shpesh krahasojmë dukuri ose objekte. **P.sh.**: Cili liqen është më i thellë? Cila shkollë në Shkup ka më shumë nxënës? Kush është më i moshuari në familjen tonë?

Vlerat që i krahasojmë mund të jenë më të mëdha se, më të vogla se, ose të barabarta ndërmjet tyre.

1 Krahaso numrat:

> < =

707 ☐ 770 356 ☐ 365

510 ☐ 150 999 ☐ 1000

2 Mendo tri shifra. Prej tyre përpilo dy numra treshifrorë, shënoji dhe më pas krahasoji me shenjë krahasimi.

☐☐☐ ◯ ☐☐☐

3 Formo dy numra treshifrorë sipas figurës. Krahasoji me shenjë krahasimi:



_____

4 Shkruani një nga shenjat për krahasimin e numrave, në mënyrë që pohimet të jenë të sakta:

a) 8478 ____ 8487 b) 5674 ____ 5670 c) 4856 ____ 4856

ç) 7917 ____ 8400 d) 3540 ____ 3450 dh) 1009 ____ 1090

e) 539 ____ 5390 ë) 765 ____ 7100 f) 2090 ____ 2109

5 Shkruani numrat në vendet e duhura, në mënyrë që krahasimet të jenë të sakta.

3093 3903 3309 9309

[ ] > [ ] > [ ] > [ ]

6478 8674 7468 6874

[ ] > [ ] > [ ] > [ ]

6 Në vend të yjeve, shkruaj numra për të fituar pohime të sakta.

a) 3489 > 3 4*9 b) 7**3 > 3 211 c) 721* < * 888

ç) 8409 > 6 *32 d) 9580 > 9 *8* dh) * 609 > * *2*

7 Plotësoni me njërën nga shenjat **<, =, >** për të qenë e saktë:

a) dyfishi i 2000 ____ gjysma e 6000.

b) një e treta e 3000 ____ 1000.

c) gjysma e 7000 ____ dyfishi i 3000.

ç) një e katërta e 10000 ____ gjysma e 5000,

NUMRAT DERI NË 10000

RENDITJA E NUMRAVE DERI NË 10000 SIPAS MADHËSISË ME SHENJAT < = >

Mësuesja u dha nxënësve si detyrë të krahasojnë numrat **6795** dhe **6695** me një nga shenjat e krahasimit.

Nxënësit e zgjidhën detyrën dhe morën rezultate të ndryshme, kështu që mësuesi u kërkoi atyre të shpjegojnë pse vendosën të përdorin shenjën e zgjedhur ndërmjet numrave.

Çfarë mendoni ju?

Cili nga nxënësit e vendosi shenjën e duhur?

Pse mendoni kështu?

Zgjidhje:	Shpjegime:
Nxënësi 1: **6795 > 6695**	**Shifra e qindësheve është më e madhe te numri i parë.**
Nxënësi 2: **6795 = 6695**	**Dy shifrat e fundit janë të njëjta.**
Nxënësi 3: **6795 < 6695**	**Mendoj se kjo shenjë tregon se numri i parë është më i madh se i dyti.**

Së pari i krahasojmë shifrat e një mijësheve	Nëse numrat kanë shifra të njëjta të njëmijësheve, krahasojmë qindëshet	Nëse numrat kanë shifra të njëjta të njëmijësheve dhe qindësheve, krahasojmë dhjetëshet	Nëse numrat kanë shifra të njëjta të njëmijësheve, qindësheve dhe dhjetësheve, krahasojmë njëshet.
NjM Q Dh Nj 3 5 6 8 5 4 6 7	NjM Q Dh Nj 7 5 3 6 7 2 4 1	NjM Q Dh Nj 9 5 6 8 9 5 3 6	NjM Q Dh Dh 8 4 4 6 8 4 4 9
3566 < 5467	7536 > 7241	9568 > 9536	8446 < 8449

1 Krahaso numrat dhe në tabelat me vendvlerat, shpjego zgjidhjen tënde:

5348 ◯ 2396 1874 ◯ 1921 2368 ◯ 2390 9373 ◯ 9371

NjM	Q	Dh	Nj

NjM	Q	Dh	Nj

NjM	Q	Dh	Nj

NjM	Q	Dh	Nj

2 Majat më të njohura në Malin Sharr janë Maja e Titos me 2748 metra lartësi dhe Turkut të Vogël me 2702 metra lartësi. Krahaso këto dy maja dhe shpjego: cila është më e larta dhe si arritët në këtë përfundim?

NjM	Q	Dh	Nj

3 Përgjigju pyetjeve:

- Cili është numri më i vogël treshifror dhe pse?

_____

- Cili është numri më i madh treshifror dhe pse?

_____

- Cili është numri më i vogël katërshifror dhe pse?

_____

- Cili është numri më i madh katërshifror dhe pse?

_____

4 Plotëso me njërën prej shenjave **>**, **=**, **<** , që të jetë e saktë:

a) dyfishi i 20 ____ gjysma e 10

b) gjysma e 20 ____ dyfishi i 10

c) 545 m____ 454 m

ç) 800 cm ____ 808 cm

d) 120 sekonda ____ 210 sekonda

dh) 62 ____ dyfishi i 26

e) 8 dhjetëshe____ 80 njëshe

ë) 4500 l____ 450l

NUMRAT DERI NË 10000

RENDITJA E NUMRAVE DERI NË 10000 SIPAS MADHËSISË



Vlerësojmë dhe hulumtojmë



Të rikujtojmë!
Në këto numëratore pozicionimi janë paraqitur tri numra katërshifrorë. T'i shkruajmë numrat, kurse pastaj t'i krahasojmë:



5200 > **3200** > **2400**

Në këtë mënyrë, ne i kemi renditur numrat sipas madhësisë me shenjat e krahasimit.

1 Në këtë bosht numerik, shkruaj numrat nga 5690 deri në 5699. Vendos shenjë krahasimi ndërmjet numrave.

2 Renditi numrat duke filluar nga më i madhi. Vendose shenjën e duhur ndërmjet tyre.

3560 4120

2630 6710

1980 7100

3 Paraardhësit e numrave 3450, 2198, 6923, 5320 dhe 7537 renditi nga më i vogli te më i madhi.

Paraardhësit e tyre janë:

4 Pasardhësit e numrave 6678, 2134, 5401, 2901 dhe 3900 renditi nga më i madhi te më i vogli duke përdorur shenja krahasimi.

5 Vendose numrat në vendin e duhur.

3093 3903 3309 9309

[ ] > [ ] > [ ] > [ ]

6478 8674 7468 6874

[ ] > [ ] > [ ] > [ ]

4069 467 4670 6740

[ ] < [ ] < [ ] < [ ]

9090 9900 9009 9990

[ ] < [ ] < [ ] < [ ]

6 Në një ëmbëltore, në një muaj u shitën 3560 akullore me shije vaniljeje. Pronari i ëmbëltores i renditi të dhënat sipas numrit të akulloreve të shitura. Për të zbuluar se sa akullore me shije të tjera janë shitur, shtoni ose hiqni nga 20.
Sa akullore me lajthi dhe sa me çokollatë janë shitur? Krahasoni shitjet e akulloreve me dredhëza dhe kikirikë.

Shije e akullores	Të shitura
çokollatë	
kikirikë	
dredhëz	
vanilje	3560
lajthi	

TEMA 1

KRAHASIMI I ÇIFTEVE TË NUMRAVE TRESHIFRORË OSE KATËRSHIFRORË



KRAHASIMI I ÇIFTEVE TË NUMRAVE TRESHIFRORË OSE KATËRSHIFRORË

Zgjedh një numër në boshtin numerik. Cili është numri që vjen para dhe cili qëndron pas tij? Cili është pozicioni i numrit të zgjedhur?



Vlerësojmë dhe hulumtojmë

Vitin e kaluar në një fabrikë kishte 1 punëtor më pak se këtë vit. Ishin 3256.

Këtë vit në fabrikën e njëjtë ka _____ punëtorë.

Nëse vitin e ardhshëm punësohet edhe një punëtor tjetër, do të ketë _____ punëtorë.

1 Shkruaj paraardhësit dhe pasardhësit e këtyre numrave:

	4568	
	3333	

	8975	
	7799	

	5002	
	6449	

2 Plotëso vargjet me numrat që mungojnë:

a) 4109, _____, 4111, _____, 4113, _____, 4115

b) 2000, _____, 2002, _____, 2004, _____, 2006

c) 8881, _____, 8883, _____, 8885, _____, 8887

3 Gjej dhe shkruaj numrat që duhet të jenë ndërmjet:

a) 1009 _____ 1013

b) 7340 _____ 7344

c) 5090 _____ 5110

ç) 2007 _____ 2013

4 Në boshtin numerik shëno numrat që mungojnë.

5 Në boshtin numerik, gjej vendin dhe shëno numrin që gjendet ndërmjet numrave 5000 dhe 7000.

6 Gjyshi dhe gjyshja kanë moshën e njëjtë. Nëse i mbledhim vitet e tyre, vitin e kaluar ata kishin 140 vjet. Vitin e ardhshëm ata do të kenë gjithsej 144 vjet.

a) Sa vjet kanë gjithsej këtë vit?

b) Sa vjet ka secili prej tyre këtë vit?

TEMA 1

NUMRAT NEGATIVË

NUMRAT NEGATIVË, NUMRA MË TË VOGLA SE ZERO

NUMRAT NEGATIVË - VAZHDIMI I VARGUT TË NUMRAVE

NUMRAT NEGATIVË



NUMRAT NEGATIVË, NUMRAT MË TË VOGLA SE ZERO

Shëno temperaturat e dhëna me të kuqe.

Shkup 12 °C

Krushevë −4 °C



Berovë −6 °C



Tetovë 0 °C



Ohër 5 °C



1 Shëno në termometër temperaturat e matura:

Shtip	Ponikvë	Gostivar	Manastir	Dojran	Kozhuf
–3 °C	–5 °C	8 °C	6 °C	10 °C	–4 °C



2 Paraqiti temperaturat e marra nga termometrat në detyrën 1 në boshtin numerik.



a) Sa është ndryshimi i temperaturës ndërmjet Manastirit dhe Kozhufit?

b) Shëno temperaturat për Berovën (-6 °C) dhe Gostivarin (6 °C) në boshtin numerik.

3 Plotëso tabelën sipas kërkesave të temperaturave të matura.

Qyteti	Temperaturat e matura në muajin shkurt
Prilep	3 °C
Strugë	
Kriva Pallankë	–6 °C
Radovish	
Dibër	
Shkup	–4 °C
Strumicë	
Koçan	

Plotësoje tabelën me pohimet e mëposhtme.

Në Strugë është 2 gradë më ngrohtë se në Kriva Pallankë.
Në Strumicë është 9 gradë më ngrohtë se në Shkup.
Në Radovish është 1 gradë më ftohtë se në Strugë.
Në Dibër është 1 gradë më ngrohtë se në Strugë.
Në Koçan është 3 gradë më ftohtë se në Prilep



NUMRAT NEGATIVË - VAZHDIMI I VARGUT TË NUMRAVE

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

NUMRAT NEGATIVË

Kur në një bosht numerik numërojmë nga e majta në të djathtë, numrat rriten, por kur numërojmë nga e djathta në të majtë, numrat zvogëlohen.

E RËNDËSISHME:
-5 është më i vogël se -2

Kur fillojmë të numërojmë nga prapa në boshtin numerik nga numri 4, për 6 numra do të arrijmë në -2.





1 Duke përdorur boshtin numerik, paraqite numrin që do ta fitosh.

a) Fillo nga numri -5 dhe numëro 8 përpara. Cilin numër e fitove?



b) Fillo nga numri 4 dhe numëro 7 nga prapa.



c) Fillo nga numri 1 dhe numëro 5 nga prapa.



ç) Fillo nga numri 6 dhe numëro 6 nga prapa.



2 Krahaso numrat:

-3 ☐ -6

-5 ☐ 4

-4 ☐ -1

2 ☐ -4

-3 ☐ 0

5 ☐ -5

3 Renditi numrat që vijojnë duke filluar nga më i vogli.

0 → 7 → -3 → -6 → 4 → 6 → -1 →

4 Temperatura në Mavrovë në mëngjes ishte 4 gradë nën zero, në mesditë u rrit për 5 gradë, kur u errësua temperatura ra për 2 gradë. Sa ishte temperature në Mavrovë në mëngjes, në mesditë dhe në mbrëmje?



TEMA 1

THYESAT

THYESAT E RREGULLTA

THYESAT E RREGULLTA, PJESË E FORMAVE DHE NUMRAVE

KRAHASIMI DHE RENDITJA E THYESAVE

THYESAT E BARABARTA

PARAQITJA E THYESAVE TË RREGULLTA NË BOSHTIN NUMERIK

PARAQITJA DHE KRAHASIMI I THYESAVE TË BARABARTA

NUMRAT E PËRZIER

NUMRAT DHJETORË ME NJË SHIFËR PAS PRESJES DHJETORE

THYESAT E RREGULLTA

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

Numëruesi

$$\frac{1}{8}$$

Vija thyesore

Emëruesi

THYESA

Thyesat i hasim dhe i përdorim shpesh në jetën e përditshme:

- Në byrektore...
- Në piceri...
- Në supermarkete...
- Në farmaci...
- Në muzikë...

Le ta zbulojmë rëndësinë dhe të fshehtat e thyesave.

Çfarë përfaqësojnë thyesat?

Emëruesi tregon se në sa pjesë është ndarë njësia e plot.

Numëruesi tregon pjesët që janë shënuar (ngjyrosur).

Vija thyesore e zëvendëson shenjën e pjesëtimit (:).

Numri që përmban një ose disa pjesë të njësisë së plot quhet THYESË.

1 Shëno me thyesë pjesën e ngjyrosur nga njësia e plot.



2 Ngjyrose një pjesë të vizatimit sipas thyesës pranë saj.



3 Lidhe figurën me thyesën, së cilës i përgjigjet pjesa e ngjyrosur nga njësia e plot.



THYESAT

Në një çantë ka 10 kube. Nxirr një kub. Kubin e nxjerrë, si thyesë, e paraqesim në mënyrën vijuese, që është

$\frac{1}{10}$ e kubeve.

Kubet e mbetura në çantë i shënojmë si thyesë:

$\frac{9}{10}$ e kubeve.

mbetën në çantë.



THYESATE RREGULLTA, PJESË E FORMAVE DHE NUMRAVE

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

Le të bëjmë disa tërheqje të tjera si kjo, duke tërhequr më shumë kube:

a) Ka _____ kube në çantë. Unë marr _____ kube. Kjo është _____e kubeve. _____mbetën në çantë.

b) Ka _____ kube në çantë. Unë marr _____ kube. Kjo është _____ e kubeve. _____ mbetën në çantë.

c) Ka _____ kube në çantë. Unë marr _____ kube. Kjo është _____ e kubeve. _____ mbetën në çantë

1 Në bibliotekën e shkollës për nxënësit e klasës së e parë deri në klasën e pestë arritën 20 lektyra.

$\frac{1}{5}$ e tyre ishin lektyra për klasën e katërt.

Lektyrat e tjera u ndanë në mënyrë të barabartë midis klasave të tjera. Nga sa lektyra kishte për secilën klasë?

2 Torta e ditëlindjes së Millës ishte prerë në 8 pjesë të barabarta. Milla hëngri një të tetën e tortës. Sa pjesë të tortës kanë ka mbetur?



3 Sa është?

a) $\frac{1}{2}$ e 2 l =

b) $\frac{1}{4}$ e 100 denarë =

c) $\frac{3}{6}$ e 12 m =

ç) $\frac{4}{8}$ e 1 km =

4 Paraqiti me thyesa pjesët e ngjyrosura të formave të dhëna 2D.



KRAHASIMI DHE RENDITJA E THYESAVE

THYESAT

2 Renditi thyesat duke filluar nga thyesa më e vogël tek ajo më e madhe.

$\frac{1}{2}, \frac{2}{6}, \frac{2}{2}$ ____, ____, ____

$\frac{1}{6}, \frac{1}{2}, \frac{1}{3}$ ____, ____, ____

1 Ngjyrosi shiritat sipas thyesave të dhëna.

$\frac{4}{6}, \frac{4}{4}, \frac{4}{8}$

1

$\frac{1}{6}$	$\frac{1}{6}$	$\frac{1}{6}$	$\frac{1}{6}$	$\frac{1}{6}$	$\frac{1}{6}$

$\frac{1}{4}$	$\frac{1}{4}$	$\frac{1}{4}$	$\frac{1}{4}$

$\frac{1}{8}$	$\frac{1}{8}$	$\frac{1}{8}$	$\frac{1}{8}$	$\frac{1}{8}$	$\frac{1}{8}$	$\frac{1}{8}$	$\frac{1}{8}$

Më e madhja është thyesa

_____

Më e vogla është thyesa

_____

Midis tyre është thyesa

_____

3 Renditi thyesat duke filluar nga thyesa më e madhe tek ajo më e vogël.

$\frac{6}{6}, \frac{2}{6}, \frac{5}{6}$ ____, ____, ____ $\frac{1}{8}, \frac{1}{4}, \frac{1}{2}$ ____, ____, ____

4 Duke e përdorur murin e thyesave, shkruaj shenjën e duhur < , > ose =.



$\frac{1}{6} \bigcirc \frac{1}{4}$ | $\frac{1}{8} \bigcirc \frac{1}{8}$ | $\frac{2}{8} \bigcirc \frac{2}{3}$

$\frac{2}{4} \bigcirc \frac{1}{2}$ | $\frac{7}{8} \bigcirc \frac{3}{8}$ | $\frac{5}{6} \bigcirc \frac{2}{3}$

$\frac{2}{4} \bigcirc \frac{3}{4}$ | $\frac{6}{6} \bigcirc \frac{6}{8}$ | $\frac{3}{4} \bigcirc \frac{7}{8}$

5 Shqyrto diagramin dhe barazimin numerik.

$\frac{1}{3}+\frac{1}{3}+\frac{1}{3}=\frac{3}{3}=1$

Në mënyrën e njëjtë plotëso barazimet numerike.

a)

$\frac{1}{4}+$ _____ $=\frac{4}{4}=1$

b)

$\frac{1}{8}+$ _____ = _____ = _____

c)

_____ = _____ = _____

ç)

_____ = _____ = _____

1 Paraqit me thyesë se ç'pjesë e picave është ngrënë dhe cila ka mbetur.

Shkruaj në tabelë.

			Zgjidh sa copa janë ngrënë.	Zgjidh sa copa ka dhe sa janë ngrënë.
të ngrëna $\frac{3}{5}$	të ngrëna	të ngrëna	të ngrëna	të ngrëna
të pangrëna $\frac{2}{5}$	të pangrëna	të pangrëna	të pangrëna	të pangrëna

2 Në një fabrikë punonin 120 punëtorë. $\frac{1}{4}$ prej tyre ishin gra.

Sa burra punonin në fabrikë?



THYESAT

THYESAT E BARABARTA

Palose një fletë letre në gjysmë. Ngjyrose $\frac{1}{2}$ e letrës.

Përsëri palose fletën në katër pjesë të barabarta. Vini re se sa të katërta janë të ngjyrosura?

Vazhdo me palosjen dhe palose në tetë pjesë të barabarta.

Sa të teta janë të ngjyrosura?

Si përfundim : $\frac{1}{2} = \frac{\quad}{4} = \frac{\quad}{8}$

Këto thyesa quhen thyesa të barabarta.

1 Plotësoje murin e dhënë me thyesa. Në mur shihen thyesa me madhësi të njëjtë.



2 Janë dhënë tabelat e shumëzimit me 4 dhe shumëzimit me 1:

·1	1	2	3	4	5	6
·4	4	8	12	16	20	24

	Ngjyros 1 pjesë prej 4 pjesëve	Ngjyros 2 pjesë prej 8 pjesëve	Ngjyros 3 pjesë prej 12 pjesëve	Ngjyros 4 pjesë prej 16 pjesëve	Ngjyros 5 pjesë prej 20 pjesëve	Ngjyros 6 pjesë prej 24 pjesëve
						

Çfarë vëren në lidhje me thyesat e ngjyrosura në secilën kolonë?

Shkruaj disa thyesa të barabarta me $\frac{1}{4}$.

3 Paraqiti thyesat e barabarta të treguara në grafikë

$\frac{1}{2}$ =

$\frac{1}{4}$ =

$\frac{1}{3}$ =

$\frac{1}{5}$ =

$\frac{2}{3}$ =

$\frac{1}{2}$ = $\frac{2}{4}$ = $\frac{3}{\ }$ = — = —

— = —

— = —

— = — = —

— = — = —

4 Emërtoje secilën thyesë dhe lidhi thyesat e barabarta. Ja një shembull:

$\frac{1}{2}$ është e barabartë me $\frac{4}{8}$



5 Rrethoje thyesën që nuk është e barabartë me dy të tjerat.

Për shembull: $\frac{1}{5}$ $\frac{3}{8}$ $\frac{2}{10}$

a) $\frac{1}{2}$ $\frac{4}{8}$ $\frac{2}{5}$

b) $\frac{6}{8}$ $\frac{3}{4}$ $\frac{4}{10}$

c) $\frac{6}{10}$ $\frac{3}{4}$ $\frac{3}{5}$

ç) $\frac{2}{8}$ $\frac{4}{10}$ $\frac{1}{4}$

d) $\frac{2}{3}$ $\frac{4}{6}$ $\frac{1}{2}$

dh) $\frac{4}{10}$ $\frac{2}{5}$ $\frac{1}{2}$

e) $\frac{4}{5}$ $\frac{7}{8}$ $\frac{8}{10}$

h) $\frac{2}{3}$ $\frac{3}{5}$ $\frac{6}{10}$

6 Në rrjetin e katrorëve skiconi forma, në mënyrë që $\frac{3}{4}$ e formës të jetë në një ngjyrë ndërsa $\frac{1}{4}$ në ngjyrë tjetër. Shëno numrin e katrorëve të përdorur.

Skica 1	Skica 2	Skica 3
Numri i katrorëve _____	Numri i katrorëve _____	Numri i katrorëve _____

Sa është numri i katrorëve që përmban forma juaj 2D?

Sa janë të ngjyrosur menjërën ngjyrë dhe sa me një ngjyrë tjetër?

PARAQITJA E THYESAVE TË RREGULLTA NË BOSHTIN NUMERIK

1 Shkruaj secilën nga thyesat e dhëna pranë ose poshtë thyesës të barabartë me të në boshtin numerik.

a)



$\frac{3}{4}, \frac{1}{8}, \frac{1}{2}, \frac{7}{8}, \frac{1}{4}, \frac{5}{8}, \frac{3}{8}$

b)



$\frac{3}{5}, \frac{1}{10}, \frac{1}{2}, \frac{4}{5}, \frac{3}{10}, \frac{7}{10}, \frac{2}{5}, \frac{9}{10}, \frac{1}{5}$

c)



$\frac{1}{2}, \frac{1}{6}, \frac{5}{6}, \frac{2}{3}, \frac{1}{3}$

2 Shkruaj nga gjashtë thyesa në secilën pjesë të tabelës:

Më e vogël se (<) $\frac{1}{2}$	Më e madhe se (>) $\frac{1}{2}$



3 Shiko me kujdes murin me thyesa.

Muri i thyesave do të na ndihmojë që të krahasojmë më lehtë!

Cilat thyesa janë paraqitur?

Diskuto me shokun.
Shkruaj të gjitha thyesat:





THYESAT

PARAQITJA DHE KRAHASIMI I THYESAVE TË BARABARTA

1 Shkruaj një thyesë të barabartë me thyesën e dhënë:

a) $\frac{1}{5} =$ _____

b) $\frac{1}{2} =$ _____

c) $\frac{3}{5} =$ _____

ç) $\frac{2}{8} =$ _____

d) $\frac{3}{4} =$ _____

dh) $\frac{4}{10} =$ _____

2 Përdore murin e thyesave për t'i gjetur thyesat midis $\frac{1}{4}$ dhe $\frac{1}{2}$



3 A janë këto pohime të sakta apo të gabuara? Rretho përgjigjen e saktë.

Për shembull:
$\frac{1}{2}$ vogël se $\frac{2}{3}$. e saktë/e gabuar

a) $\frac{3}{4} = \frac{6}{8}$ e saktë/e gabuar

b) $\frac{6}{10} > \frac{1}{2}$ e saktë/e gabuar

c) $\frac{1}{4} = \frac{3}{8}$ e saktë/e gabuar

ç) $\frac{3}{10} = \frac{3}{8}$ e saktë/e gabuar

d) $\frac{2}{5} = \frac{4}{10}$ e saktë/e gabuar

NUMRA TË PËRZIER

THYESAT

MBAJ MEND!

Çka është numri i përzier?

Çdo **numër** i **përbërë** nga një numër i plotë dhe nga një thyesë quhet **numër i përzier.**

PARAQITJA E NUMRIT TË PËRZIER

$2\frac{1}{2}$

Si fitohet numri i përzier?



1

Secilën paraqitje grafike shprehe me thyes dhe numër të përzier.

Paraqitje grafike	Thyesë	Numër i përzier

a) ___

b) ___

c) ___

ç) ___

d) ___

dh) ___

e) ___

ë) ___

f) ___

g) ___

2 Në tabelë është paraqitur në vite, grupmosha e disa grupeve të miqve.

Rendite secilin grup sipas madhësisë, duke filluar nga grupmosha më e re:

$6\frac{1}{4}$ vjet $9\frac{2}{3}$ vjet $8\frac{3}{4}$ vjet $7\frac{1}{6}$ vjet $8\frac{1}{4}$ vjet	_____ < _____ < _____ < _____ < _____
$8\frac{1}{3}$ vjet $9\frac{1}{3}$ vjet $8\frac{1}{6}$ vjet 9 vjet $8\frac{1}{2}$ vjet	_____ < _____ < _____ < _____ < _____
$7\frac{2}{3}$ vjet $7\frac{3}{4}$ vjet $7\frac{1}{4}$ vjet $7\frac{1}{2}$ vjet 7 vjet	_____ < _____ < _____ < _____ < _____



3 Paraqite thyesën e rregullt dhe numrin e përzier në boshtin numerik.
Rretho thyesën që është më afër numrit 1.



a) $1\frac{1}{4}$ dhe $\frac{5}{8}$

b) $\frac{3}{4}$ dhe $1\frac{3}{8}$

c) $1\frac{2}{5}$ dhe $\frac{9}{10}$



ç) $\frac{7}{8}$ dhe $1\frac{1}{2}$



d) $\frac{8}{10}$ dhe $1\frac{1}{5}$



NUMRA TË PËRZIER

THYESAT

1 Për $\frac{1}{4}$ orës, piqet një tepsi e madhe me biskota.

Furra merr vetëm një tepsi.

Sa orë duhen për t'u pjekur biskotat:

a) Për 6 tepsi me biskota duhen ____ orë..
b) Për 9 tepsi me biskota duhen ____ orë..
c) Për 11 tepsi me biskota duhen ____ orë..
ç) Për 21 tepsi me biskota duhen ____ orë..
d) Për 17 tepsi me biskota duhen ____ orë..
dh) Për 45 tepsi me biskota duhen ____ orë..

2 Çdo ditë në mëngjes, në ëmbëltore ekspozohen 10 torta të llojeve të ndryshme.
Në fund të ditës, pastiçeri kontrollon sa torta kanë mbetur nga secili lloj.

Njeshoni sa torta janë shitur prej secilit lloj.

Sasia e tortave (prej 10)	Mbetën	U shitën
	$4\frac{3}{4}$	$5\frac{1}{4}$
		
		

NUMRA DHJETORË ME NJË SHIFËR PAS PRESJES DHJETORE

Maria bleu çokollatë dhe e ndau atë në 10 pjesë të barabarta. Ajo i dha katër pjesë vëllait të saj Ivanit.

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

THYESAT



Sa çokollatë hëngri Maria dhe sa vëllai i saj?

_____

_____

1 Në një thyesë dhjetore, presja dhjetore e ndan numrin e plotë nga thyesa.
Vendi i parë pas presjes tregon dhjetat.

Cila pjesë e secilës thyesë është hijezuar?
Shkruaji pjesët si thyesa dhe si thyesa dhjetore.



_____ _____



_____ _____



_____ _____



_____ _____



_____ _____



_____ _____



_____ _____



_____ _____

2

a) $\frac{1}{2}$ 0,3; shtatë të dhjetat _____

b) 0,9; gjysma; tri të dhjetat _____

c) gjashtë të dhjetat; 1; 0,8 _____

ç) $\frac{4}{10}$; $\frac{1}{10}$; 0,5 _____

d) 2; 1,9; gjysma _____

dh) 3,8, 4,2, 4 _____

e) katër dhe tri të dhjetat; 4,5; 3 $\frac{9}{10}$ _____

3

Shikoje boshtin numerik
Pranë secilës shigjetë, shkruaje numrin në formë dhjetore.



_____ _____ _____ _____ 2,1 _____ _____

4

Secili prej drejtkëndëshave është ndarë në pjesë të barabarta dhe në secilin prej tyre është ngjyrosur një numër i ndryshëm i pjesëve të tilla. Shkruaje në formën e një thyese dhe një numri dhjetor pjesën e ngjyrosur të secilit prej drejtkëndëshave.

thyesa _____

numri dhjetor _____

thyesa _____

numir dhjetor _____

thyesa _____

numri dhjetor _____

thyesa _____

numri dhjetor _____

5 Në secilin prej rrathëve vendos shenjën >, < ose =.

$\frac{3}{10}$		0,3
$\frac{1}{2}$		$\frac{6}{10}$
1		0,7
0,2		$\frac{3}{10}$
$\frac{1}{3}$		0,1
6,2		6,1



AKTIVITET Ju duhen letra me **thyesa me emëruesin 10**

$\left(\frac{1}{10}, \frac{2}{10}, \frac{3}{10}, \frac{4}{10}, \frac{5}{10}, \frac{6}{10}, \frac{7}{10}, \frac{8}{10}, \frac{9}{10}, 1\right)$

Një pako letrash me **numra dhjetorë me një shifër pas presjes dhjetore** (0,1; 0,2; 0,3; 0,4; 0,5; 0,6; 0,7; 0,8; 0,9; 1,0)

Letra me **thyesa me emëruesin pesë.** $\left(\frac{1}{5}, \frac{2}{5}, \frac{3}{5}, \frac{4}{5}, \frac{5}{5}\right)$

· Ndani letrat nëtre grupe dhe vendosini ato me pjesën e prapme.
· Tërhiq:
- dy letra nga pakoja me thyesa me emëruesin 10
- dy nga letrat me numra dhjetorë
- një nga pakoja me thyesa me emëruesin 5
· Renditi numrat, duke filluar nga më i vogli.
· Shkruaji ato me shenjën më të vogël se (<):

_____ < _____ < _____ < _____ < _____

· Përsërisni të njëjtën gjë me pesë letra të tjera.
· Përdorni të gjitha letrat.
· Shkruaj:

_____ < _____ < _____ < _____ < _____

_____ < _____ < _____ < _____ < _____

_____ < _____ < _____ < _____ < _____

_____ < _____ < _____ < _____ < _____

_____ < _____ < _____ < _____ < _____

PËRSËRISIM PËR NUMRAT DHJETORË

1

Shikoj dizajnin e secilit flamur.
Cila pjesë e secilit flamur është e ngjyrosur me ngjyrë të gjelbert?
Shkruaj përgjigjen me thyesë dhe numër dhjetor.
Njëri nga shembujt është i zgjidhur.



$\frac{2}{10}$	0,2						

2

Plotëso këto vargje numerike

a) 0,6; 0,7; 0,8; 0,9 ; 1,0 ; 1,1 ; 1,2; 1,3.
b) 1,7; 1,8; _____; _____; _____; _____; 2,3; 2,4.
c) 1,4; 1,3; 1,2; _____; _____; _____; 0,8; 0,7.
ç) 5,3; 5,2; 5,1; _____; _____; _____; _____; 4,6.
d) 3,5; 3,6; 3,7; _____; _____; _____; _____.
dh)10,5; 10,4; 10,3; 10,2; _____; _____; _____; _____.

3 Vizato flamurin tënd. Përdor dy ngjyra.
Ngjyrat që i përdore janë _____ dhe _____.

Vendosi ngjyrat që i zgjodhe.
Për secilën pjesë të ngjyrosur me ngjyrën e parë shkruaje me thyesë, kurse pjesën me ngjyrën e dytë shkruaje me numër dhjetor.

Ngjyra 1 ☐ Thyesa	Ngjyra 1 ☐ Thyesa	Ngjyra 1 ☐ Thyesa	Ngjyra 1 ☐ Thyesa
Ngjyra 2 ☐ Numri Dhjeto	Ngjyra 2 ☐ Numri Dhjeto	Ngjyra 2 ☐ Numri Dhjeto	Ngjyra 2 ☐ Numri Dhjeto

4 Plotëso tabelën duke shkruar një numër dhjetor të barabartë me thyesën e dhënë ose një thyesë që korrespondon me numrin dhjetor të dhënë.

Thyesa	Numri dhjetor
$\frac{1}{2}$	
	0,3
$\frac{1}{10}$	
	0,8
	0,7
$\frac{3}{5}$	
$\frac{3}{6}$	

ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE

1 Mateji kishte 24 karamele. Ai ia dha $\frac{1}{6}$ e tyre Ivës, $\frac{1}{3}$ Mihailit dhe $\frac{1}{4}$ Millës. Sa karamele mori secili prej tyre? Sa karamele i mbetën Matejit?

Iva mori $\frac{1}{6}$ e 24 karameleve ose _____ karamele.
Mihaili mori _____.
Milla mori _____.
Matejit i mbetën _____.



2 Një tabelë shahu ka gjithsej 64 katrorë. Gjysma e katrorëve janë të zinj. Sa katrorë të bardhë dhe sa të zinj ndodhen në tabelën e shahut?

3 Nga thyesat: $\frac{1}{2}$, $\frac{1}{4}$, $\frac{2}{3}$, $\frac{5}{6}$, $\frac{3}{4}$ shkruan thyesën përkatëse me emëruesin 12. Pastaj renditni thyesat e reja nga më e vogla te më e madhja.

4 Nën secilën figurë, shkruaj pjesën me ngjyra në formën e një thyese të numrit dhjetor.



Thyesa: _____
Numri dhjetor: _____



Thyesa: _____
Numri dhjetor: _____



Thyesa: _____
Numri dhjetor: _____



Thyesa: _____
Numri dhjetor: _____



Thyesa: _____
Numri dhjetor: _____

5 Janë dhënë disa numra dhjetorë. Renditi numrat dhjetorë sipas madhësisë, duke filluar nga më i vogli.

a) 3,1; 2,2; 4,5; 1,3; 1,6; 6,1.

_____ < _____ < _____ < _____ < _____ < _____

b) 10,6; 8,9; 7,6; 0,5; 5,1; 8,2.

_____ < _____ < _____ < _____ < _____ < _____

c) 0,8; 1,2; 0,3; 6,6; 8,3; 9,9.

_____ < _____ < _____ < _____ < _____ < _____

TEMA 2



GJEOMETRIA

1. GJYSMËDREJTËZA DHE KËNDI
2. FORMAT 2D
3. FORMAT 3D
4. BOSHTI I SIMETRISË
5. POZITA DHE LËVIZJA

GJEOMETRIA

GJYSMËDREJTËZA DHE KËNDI, FORMAT 2D, FORMAT 3D, BOSHTI I SIMETRISË, POZICIONI, LËVIZJA DHE DREJTIMI

PËR TEMËN

Me këtë temë, do të thelloni njohuritë tuaja për gjysmëdrejtëzën dhe këndin, format 2D dhe 3D, boshtin e simetrisë, pozicionin, lëvizjen dhe drejtimin.

Do të mësoni se çfarë është gjysmëdrejtëza dhe këndi, si dhe do të krahasoni këndet. Do të përshkruani, do të vizatoni dhe do të gruponi format 2D dhe 3D sipas kritereve të ndryshme, do të bëni rrjetin e kubit, të prizmit të drejtë me bazë katrore, të piramidës, do të vizatoni dhe do të numëroni boshtet e simetrisë në format 2D, do të përcaktoni pozicionin e një objekti dhe do të jepni drejtime për lëvizjet.

SFIDAT E MUNDSHME

Termat shumëkëndëshi i rregullt dhe shumëkëndësh i parregullt, janë vendosurpër herë të parë. Nxënësi ndihmohet që të kuptojë se një gjashtëkëndësh ka gjashtë brinjë, por jo gjithmonë ato duhet të kenë gjatësi të barabartë. Për format 3D, ushtrohen për numrin dhe llojin e faqeve që ndërtojnë, për numrin e teheve dhe për numrin e kulmeve. Ideja e vizualizimit dhe digjitalizimit i mbështet të gjitha aktivitetet. Kjo njësi lidhet edhe me artin.

Nxënësit kanë nevojë për shumë materiale për të konsoliduar të kuptuarit e vetive të tyre dhe për të zhvilluar aftësinë e tyre për vizualizimin e formave 2D dhe 3D.

Nxënësit i mbyllin sytë dhe ajo që "shikojnë" është forma. Termat prizëm dhe piramidë ndonjëherë ndodh që edhe të zëvendësohen.

Forma e piramidës egjiptiane mund t'i ndihmojë nxënësit të mbajnë mend ndryshimin. Nxënësit shpesh e gjejnë lehtësisht një bosht të simetrisë, por nuk mund të gjejnë më shumë boshte simetrie dhe kjo duhet të ushtrohet.

MATERIALET E NEVOJSHME DHE INSTRUMENTET MATËSE:

Kartonë të vizatuar me format 2D (të gjysmërrethit, shumëkëndëshit, shtatëkëndëshit, tetëkëndëshit, nëntëkëndëshit, dhjetëkëndëshit, dymbëdhjetëkëndëshit), modelet e formave 3D (të kubit, kuadrit, cilindrit, konit, prizmit, piramidës)



FJALOR
i termave të reja

- Gjysmëdrejtëza
- këndi
- këndi i drejtë
- këndi i gjerë
- këndi i ngushtë
- gjysmërrethi
- shumëkëndëshi
- shtatëkëndëshi
- tetëkëndëshi
- nëntëkëndëshi
- dhjetëkëndëshi
- dymbëdhjetëkëndëshi
- kubi
- kuadëri
- cilindri
- koni
- prizmi
- piramida
- 3D forma me faqe të rrafshëta
- 3D forma me faqe të lakuara
- vija e pasqyrës
- boshti i simetrisë
- vija e përputhjes
- rreshta
- kolona
- lëvizja
- rrotullimi
- drejtimi
- kahja
- 90°, 180°, 360°.

TEMA 2

GJYSMËDREJTËZA DHE KËNDI

GJYSMËDREJTËZA

KËNDI

KËNDI I DREJTË

LLOJET E KËNDEVE

KRAHASIMI I KËNDEVE – ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE



GJYSMËDREJTËZA

Drejtëz – quhet një vijë e gjatë pafundësisht, që vazhdon në të dyja anët e që nuk ka as fillim, as mbarim.

Pikë – quhet një pozicion i saktë ose vendndodhja e një objekti.

Drejtëzës i përkasin një pafundësi pikash, por ka edhe pika jashtë drejtëzës.



Segmenti është pjesë e drejtëzës e kufizuar nga dy pika. Ai i përmban të gjitha pikat e drejtëzës ndërmjet dy pikave të skajshme.

Themi se është dhënë segmenti AB nëse A dhe B janë pikat e skajshme të tij.

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Vija të drejta janë vijat me numrin: _____ Vija të lakuara janë vijat me numrin: _____

1 2 3 4 5 6 7

MBAJ MEND

GJYSMËDREJTËZA ËSHTË PJESË E DREJTËZËS, AJO KA NJË PIKËNISJE DHE MUND TË VAZHDOHET PAFUNDËSISHT NË NJË KAHJE.

A e dini çfarë është kjo?

2 Cila nga këto forma është gjysmëdrejtëz?



3 Ana e përshkroi formën e vizatimit si formë që ka dy pika përfundimtare dhe që mund të zgjatet pafundësisht në një drejtim.



A ka të drejtë Ana? Pse?

Themi se është dhënë gjysmëdrejtëza OA, nëse O është pika e saj e fillimit dhe A është pika e gjysmëdrejtëzës. E shënojmë: gjysmëdrejtëza OA

4 Tregoni si quhen format e vizatuara.



KËNDI

A është e mundur që dy gjysmëdrejtëza të kenë një pikënisje të përbashkët? Vizato!

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Gjej dhe lidh me shkronjën e duhur nënkëndet:



a) Këndi me kulmin në C

b) Këndi me krahët BA

c) Këndi me krahët AB dhe AC

2 Sipas vizatimit, shkruaj:



Këndi:_____ Kulmi: _____ Krahë: _____

Këndi:_____ Kulmi: _____ Krahë: _____

Këndi:_____ Kulmi: _____ Krahë: _____

GJYSMËDREJTËZA DHE KËNDI

MBAJ MEND

DY GJYSMËDREJTËZA QË KANË PIKË FILLESTARE TË PËRBASHKËT FORMOJNË **KËND**.
SHKRUAJMË: KËNDI **AOB**.
PIKA O QUHET KULMI I KËNDIT, KURSE GJYSMËDREJTËZAT OA DHE OB QUHEN **KRAHË**.





GJYSMËDREJTËZA DHE KËNDI

MBAJ MEND

NJËSIA PËR MATJEN E MADHËSISË SË KËNDIT QUHET **SHKALLË**.

Aktivitet: Matja e një këndi të drejtë duke përdorur një rreth letre të palosur në katër pjesë.

Aktivitet: Matja e një këndi të drejtë duke përdorur një trekëndësh. Matja e një këndi të drejtë me këndmatës.

Diskutim: Si duket vegla për matjen e këndeve?

MBAJ MEND

GJYSMËRRETHI ËSHTË FORMA 2D QË PËRFTOHET NËSE PALOSIM RRETHIN DHE PJESËT E PALOSURA I PËRPUTHIM.



Në një gjysmërreth, mund të vendosen dy kënde të drejta.

KËNDI I DREJTË

A mund të masim madhësinë e një këndi? Në cilën mënyrë? A ka ndonjë instrument matës?



Vlerësojmë dhe hulumtojmë

TË RIKUJTOJMË

KËNDI ME MADHËSI PREJ 90 SHKALLË QUHET KËND I DREJTË DHE E SHËNOJMË ME 90°.

Ky është kënd i drejtë.



1 Gjej dhe shkruaj emrat e disa objekteve rreth teje që kanë së paku një kënd të drejtë.

2 Sa kënde të drejta kanë format 2D? Shkruaj ato nën secilën formë!



3 Emërto dhe shkruaj trekëndëshat që kanë kënd të drejtë!



LLOJET E KËNDEVE



Cila nga këto tri kënde në vizatim është më e madhe?



Vlerësojmë dhe hulumtojmë

MBAJ MEND

MADHËSIA E KËNDIT NUK VARET NGA GJATËSIA E KRAHËVE TË TIJ.



KËND I DREJTË 90°



Ky kënd është më i vogël se këndi i drejtë dhe quhet **KËND I NGUSHTË**.



Ky kënd është më i madh se këndi i drejtë dhe quhet **KËND I GJERË**.

1 Vini re këndet e formuara nga akrepat e orëve! Tregoni si quhen ato!



A _____ B _____ C _____

D _____ E _____ F _____

2 Emërto këndet sipas llojit:



KËNDI	LLOJI
AEC	
AEB	
BEC	
AED	
CED	

3 Plotëso:
Shkalla është njësia e matjes për _____. Në varësi të madhësisë, këndi mund të jetë:
_____, _____ ose _____ .

4 Vizato një kënd të drejtë, një të gjerë dhe një të ngushtë. Shënoji dhe emërtoji.

5 Shëno me: ✓ ✗

Këndi i gjerë është më i vogël se 90°. ◯
Këndi i drejtë ka 90°. ◯
Këndi prej 30° është kënd i ngushtë. ◯
Këndi prej 60° është kënd i gjerë. ◯
Kënd i ngushtë është këndi më i madh se 90°. ◯

6 Vizato një kënd të drejtë me krahët G dhe T, një kënd të ngushtë me krahët D dhe P dhe një kënd të gjerë me krahët S dhe M. Kulmet shënoji sipas dëshirës. Emërto secilin me shenjat e tij.

KRAHASOJMË KËNDET – ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE

1 Nga sa kënde kanë figurat? Shkruaji dhe emërtoji si kënde të drejta, të gjera ose të ngushta.







2 Shiko figurën. Përcakto këndet sipas llojit dhe pastaj krahasoji.



KËNDI	LLOJI
AOB	
BOC	
COM	

KËNDI	LLOJI
BOM	
AOC	
AOM	

> = <

∢AOB ◯ ∢AOC ◯ ∢AOM

TEMA 2



FORMAT 2D

EMËRTIMI I FORMAVE 2D

VIZATIMI I FORMAVE 2D

PËRSHKRUAJMË DHE GRUPOJMË FORMA 2D

SHUMËKËNDËSHA TË RREGULLT DHE TË PARREGULLT

SITUATA PROBLEMORE ME FORMAT 2D



FORMAT 2D

EMËRTIMI I FORMAVE 2D

MBAJ MEND

KËNDI FORMOHET GJITHASHTU MIDIS DY SEGMENTEVE QË KANË NJË PIKË TË PËRBASHKËT FILLIMI OSE MBARIMI.

SHUMËKËNDËSH ËSHTË *FORMA E MBYLLUR 2D* E PËRBËRË NGA SEGMENTE TË NJËPASNJËSHME, KU PËRPUTHEN PIKA E FILLIMIT TË SEGMENTIT TË PARË DHE PIKA PËRFUNDIMTARE E SEGMENTIT TË FUNDIT.



ÇDO SHUMËKËNDËSH KA TRI OSE MË SHUMË KËNDE. ATA I QUAJMË SIPAS NUMRIT TË KËNDEVE: TREKËNDËSH, KATËRKËNDËSH, PESËKËNDËSH, GJASHTËKËNDËSH, SHTATËKËNDËSH, TETËKËNDËSH, NËNTËKËNDËSH, DHJETËKËNDËSH ...

Le të rikujtohemi!
Cilat nga format 2D i njeh në vizatimin e mëposhtëm?



Shkruaj emrat e tyre! Diskuto pse quhen me këto emra! A njeh ndonjë term matematikor gjatë emërtimit?



1 Ana vizatoi një formë 2D në fletoren e saj. Sa kënde mund të gjesh në këtë formë? Çfarë madhësie kanë? Përshkruaj ato! Si mund të quhet kjo formë?



2

Forma	Shembull	Numri i brinjëve	Numri i këndeve	Numri i kulmeve
Trekëndësh		3	3	3
Katërkëndësh		4	4	4
Pesëkëndësh		5	5	5
Gjashtëkëndësh		6	6	6
Shtatëkëndësh		7	7	7
Tetëkëndësh		8	8	8
Nëntëkëndësh		9	9	9

3 Sa brinjë dhe kënde kanë shumëkëndëshat? Rretho!

5 3 4



3 2 1



1 4 3



3 2 6



2 1 9



1 5 3



1 4 8



3 4 1



2 3 8



4 Plotësoje tabelën:

	EMRI	**Numri i brinjëve**	**Numri i këndeve**	**Numri i kulmeve**
		8		
	pesëkëndëshi			5
			7	
	trekëndëshi			3
	katërkëndëshi			
		6		
			9	

5 Ngjyros vetëm shumëkëndëshat me të cilët mund t'i formosh figurat e dhëna:







6 Sfidë: A paraqet shumëkëndësh çdo formë e mbyllur 2D?



7 Vendose numrin në vendin e duhur nën secilin prej shumëkëndëshave:



Katërkëndëshi_____; Pesëkëndëshi _____; Gjashtëkëndëshi _____;

Shtatëkëndëshi _____; Tetëkëndëshi _____; Nëntëkëndëshi _____;

VIZATIMI I FORMAVE 2D

FORMAT 2D

Në orën e matematikës Ema formoi me llastik një drejtkëndësh në gjeotabelë. Ardi me shkopinj formoi një gjashtëkëndësh.

Pastaj ata vendosën të vizatonin forma 2D në fletoret e tyre.

Ata për ta bërë këtë gjë kishin nevojë për këto vegla:

Vlerësojmë dhe hulumtojmë



Sanela përdori një fletë letre me pika, (letër izometrike) kurse me vizore i bëri format e mëposhtme:



1 Provo edhe ti të vizatosh ndonjë formë 2D në këtë hapësirë.



2 Vizato një shumëkëndësh që ka:

a) 4 brinjë të barabarta b) 5 kulme c) një kënd të drejtë

3 Le të përpiqemi të gjejmë ngjashmëritë dhe ndryshimet midis këtyre dy formave 2D.



MBAJ MEND

Format **katror dhe drejtkëndësh** janë katërkëndësha. Ata kanë 4 brinjë, 4 kulme dhe 4 kënde të drejta.
Dallimet: Te katrori: të gjitha brinjët kanë gjatësi të njëjtë.
Te **drejtkëndëshi**: dy nga dy brinjët kanë gjatësi të njëjtë.
Cilat janë dy brinjët e ndryshme?
Brinjët e një drejtkëndëshi që kanë një kulm të përbashkët janë të ndryshme për nga gjatësia.

Brinjët e tyre i shënojmë si më poshtë:



Mund të përdorësh edhe shkronja tjera p.sh m,n

4 Mat dhe shëno:

te katrori gjatësia e brinjëve është _____ cm.
te drejtkëndëshi, gjatësia e brinjëve është _____ cm, dhe _____ cm



Kulmet A dhe D, A dhe B **janë fqinjë**, kurse kulmet B dhe D janë të **kundërta** (**ose jo fqinjë**)

Sfidë: A është katrori drejtkëndësh? A është katror çdo drejtkëndësh? Pse?

5 Vizato një katror me brinjë 4cm.

6 Vizato një drejtkëndësh me brinjë: a = 3 cm, kurse b = 5 cm

FORMAT 2D

PËRSHKRUAJMË DHE GRUPOJMË FORMAT 2

1 Gjeje për cilën formë 2D bëhet fjalë?

Shumëkëndëshi me pesë brinjë dhe pesë kënde quhet _____.
Shumëkëndëshi me një kënd të drejtë me tre brinjë quhet _____.
Katërkëndëshi që ka vetëm kënde të drejta quhet _____, por nëse gjatësia e brinjëve është e barabartë, atëherë është _____.
Shumëkëndëshi që ka 2 brinjë më shumë se një gjashtëkëndësh quhet _____.

2 Shtatëkëndëshi ka _____ brinjë.
Katrori ka _____ kënde të drejta dhe _____ kënde të ngushta.
Nëse shumëkëndëshi është dhjetëkëndësh, atëherë ai ka _____ kulme

3 T'i grupojmë format 2D sipas ngjyrës

	△	○	□
E kuqe			
E gjelbër			
E kaltër			



4 Vendosi shkronjat nën format 2D në vendin e duhur



A B C Ç D DH





SHUMËKËNDËSHAT E RREGULLT DHE PARREGULLT

Le të mendojmë!
A kanë të gjithë shumëkëndëshat brinjë me të njëjtën gjatësi dhe këndë me të njëjtën madhësi?



Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Pranë çdo forme 2D shkruaj nëse është e rregullt ose e parregullt. Shënoji me R ose P.



FORMAT 2D

MBAJ MEND

THEMI SE SHUMËKËNDËSHAT JANË TË RREGULLT, NËSE TË GJITHA BRINJËT KANË TË NJËJTËN GJATËSI DHE TË GJITHA KËNDET KANË TË NJËJTËN MADHËSI.
TË PARREGULLT JANË SHUMËKËNDËSHAT QË KANË GJATËSI TË BRINJËVE DHE MADHËSI TË KËNDEVE TË NDRYSHME

Shumëkëndësha të rregullt



Shumëkëndësha të parregullt





FORMAT 2D

SITUATAT PROBLEMORE ME FORMAT 2D

1 Sa rrathë vëren në këtë formë?



Forma përmban ◯ rrathë.

2 Sa katrorë vëren në këtë formë?



Forma përmban ◯ katrorë.

3 Përfundo fjalitë:

a) Të gjitha këndet e drejtkëndëshit janë _____.

b) Nëse një shumëkëndësh ka 8 brinjë, atëherë ai ka _____ kulme.

c) Nëse i lidhim dy kulme jo fqinjë të katrorit, fitojmë _____.

4 Vizato një formë tjetër të njëjtë në vendin e zbrazët



Forma ka:

◯ Pesëkëndësha

◯ trekëndësha

◯ drejtkëndësha

◯ katror

TEMA 2

FORMAT 3D

TRUPAT ME SIPËRFAQE TË SHESHTË DHE TË LAKUAR

ELEMENTET E FORMAVE 3D ME FAQE TË SHESHTA:

KULMI, TEHU DHE FAQJA
FORMA 3D ME FAQE TË SHESHTA DHE TË LAKUARA;
ELEMENTET E FORMAVE 3D ME FAQE TË LAKUARA:
KULMI, FAQJA, MBËSHTJELLËSJA
LIDHJA MIDIS FORMAVE 2D DHE 3D

KRIJIMI I RRJETEVE TË FORMAVE 3D

LIDHJA NDËRMJET FORMAVE 2D DHE 3D – VIZATIMI I FORMAVE 3D

SITUATAT PROBLEMORE ME FORMA 3D

FORMAT 3D

FORMAT 3D ME SIPËRFAQE TË SHESHTË DHE TË LAKUAR

Vlerësojmë dhe hulumtojmë



Shiko objektet në figurë.
Përshkruaj ato!
A mund të dallosh disa nga format 3D që i di?

MBAJ MEND

FORMAT 3D QUHEN EDHE **TRUPA GJEOMETRIKË**

FORMAT 3D FORMOHEN NGA SIPËRFAQE TË SHESHTA OSE TË LAKUARA.



MBAJ MEND

DISA FORMA 3D KANË VETËM SIPËRFAQE TË SHESHTA. ATA QUHEN **TRUPA TEHORE**.



DISA FORMA TË TJERA 3D KANË SIPËRFAQE TË SHESHTA DHE TË LAKUARA OSE THJESHT SIPËRFAQE TË LAKUARA. ATO QUHEN **TRUPA ME SIPËRFAQE TË LAKUAR (TRUPA RROTULLUESE)**



1 Përcakto se çfarë sipërfaqesh kanë format 3D të dhëna më poshtë:

objekti	kubi	katrori	cilindri	piramida	sfera
sipërfaqe e sheshtë	✓				
sipërfaqe e lakuar					

2 Emërto format 3D në këtë figurë. A janë ato me sipërfaqe të sheshta apo të lakuara? Sa sipërfaqe të sheshta dhe sa të lakuara kanë këto forma 3D?



FORMA 3D

ELEMENTET E FORMAVE 3D ME FAQE TË SHESHTA: KULMI, BRINJA DHE FAQJA

✓ MBAJ MEND

PIKA KU TAKOHEN TRI TEHE QUHET **KULM**

SEGMENTI I PËRBASHKËT I DY FAQEVE QUHET **TEH**







Emërto trupat gjeometrikë. Shiko me kujdes vizatimin dhe përgjigju: Çfarë përfaqësojnë faqet e kubit, kuadrit dhe piramidës?

Sa faqe ka kubi, sa kuadri? A mund të zbulosh se sa faqe ka piramida? Nga se varet ai numër?

Shiko disa prizma dhe piramida. Trego si quhen! Trego ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet tyre!

Sa kulme ka kubi, sa ka kuadri?

Zgjidh një model piramide dhe përcakto numrin e kulmeve!

Zbulo nëse tehet e trupave me faqe të sheshta janë drejtëza, gjysmëdrejtëza ose segmente!

Zbulo sa tehe bashkohen në një kulm të kubit.

Vlerësojmë dhe hulumtojmë



1 Përcakto brinjët dhe kulmet e kuadrit ABCDEFGH.



2 Shëno kulmet e kubit me ngjyrë të kaltër! Emërto ato!



Tehet e kubit bëji më të trasha me ngjyrë të kuqe!



Tre faqe të kubit ngjyrosi me ngjyra të ndryshme!



3 Tre drejtkëndësha të kuadrit ngjyrosi me ngjyrë të ndryshme!



Tehet e kuadrit bëji më të trasha me ngjyra të ndryshme! Sa ngjyra do të përdorësh?



Shëno kulmet e kuadrit! Sa kulme janë?



3 Shiko dhe përshkruaj format 3D. Konstato ngjashmëritë dhe dallimet e tyre! Plotëso tabelën!

	Emri i formës 3D	Numri i kulmeve	Numri i teheve	Numri i faqeve
				
				
				
				

4 Aliu ka përshkruar trupin e të paraqitur në figurën e mëposhtme si në vijim: Kubi ka 8 tehe. Të gjitha tehet kanë gjatësinë e njëjtë. Faqet janë katrore dhe gjithsej ka 9 faqe. Tehu i përbashkët për faqet BCGF dhe FGHE është tehu CG. Ku ka gabuar Aliu?



FORMAT 3D ME FAQE TË SHESHTA DHE TË LAKUARA; ELEMENTET E FORMAVE 3D ME FAQE TË LAKUARA: KULMI, FAQJA, MBËSHTJELLËSJA

FORMA 3D



Trupat me faqe të sheshta janë: _____

Trupat me faqe të lakuara janë: _____

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Përshkruaj format:

Ka një faqe të sheshtë dhe një të lakuar. Ka një kulm. Ai është KONI.



_____

_____



_____

_____



_____

_____

_____

_____

2 Për secilën formë 3D përcakto numrin e faqeve, numrin e kulmeve. Pastaj shkruaj me sa faqe të sheshta dhe me sa të lakuara është i kufizuar trupi:

	Numri i faqeve	Numri i kulmeve	Numri i faqeve të sheshta	Numri i faqeve të lakuara
				
				
				
				
				
				
				

LIDHJA NDËRMJET FORMAVE 2D DHE 3D

Konstatuam se:

- Një kub ka gjashtë faqe.
- Faqet e kubit janë katrorë.
- Katrorët kanë gjatësinë e njëjtë të brinjës, duke i bashkuar katrorët sipas brinjëve mund të bëjmë një kub.

Le të bëjmë një kub!



Vlerësojmë dhe hulumtojmë

FORMAT 3D



1



2



1 Trego si quhen format 3D që fitohen nga rrjetet:













KRIJIMI I RRJETEVE TË FORMAVE 3D

1 Vizato një rrjet të prizmit katërkëndor që nuk është kub!

2 Vizato një rrjet të piramidës trekëndore!



3 Vizato dy prizma me numër të ndryshëm të faqeve!

4 Vizato dy piramida me numër të ndryshëm të kulmeve!



LIDHJA MIDIS FORMAVE 2D DHE 3D

FORMAT 3D

1. Ju duhet të projektoni një kënd të ri lojërash në oborrin e shkollës.
Në këndin tuaj të lojërave, duhet të ketë një tra për ruajtjen e baraspeshës, një kornizë për ngjitje dhe zgjatje, një luhatëse, një lojë të vizatuar për të luajtur duke kërcyer në sipërfaqe të tokës, një shteg për të ecur ...
Detyrat tuaja janë:

1. Projektoni traun e baraspeshës.

Sipas Jush, cila është forma më e mirë 3D për t'u përdorur për traun? Kini kujdes se si do ta bëni traun e qëndrueshëm. Cilat kënde do të përdorni?

2. Cilat forma do t'i përfshini në ndërtimin e kornizës për ngjitje dhe zgjatje?

3. Projektoni një lojë kërcimi. Përdorni të paktën tri forma të ndryshme 2D.

4. Bëni një model 3D të luhatëses. Kini kujdes se si do t'i bëni luhatëset e qëndrueshme. Cilat kënde do të përdorni? Cilat forma 2D? Pse?

5. Vizatoni një skicë të këndit të lojërave për të ilustruar rezultatet tuaja.

Projektojmë, Modelojmë



1 Gjeni objektet në klasë.
• Vizatoni ato në tabelën e mëposhtme.
• Dalloni të paktën dy forma 2D dhe dy 3D.
• Përshkruaj ato, në mënyrë që shokët e tu të klasës të mund t'i gjejnë këto objekte.
Vazhdoni të luani!

Fotografia ose skica e objektit	Përshkrimi
	1.
	2.
	3.
	4.
	5.
	6.
	7.
	8.
	9.

LIDHJA NDËRMJET FORMAVE 2D DHE 3D – VIZATIMI I FORMAVE 3D

Shikojmë,
vlerësojmë,
gjykojmë,
vizatojmë,
modelojmë



Keni 4 kube të njëjta të vendosura sikur te figura. Bëni modelin. Shikoni modelin. Çfarë vëreni nëse e shihni nga para, nga anash dhe nga lart? Vizatoni!

Lidhi:









pamja nga lart

pamja nga para

pamja nga anash

1 Merr 5 modele kubesh me ngjyra të ndryshme. Bëj një model në 3D. Vizato dhe pikturo!

Modeli:	Pamja nga para
	Plani (pamja nga lart)
	Pamja nga anash

1 Cili nga rrjetet e mëposhtme mund të jetë rrjet kubi?



2 Çfarë forme ka dhurata në fotografi?

3 Prej cilave forma 3D, përbëhet secila prej ndërtesave?

a) _____

b) _____

c) _____

ç) _____

4 Cila pjesë mungon? Rretho

TEMA 2

BOSHTI I SIMETRISË

SIMETRIA



SIMETRIA

Shikoni me vëmendje fotografitë.
Çfarë vini re?

Vëzhgojmë dhe hulumtojmë

Arkitektët kanë projektuar dhe kanë bërë ndërtesa simetrike qindra vjet më parë. Pamja e ndërtesave simetrike është një kënaqësi për syrin dhe një art për t'u ndërtuar.

BOSHTI I SIMETRISË



MBAJ MEND

KUR DY GJYSMAT E NJË FOTOGRAFIE, SHABLLONI, LARMIE OSE **FORME 2D** PASQYROHEN, ATËHERË AJO FIGURË OSE LARMI ËSHTË **SIMETRIKE**

1 Bëhu artist ose arkitekt. Vizato pamjen e parme të një forme simetrike! Pastaj përshkruaje atë!

2 Shiko dy vijat e vizatuara në secilën prej formave 2D. Përcakto se cila prej tyre është bosht i simetrisë. Kontrolloni përgjigjen me pasqyrë.



3 Vizato boshtet e simetrisë në format e mëposhtme 2D.





MBAJ MEND

ME BOSHTIN E SIMETRISË FIGURA NDAHET NË 2 PJESË TË BARABARTA QË **PËRPUTHEN** DUKE I PALOSUR PËRGJATË BOSHTIT TË SIMETRISË, TË DY PJESËT PËRPUTHEN.

4 Vizato të gjitha boshtet e simetrisë së këtyre formave 2D, numëroji ato dhe shënoji në vijë.









5 Vizato boshtet e simetrisë në një katror dhe në një gjashtëkëndësh të rregullt. Pastaj numëroji ato. Çfarë vini re?





MBAJ MEND

NUMRI I BOSHTEVE TË SIMETRISË NË NJË SHUMËKËNDËSH TË RREGULLT ËSHTË I BARABARTË ME NUMRIN E BRINJËVE TË SHUMËKËNDËSHIT.

1 Vizato të gjitha boshtet e simetrisë te shumëkëndëshat.



2 Vizato në atë mënyrë që larat të jenë simetrike.



3 Cila vijë e tregon saktë boshtin e simetrisë?



4 Shkruani shkronjat që shënojnë format 2D në vendin e duhur në tabelë:



	Kënd i drejtë	Nuk ka kënd të drejtë
Ka të paktën një bosht simetrie		Dh
Nuk ka bosht simetrie		

TEMA 2

POZICIONI DHE LËVIZJA

PËRCAKTIMI I POZICIONIT ME RROTULLIM NË DREJTIM TË LËVIZJES SË AKREPAVE TË ORËS

VIZATIMI I SHTIGJEVE TË LËVIZJES SIPAS UDHËZUESIT

SHËNIMI I POZICIONIT NË RRJETIN E KOORDINATAVE

PËRCAKTIMI I POZICIONIT ME RROTULLIM NË DREJTIM TË LËVIZJES SË AKREPAVE TË ORËS

Cili instrument është i paraqitur në fotografi?
Ku përdoret ?
Shiko!
Mendo sikur gjendesh në pozicionin në veri dhe duhet të arrish në pozicionin në lindje. Duhet të kthehesh në kënd të drejtë (90°) në drejtim të rrotullimit të akrepave të orës. Nga pozicioni në lindje në pozicionin në jug, ti duhet të rrotullohesh edhe një herë për një kënd të drejtë. Sa herë do të rrotullohesh në kënd të drejtë, nëse je në pozicionin në veri dhe do të arrish në pozicionin në jug? Gjatë rrotullimit do të bësh një gjysmërreth. Ky kënd i rrotullimit ka 180° dhe e quajmë kënd të shtrirë. Sa kënde të drejta ka në këndin e shtrirë? Nëse vazhdon të rrotullohesh nga jugu në perëndim dhe nga perëndimi në veri në drejtim të lëvizjes së akrepave të orës, do të formohet një kënd tjetër prej _____. Sa rrotullime në kënd të drejtë bëhen nga pozicioni në veri për të arritur përsëri në pozicionin në veri?
Ne themi se kemi bërë rrotullim të plotë ose një kënd të plotë. Këndi i plotë ka 360°.

Hulumtojmë dhe zbulojmë

POZICIONI DHE LËVIZJA

Në busull janë shënuar dhe pozicionet e ndërmjetme:
verilindje -VL,
veriperëndim-VP,
juglindje-JL,
jugperëndim-JP
Shëno:



1 Sipas informacioneve, plotëso tabelën me pozicionin e saktë:

Udhëton në veri (V), lakon për 90° ↑ Tani udhëton në: Lindje	Udhëton në veri (V), lakon për 180°. ↑ Tani udhëton në:	Udhëton në perëndim (P), lakon për 90°. ← Tani udhëton në:	Udhëton në juglindje (JL), lakon për 180°. ↘ Tani udhëton në:
Udhëton në verilindje (VL), lakon për 90°. ↗ Tani udhëton në:	Udhëton në veriperëndim (VP), lakon për 180°. ↖ Tani udhëton në:	Udhëton në juglindje (JL), lakon për 90°. ↘ Tani udhëton në:	→ Udhëton në lindje (L) Tani udhëton në:

2 SFIDË!
Për të arritur nga pozicioni në veri në pozicionin në verilindje, duhet bësh gjysmë rrotullimi të këndit të drejtë, d.m.th. rrotullohesh me një kënd prej 45°.

↙ Udhëton në jugperëndim (JP), Tani udhëton në:	Udhëton në jug (J), lakon për 135°. ↓ Tani udhëton në:	Udhëton në juglindje (JL), lakon pë 270°. ↘ Tani udhëton në:	Udhëton në verilindje (VL), lakon për 135°. ↗ Tani udhëton në:



3 Lojë matematikore: Nevojitet një shabllon busulle dhe zar (kub) për hedhje. Hidhe atë dy herë. Shkruaj rezultatet në tabelën dhe përcakto pozicionin fillestar dhe atë përfundimtar. Përdor udhëzimet e dhëna:

Hedhja e parë – përcaktimi i drejtimit të lëvizjes	
1	VL
2	JL
3	VP
4	JP
5	L
6	P

Hedhja e dytë – përcaktimi i këndit të rrotullimit	
1	45^0
2	90^0
3	135^0
4	45^0
5	225^0
6	270^0

Drejtimi fillestar	Këndi	Destinacioni përfundimtar
L	135^0	JP

4 Ana, Erolli dhe një grup alpinistësh u ngjitën në majën e malit Korab. Udhëheqësi i grupit, me busullën e tij, u jep instruksione alpinistëve se në cilin drejtim duhet të shkojnë. Lëvizja është në drejtim të rrotullimit të akrepave të orës. Në tabelën në vijim jepet pozicioni i tyre fillestar dhe këndet në të cilat duhet të lakojnë. Përcakto pozicionet e reja të grupit të alpinistëve.

Pozicioni fillestar	Këndi i rrotullimit	Pozicioni i ri
Perëndim	90^0	
	180^0	Jug
Lindje		Veri
juglindje	45^0	
Veriperëndim	180^0	
	360^0	Jugperëndim
Veri	45^0	Veriperëndim
	270^0	Lindje
Veri		Jug
	135^0	Lindje

Bëj një plan për të ecur në parkun më të afërt. Shëno hyrjen dhe daljen e parkut. Zgjidh dy shtigje për të ecur. Përdor busullën. Cili shteg është më i lehtë për të lëvizur? Pse?

VIZATIMI I SHTIGJEVE TË LËVIZJES SIPAS UDHËZUESIT

1 Duhet ta lëvizësh shenjën X në rrjetin katror. Ndiq udhëzimet për lëvizje:
Zhvendos 4 katrorë përpara dhe vendose shenjën X;
Rrotulloje me një kënd prej 90^0 në drejtim të akrepave të orës dhe zhvendose shenjën X 4 katrorë përpara.
Rrotulloje edhe një herë në një kënd prej 90^0 në drejtim të akrepave të orës dhe zhvendose X-in 4 katrorë përpara.
Rrotulloje me një kënd prej 90^0 në drejtim të akrepave të orës dhe zhvendose X-in 4 katrorë përpara. Çfarë forme ka shtegu i shenjës X?



Bëj edhe shtigje të tjera!



Shiko rrugën e lëvizjes së qenit në rrjetin katror. A mund t'i zbulosh udhëzimet që ai po ndjek? Shkruaji ato!



2 Në rrjetin e dhënë 5 forma zhvendosen nga një pozicion në një pozicion tjetër. Përshkruaj lëvizjen e secilës prej formave, pa kaluar nëpër katrorët me ngjyra. Vizato shtegun e lëvizjes dhe shkruaj udhëzimet. Përdor shenjën M për majtas, D për djathtas, P për poshtë dhe L për lart. Sa shtigje për lëvizje zbulove në lidhje me formën me ngjyrë të gjelbër? Po për pesëkëndëshin? Çfarë mund të konstatosh?





3 Në këtë vizatim është paraqitur plani i dyshemesë së një shitoreje ushqimesh. Katrorët e bardhë tregojnë hapësirën e lirë (shtigje për lëvizje), kurse të kaltrit tregojnë raftet.

a) Gjeni të paktën 3 shtigje të ndryshme për të lëvizur nëpër dyqan, nga hyrja te dalja.

b) shkruani udhëzimet për të lëvizur nëpër shitore duke dhënë informacione lidhur me numrin e katrorëve, drejtimet sipas anëve të horizontit, drejtimin e rrotullimit dhe këndin në gradë. Vlerëso se cili nga shtigjet është më i shkurtri. Shpjego pse!





SHËNIMI I POZICIONIT NË RRJETIN E KOORDINATAVE

1 Shiko me kujdes hartën e rrjetit dhe objektet e vizatuara në të. A mund ta përcaktosh saktë pozicionin e secilit objekt? Si e bëre atë? Çfarë të ndihmoi të përcaktosh pozicionin e tyre? Shembulli 1: Busulla ndodhet në kolonën D dhe në rreshtin 2. Shkruajmë pozicionin e saj. (D,2).

a) Përcakto dhe shkruaj pozicionin e objekteve të tjera në rrjetin e koordinatave!

b) Përcakto në hartë pozicionet e përfaqësuara nga (A, 7) dhe (7, A). A është i njëjti pozicion? Shpjegoni pse!



_____

_____

_____

_____

_____

_____

MBAJ MEND

PËR TA PËRCAKTUAR POZICIONIN E OBJEKTEVE TI PËRDORE **RRJETIN E KOORDINATAVE**, NË TË CILIN JANË SHËNUAR KOLONAT (A, B, C, ... GJ) DHE RRESHTAT (1,2,3, ... 12), ME TË CILAT PËRCAKTOHET, NË MËNYRË UNIKE, POZICIONI I SECILIT OBJEKT NË RRJET

2 Lojë matematikore: Zgjedh një kafshë dhe përcakto pozicionin e saj në rrjetin e koordinatave. Tregoja shokut tuaj. A do ta gjejë kafshën e zgjedhur? Vazhdo të luash. Shkruaj pozicionet!





3 Në këtë figurë është paraqitur një tabelë shahu. Përcakto pozicionet e figurave në tabelë. Nëse "kali" lëviz dy katrorë lart dhe pastaj një katror majtas ose djathtas, atëherë cili është pozicioni i tij i ardhshëm?



1. _____

2. _____

3. _____

4. _____

4 Zgjidh detyrat e dhëna në tabelë, pastaj gjej zgjidhjen në rrjetin e koordinatave dhe shkruaj pozicionin e zgjidhjes në tabelë.

Detyra	Zgjidhja	Pozicioni
630 : 3		
250 • 2		
Thyesa e $\frac{1}{10}$ shkruar si numër dhjetor		
Numri dhjetor më i madh nga 0.2 dhe 0.8		
950 - 120		
$\frac{1}{4}$ e 100		
195 + 305		

1										0,1
2				0,8						
3	30				200		25			
4			500							
5		830			100					
6	850							100		0,2
7						210				
8					220					
9			0,3				20			
10										
	A	B	C	Ç	D	Dh	E	Ë	F	G

1 Në rrjetat e koordinatave janë vizatuar disa forma 2D. Vizato format simetrike nëse boshtet e simetrisë janë vijat e vizatuara në rrjet. A mund ta ndihmosh gjatë gjetjes së pozicioneve të kulmeve dhe të imazheve të tyre?







2 Vizato format simetrike të formave të dhëna 2D në rrjet, nëse është dhënë boshti i simetrisë. Shfrytëzo pozicionin e kulmeve në rrjetin e koordinatave. Vështro mënyrën e lëvizjes!





ÇFARË MËSUAM?

1 Pranë secilit yll në rrjetin e koordinatave shëno pozicionin e tij:





2 Në rrjetin e mëposhtëm të koordinatave shëno pikat në pozicionet (4,4), (9,4) dhe (4,9). Pastaj lidhi pikat e shënuara. Çfarë forme 2D fitove?



3 Në rrjetin e koordinatave në vijim vendos pika, por zgjidhi në mënyrën e tillë, që kur t'i bashkosh, të fitosh një drejtkëndësh. Shëno pozicionet përkatëse.



4 Vizato secilën formë në lidhje me secilin nga boshtet e dhëna të simetrisë, për të fituar katër forma në secilën prej pjesëve të formuara të rrjetave.





5 Është dhënë rrjeti dhe në të ka disa forma. Përpiqu të arrish nga në Përshkruaje lëvizjen duke treguar nëse lëviz majtas ose djathtas, lart ose poshtë dhe për sa katrorë zhvendosesh. Ki kujdes të lëvizësh vetëm nëpër katrorët e bardhë dhe të kalosh nëpër të gjitha format që janë në rrjet.



TEMA 3

OPERACIONE ME NUMRA

1. MBLEDHJA DHE ZBRITJA DERI NË 10000
2. DYFISHIMI DHE PËRGJYSMIMI I NUMRAVE DERI NË 10000
3. SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 DHE 10
4. MBLEDHJA DHE ZBRITJA E THYESAVE TË RREGULLTA ME EMËRUES TË NJËJTË

TEMA 3

MBLEDHJA DHE ZBRITJA DERI NË 10000

MBLEDHJA DHE ZBRITJA E DHJETËSHEVE DHE QINDËSHEVE TË PLOTA

MBLEDHJA DHE ZBRITJA E MIJËSHEVE TË PLOTA

ÇIFTE TË MIJËSHEVE SHUMA E TË CILAVE ËSHTË 10000

MBLEDHJA DHE ZBRITJA E NUMRAVE KATËRSHIFRORË ME DHJETËSHE TË PLOTA

MBLEDHJA DHE ZBRITJA E NUMRAVE KATËRSHIFRORË ME QINDËSHE TË PLOTA

MBLEDHJA DHE ZBRITJA E NUMRAVE KATËRSHIFRORË ME MIJËSHE TË PLOTA

MBLEDHJA DERI NË 10000 PA KALIM

ZBRITJA DERI NË 10000 PA KALIM

MBLEDHJA DERI NË 10000 ME KALIM

ZBRITJA DERI NË 10000 ME KALIM

MBLEDHJA DHE ZBRITJA E NUMRAVE ME DHJETËSHEN OSE QINDËSHEN MË TË AFËRT

MËNYRA TË TJERA PËR MBLEDHJE DERI NË 10000

MËNYRA PËR ZBRITJE DERI NË 10000

VETIA KOMUTATIVE DHE ASOCIATIVE E MBLEDHJES

ZBATIMI I VETISË KOMUTATIVE DHE ASOCIATIVE GJATË MBLEDHJES

VARSHMËRIA E SHUMËS NGA MBLEDHËSAT TEK APO ÇIFT

VARSHMËRIA E NDRYSHIMIT NGA I ZBRITSHMI DHE ZBRITËSI ÇIFT

NJEHSIMI I NUMRIT TË PANJOHUR GJATË MBLEDHJES DHE ZBRITJES

MBLEDHJA DHE ZBRITJA DERI NË 10000, DYFISHIMI DHE PËRGJYSMIMI I NUMRAVE DERI NË 10000, SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 DHE 10, MBLEDHJA DHE ZBRITJA E THYESAVE TË RREGULLTA ME EMËRUES TË NJËJTË

PËR KËTË TEMË

Me këtë temë, do t'i zgjeroni dhe do t'i thelloni njohuritë për mbledhjen dhe zbritjen e numrave deri në 10000, dyfishimin dhe përgjysmimin e numrave katërshifrorë, shumëzimin dhe pjesëtimin me 2, 3,...10 dhe mbledhjen dhe zbritjen e thyesave të rregullta me emërues të njëjtë.

Idetë kryesore janë mënyrat (strategjitë) e ndryshme të mbledhjes dhe zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit dhe arritja e shkathtësive themelore për përdorimin e tyre në kontekstet e dhëna. Nxënësi duhet ta zhvillojë aftësinë për të lexuar pyetje dhe detyra të caktuara, kurse pastaj të vendosë për zgjidhjen me njërën prej metodave (mënyrave), mentale ose me shkrim. Në këtë temë, zhvillohen të dyja mënyrat: strategjia mentale (mendore) për llogaritje përmendsh dhe me shkrim.

Nxënësit mbledhin dhe zbresin numra dyshifrorë, treshifrorë dhe katërshifrorë, thyesa dhe numra dhjetorë (decimalë), shumëzojnë dhe pjesëtojnë, duke përdorur vetitë e operacioneve përkatëse, radhitjen e operacioneve, si dhe zbërthimin e numrave.

Për shkak se mënyrat (strategjitë) janë përpunuar në klasat e mëparshme, në këtë temë ato vetëm përsëriten shkurtimisht dhe zgjerohen në numrat katërshifrorë, por tema është e pasur me shumë detyra dhe situata problemore nga jeta reale të parashtruara në kontekst matematikor, që të arrihen rezultatet e parapara nga mësimi. Le të jenë sfidë të kuptuarit dhe ushtrimet.

SFIDAT E MUNDSHME

1. Të kuptuarit formal të vetisë komutative dhe asociative, mund të shkaktojë përdorim jo të drejtë të tyre nga ana e nxënësve. Te grupimi, përdorimi i kllapave shkakton gabime gjatë llogaritjeve, prandaj është e nevojshme që të parashtrohen shpesh pyetje dhe detyra për t'u vërtetuar arritjet e rezultateve në mësim, veçanërisht tek operacionet me zbritje dhe pjesëtim.

2. Pritet që disa nxënës të gabojnë gjatë përdorimit të etapave me shkrim të mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit. Kjo vjen si rezultat i mungesës së të kuptuarit të vendvlerës së shifrave dhe trajtimit të shifrës si numër njëshifror. Gabimet mund të jenë të llojit:

$$\begin{array}{r} 2305 \\ -\,1284 \\ \hline 1181 \end{array} \qquad \begin{array}{r} 126 \\ \cdot\,4 \\ \hline 4824 \end{array} \qquad \begin{array}{r} 2436 \\ +1327 \\ \hline 3753 \end{array}$$

3. Të kuptuarit e mbetjes gjatë pjesëtimit duhet të bëhet nëpërmjet shembujve me vizualizim. Grupimi i gjësendeve sipas numrit dhe numërimi i grupeve, në fakt është pjesëtimi që bëhet deri në një nivel ku duhet kryer operacione konkrete, të rekomanduara në këtë material. Grupet që përmbajnë më pak gjësende duhet të lidhen me mbetjen gjatë pjesëtimit. Këto grupe mund të lidhen edhe me numërimin e pjesëve nga tërësia (grupi) dhe paraqitjen e kësaj pjese me një thyesë të rregullt.

4. Të kuptuarit dhe përdorimi i barabarësisë së thyesave gjatë mbledhjes dhe zbritjes së thyesave me emërues të ndryshëm. Vrojtimi i barabarësisë së thyesave duhet të bëhet në mënyrë vizuale me mjete manipulative si dhe me vegla digjitale.

5. Dyfishimi dhe përgjysmimi lidhet në mënyrë të vështirë me shumëzimin dhe pjesëtimin me 4, 8, 5, 10...

MATERIALET E NEVOJSHME DHE INSTRUMENTET MATËSE:

Komplet letrash me numra (karta), karta me shifra, vargje me numra, abakus (numëratore), karta me thyesa dhe numra dhjetorë, rrota me numra – pikado, grafikë me vlera vendore, kube me numra, „mur“ me thyesa, kompjuter, printer, tabelë elektronike, vegla digjitale për vizualizim

FJALORI
i nocioneve të reja

- Mbledhësi
- shumësi
- vetia komutative
- vetia asociative
- i zbritshmi
- zbritësi
- ndryshimi
- dyfishimi
- përgjysmimi
- shumëfishi/shumëfishat
- raporti – proporcioni
- të plota
- thyesa e rregullt
- thyesat e barabarta

MBLEDHJA E DHJETËSHEVE DHE QINDËSHEVE TË PLOTA

Rikujto mënyrat e mbledhjes së numrave dyshifrorë dhe treshifrorë që janë dhjetëshe dhe qindëshe të plota.

Përsërisim dhe zgjerojmë

MBLEDHJA DHE ZBRITJA DERI NË 1000

1 Njehso:

40 + 50 = 400 + 500 =

20 + 40 = 200 + 400 =

40 - 30 = 400 - 300 =

80 - 20 = 800 - 200 =

2 Plotëso tabelat.

+	400	500	600
200			
300			
400			

-	400	300	500
800			
700			
900			

3 Njehso shumat:

a) 20 + 30 + 40 =

b) 50 + 30 + 20 =

c) 40 + 80 + 20 =

ç) 30 + 60 + 40 =

d) 50 + 20 + 50 =

4 Gjej dhe shkruaj çiftet e numrave, shuma e të cilëve është 1000.

200 450 300

800 550 250

700 750

5 Plotëso deri te qindëshja e plotë, e pastaj plotëso deri në 1000. Përdore boshtin numerik dhe vepro si në shembullin e zgjidhur.



6 Në orën e lëndës së matematikës, mësuesja i ndau nxënësit në dy grupe dhe secilit grup i dha nga një ilustrim me kulla me katrorë. Në rreshtin e parë, katrorët ishin shënuar me numra. Kullën e plotësuan ashtu që numri në secilin prej katrorëve është fituar si shumë e numrave të dy katrorëve mbi të cilët qëndron katrori. Cili grup, në majë të kullave ka fituar numër më të madh?



7 Në dy kuti, një e kaltër dhe një e gjelbër, janë vendosur kartelat me numra. Luhet një lojë në çifte, ashtu që njëri nxënës tërheq një kartelë me një numër nga kutia e kaltër dhe ia tregon nxënësit tjetër. Nxënësi tjetër ka për detyrë të zgjedhë një kartelë nga kutia tjetër (e gjelbër), ashtu që shuma e numrit të tij dhe e numrit të shokut të tij të jetë 1000. Cilat shuma mund të formohen, nëse loja vazhdon derisa të harxhohen të gjitha kartelat nga kutia e kaltër? Shkruaj shumat.

250	400	350	
200	950	850	500

650	600	250	50	
150	750	350	800	700	500

MBLEDHJA DHE ZBRITJA E MIJËSHEVE TË PLOTA

MBLEDHJA DHE ZBRITJA DERI N 10000

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

3 + 7 = 10
30 + 70 = 100
300 + 700 = 1000
3000 + 7000 = 10000

1 **Punë në çifte.** Përdorni kartela me mijëshe të plota. Tërhiq një kartelë e pastaj kërko që shoku yt të tërheqë një kartelë me një numër që do të plotësojë deri në shumën 10000.



Zgjeroni lojën. Formoni shuma me mijëshe të plota. Sa shuma 10000 mund të formoni nga këta numra? Mund të përdorni edhe më shumë se dy kartela, por një kartelë mund ta tërhiqni vetëm një herë.
Shkruani shumat.

2 Përpilo një detyrë tekstuale sipas fotografisë.



3 Cili numër mungon?

2000 + _____ = 5000 4000 + 1000 = _____ 7000 + _____ = 10000

8000 - 5000 = _____ 9000 - 6000 = _____ 7000 - 3000 = _____

4 Në fushat e shënuara, duke ndjekur kahun e shigjetave, shkruaj numrat përkatës.



ÇIFTE TË MIJËSHEVE SHUMA E TË CILAVE ËSHTË 1000

Plotëso tabelën!

+	2000	3000	5000
1000			
3000			
4000			

Vlerësojmë dhe plotësojmë

1 Mbledhësi i parë është 4000, kurse shuma është 10000. Sa është mbledhësi i dytë?

Përgjigje: _____

2 Plotëso pjesët me numra që të fitosh shumën e saktë.





3 Në kopshtin e pemëve, për dy ditë janë mbledhur 10000 kg mollë. Ditën e parë janë mbledhur 4500 kg mollë. Sa kilogram mollë janë mbledhur ditën e dytë?

Zgjidhje: _____

Përgjigje: _____

MBLEDHJA E NUMRAVE KATËRSHIFRORË ME DHJETËSHE TË PLOTA

Mendo!
Cilët numra gjenden në vizat e shënuara ndërmjet numrave 2000 dhe 2100 në boshtin numerik?

Shkruaji.

Për shembull:
Agimi tërhoqi katër kartela me shifra. Prej tyre formoi katër numra katërshifrorë, kurse pastaj atyre u shtoi nga një dhjetëshe të plotë.

Numri	1341	3124	2431	4123
+	10	30	50	20
	1351	3154	2481	4143

Gjatë mbledhjes së numrave shumëshifrorë, duke përdorur shënimin e numrave njëri nën tjetrin (mbledhja me shkrim), me rëndësi është që:

Mbledhja kryhet duke filluar me njëshet. Mblidhen numrat me vendvlerën e njëjtë.

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

MBLEDHJA DHE ZBRITJA DERI NË 10000

Për sa zmadhohet secili numër?

2010 + **10** = 2020
2020 + **10** = 2030
2030 + **10** = 2040
2040 + **10** = 2050
2050 + **10** = 2060
2060 + **10** = 2070
2070 + **10** = 2080
2080 + **10** = 2090
2090 + **10** = 2100

Për sa zvogëlohet secili numër?

4090 - **10** = 4080
4080 - **10** = 4070
4070 - **10** = 4060
4060 - **10** = 4050
4050 - **10** = 4040

MBAJ MEND

SHIFRAT ME VENDVLERËN E NJËJTË DUHETT'I SHËNOJMË NJËRËN NËN TJETRËN.

M Q Dh Nj	M Q Dh Nj
4653	7692
+ 30	- 50
4683	7642

1 Duke shfrytëzuar këtë shembull, plotëso tabelën:

numri	2301	5164	9421	7043	4744
+ 30	30				
Shuma	2331				

2 Engini udhëtoi nga një qytet në një tjetër. Ai kaloi një rrugë prej 1432 kilometrash. I kanë mbetur edhe 50 kilometra që të arrijë në qytetin tjetër. Sa është largësia ndërmjet dy qyteteve?

Zgjidhje: _____

Përgjigje: _____

3 Sot, në parkun argëtues për ngasjen e karuselit, janë shitur 2569 zhetonë. Një ditë më parë u shitën 30 zhetonë më shumë. Ditën tjetër pritet të shiten 40 zhetonë më tepër se sot. Sa zhetonë janë shitur dje? Sa zhetonë pritet të shiten nesër?

Zgjidhje: _____

Përgjigje: _____

4

SHTO **30**

3970 _____

2666 _____

2769 _____

4444 _____

ZVOGËLO **20**

2140 _____

5545 _____

9947 _____

1149 _____

5 Zgjidh detyrat e mëposhtme:

a) 2465 + 30 = _____

b) 7326 + 70 = _____

c) 9272 - 60 = _____

ç) 8745 - 30 = _____

MBLEDHJA E NUMRAVE KATËRSHIFRORË ME QINDËSHE TË PLOTA

Numëro nga 100 ndërmjet numrave 6000 dhe 7000. Numrat shënoji në boshtin numerik.

Cilët numra duhet t'i shënosh në vizat e boshtit numerik dhe që gjenden ndërmjet numrave 4000 dhe 5000?
Çfarë vëreni?

Për shembull:
Kire ka pasur në arkën e kursimit 1256 denarë. Çdo ditë gjatë javës ka futur në të nga 100 denarë. Në fund të javës, pa e hapur arkën, deshi të dinte se sa ka kursyer. Ai njehson kështu: Plotësoi shumat që mungojnë

E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E diel
1256	1 356			1656		
+ 100	+ 100	+ 100	+ 100	+ 100	+ 100	+100
1356			1656			1956

Në këtë mënyrë, Kire mësoi se në fund të javës kishte kursyer gjithsej 1956 denarë.

Për sa denarë është zmadhuar kursimi i Kires?

MBLEDHJA DHE ZBRITJA DERI NË 10000

Duke numëruar nga 4000 deri në 5000 shtojmë nga një qindëshe të plotë
4100 + **100** = 4200
4200 + **100** = 4300
4300 + **100** = 4400
...
4900 + **100** = 5000

7900 - **100** = 7800
7800 - **100** = 7700
7700 - **100** = 7600
7600 - **100** = 7500
7600 - **100** = 7500

Për sa zvogëlohet secili numri.

✓ MBAJ MEND

SHIFRAT E VENDVLERËS SË NJËJTË I SHËNOJMË NJËRËN POSHTË TJETRËS. PASTAJ I MBLEDHIM.

M Q Dh Nj	M Q Dh Nj
5399	7587
+ 100	- 100
5499	7487

Mbledhja dhe zbritja kryhet duke filluar nga njëshet.

1 Plotëso tabelën në vijim:

6288	+ 100	- 200	+ 300	- 400	+ 500

2 Isidora bleu atlete për 2670 denarë. Vëllai i saj, bleu tuta që kushtonin për 300 denarë më shtrenjtë se atletet e Isidorës. Sa është çmimi i tutave?

3 Nga topthat e dhënë me shifra, formo dy numra katërshifrorë. Pastaj në këto numra shto edhe nga një qindëshe të plotë. Çfarë numra do t'i fitosh?

a) Numri i parë është _____, i shtova _____ dhe fitova _____.

b) Numri i dytë është _____, i shtova _____ dhe fitova _____.

4 Duke shtuar nga 200, krijo një varg numrash, duke filluar nga numri 7156 deri te numri 7956

Zgjidhje: _____

5 Njehso:

a) $\begin{array}{r} 4564 \\ -\ 100 \\ \hline \end{array}$ b) $\begin{array}{r} 2333 \\ +\ 620 \\ \hline \end{array}$ c) $\begin{array}{r} 7659 \\ -\ 440 \\ \hline \end{array}$ ç) $\begin{array}{r} 3726 \\ +\ 100 \\ \hline \end{array}$

MBLEDHJA DHE ZBRITJA DERI NË 10000

Le ta shikojmë boshtin numerik.

Për sa është zmadhuar numri nga njëri te tjetri numër në boshtin numerik?

Duke numëruar prej 2000 deri më 10000 është shtuar nga një mijëshe e plotë.

Leo mori tre kartela me numra.

3456 6999 8579

Ai dëshironte t'i shkruante numrat që janë për një mijë më të mëdhenj dhe për një mijë më të vegjël se ta.
Ndihmoi Leos që t'i gjejë këto numra:

3456	6999	8579	3456	6999	8579
+ 1000	+ 1000	+ 1000	- 1000	- 1000	- 1000

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Njehso sipas udhëzimeve:

3456	shto	3000	
8765	shto	1000	
6540	vogëlo	2000	
8520	zvogëlo	4000	

2 Vera, Ema, Roni dhe Edini kanë blerë biçikleta. Roni pagoi 6780 denarë për biçikletën e tij.
Vera pagoi 1000 denarë më shumë se Roni. Biçikleta e Emës ishte për 1100 denarë më e shtrenjtë se biçikleta e Verës. Edini pagoi 2010 denarë më shumë se Rroni për biçikletën e tij.

Njehso dhe shkruaj çmimet e biçikletave të:

Verës _____

Emës _____

Edinit _____

3 Babi i Marijes kishte kaluar me veturën e tij të re 3865 kilometra. Në pesë ditët e mëtejme çdo ditë kalonte edhe nga 1000 kilometra. Sa kilometra ka kaluar me veturë pas pesë ditëve?

Gjendja në kilometra gjatë ditëve:
Gjendja fillestare _____

Dita 1	Dita 2	Dita 3	Dita 4	Dita 5
_____	_____	_____	_____	_____

Përgjigje: _____

MBLEDHJA DERI NË 10000 PA KALIM

Të njehsohet shuma e numrave 5673 dhe 2321.

	M	Q	Dh	Nj
	5	6	7	3
+	2	3	2	1
	7	9	9	4

Shifrat e vendvlerës së njëjtë i shënojmë poshtë njëra tjetrës.

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

MBLEDHJA DHE ZBRITJA DERI NË 10000

Mundemi të mbledhim edhe ndryshe

5673 + 2321 = 7994

Si njehsohet kjo shumë?

5673 + 2321 =
(5000 + 2000) + (600 + 300)
+ (70 + 20) + (3 + 1)
= 7000 + 900 + 90 + 4 = 7994

Çka është përdorur në këtë mënyrë të mbledhjes së numrave katërshifrorë?

1 Në një shkollë, në vitin e kaluar shkollor, ishin regjistruar 1342 nxënës. Këtë vit shkollor janë regjistruar 153 nxënës më shumë. Sa nxënës janë regjistruar këtë vit shkollor?

	Mijëshe	Qindëshe	Dhjetëshe	Njëshe
+	1	3	4	2
		1	5	3

Në këtë vit shkollor janë regjistruar _____ nxënës.

2

a) 7775 + 112 =

b) 6784 + 202 =

c) 2816 + 133

ç) 4344 + 645

d) 9 116 + 873

3 Vesna e vizitoi shitoren për veshje sportive dhe bleu rolerë që kushtonin 2450 denarë, mbrojtëse për gjunjët me çmim prej 407 denarëve dhe doreza mbrojtëse prej 132 denarëve.
Sa të holla shpenzoi gjithsej Vesna në shitore?

4 Ivoja e mendoi një numër nga mijëshja e katërt. Në vendin e qindësheve qëndron shifra 0, në vendin e dhjetësheve qëndron shifra 9, kurse në vendin e njësheve shifra 3.
Cilin numër e mendoi Ivoja?
Atij numri ia shtoi numrin 605. Sa është shuma e të dy numrave?

MBLEDHJA DHE ZBRITJA DERI NË 10000

Njehso ndryshimin e numrave 9875 dhe 7422.

Rikujtohu!
Si e quajmë numrin 9875?
Si e quajmë numrin 7422?

9875 – 7422 = ☐

I zbritshmi	9875
Zbritësi	7422
Ndryshimi	☐

ZBRITJA DERI NË 10000 PA KALIM

Gjatë zbritjes me shkrim, shifrat e vendvlerës së njëjtë, qëndrojnë në pozitë të njëjtë dhe shënohen njëra poshtë tjetrës.

	Mijëshe	Qindëshe	Dhjetëshe	Njëshe
–	9	8	7	5
	7	4	2	2
	2	4	5	3

	M	Q	Dh	Nj
	9	8	7	5
–	7	4	2	2
	2	4	5	3

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Njehso ndryshimet:

a) 8456 – 2322 = c) 7210 – 2100 = d) 5869 – 4438 =

b) 4267 – 1033 = ç) 9987 – 7876 = dh) 6678 – 3254 =

2 Ada, Bojani, Vlera dhe Burxhu i njehson ndryshimet e numrave katërshifrorë.

a) 9254 – 5132 = b) 6735 – 4424 = Ata i c) 8845 – 4623 =

fituan këto rezultate:

	a)	b)	c)
Ada	4122	2210	4222
Bojani	4022	2311	4222
Vlera	4122	2301	4232
Burxhu	4122	2311	4222

- Njehso edhe ti.
- Krahasoi rezultatet e tua me ato të dhëna në tabelë.
- Me cilat rezultate u përputhën zgjidhjet e tua?
- Gjej gabimet.

3 Njehso ndryshimet. Ndiqe veprimin e dhënë si në shembullin e mëposhtëm:

9985 – 4734 = (9000 + 900 + 80 + 5) – (4000 + 700+ 30 + 4)

	Mijëshe		*qindëshe*		*dhjetëshe*		*njëshe*	
=	(9000 – 4000)	+	(900 – 700)	+	(80 - 30)	+	(5 - 4)	=
=	5000	+	200	+	50	+	1	= 5251

a) 3786 – 641 =

b) 6357 – 2027 =

c) 7 659 – 7 139 =

4 Festivali i këngës për fëmijë „Zogu i Artë“ u mbajt për tri ditë. Në sallën ku është mbajtur, kishte gjithsej 1985 ulëse. Ditën e parë u shitën 1924 bileta, ditën e dytë u shitën 1883, kurse ditën e tretë u shitën 1771 bileta. Sa ulëse të lira kishte në sallë?

Ditën e parë _____

Ditën e dytë _____

Ditën e tretë _____

5 Për ditëlindjet e tyre Emina mblodhi 3949 denarë, Bisera 3680 denarë, kurse Aliu mblodhi 3450 denarë. Nga këto të holla secili prej tyre bleu diçka. Emina bleu një fanellë që i kushtoi 949 denarë. Bisera bleu një fustan që i kushtoi 2500 denarë, kurse Aliu bleu një libër që i kushtoi 1125 denarë. Nga sa të holla u mbetën?

Eminës _____

Biserës _____

Aliut _____

6 Gjej ndryshimin ndërmjet numrit më të madh katërshifrorë dhe atij më të vogël katërshifrorë të mijëshes së tretë dhe qindëshes së tetë.

MBLEDHJA DERI NË 10000 ME KALIM

1 Të njehohet mbledhja e numrave 3463 dhe 2634

	DHM	MQ	Q	Dh	Nj
		3	4	6	3
+		2	6	3	4
		1			
			10	9	7
		6	0	9	7

Themi: 3Nj plus 4Nj e barabartë me 7Nj.
6Dh Plus 3Dh e barabartë me 9Dh.
4Q plus 6Q e barabartë me 10Q, pasiqë 10Q e barabartë me 1 M.
1 M shtohet në kolonën e M.
3M plus 2M plus **1M** e barabartë me 6M

Shkruajmë:

$$\begin{array}{r} \scriptstyle 1 \\ 3463 \\ +\ 2634 \\ \hline 6097 \end{array}$$

2 Të njehsohet shuma e numrave 4265 dhe 5663

	DHM	MQ	Q	Dh	Nj
		4	2	6	5
+		5	6	6	3
			1		
		9	9	12	8
		9	9	2	8

Themi: 5NJ plus 3NJ e barabartë me 8NJ
6DH plus 6DH e barabartëme12NJ 1
0NJ e barabartë me 1Q Shkruajmë 2DH, shtojmë 10DH te **1Q**
2Q plus 6Q plus **1Q** e barabartë me 9Q
4M plus 5M e barabartë me 9M

Shkruajmë:

$$\begin{array}{r} \scriptstyle 1 \\ 4265 \\ +\ 5663 \\ \hline 9928 \end{array}$$

3 Njehso shumat

a) $\begin{array}{r} 7832 \\ +\ 2194 \\ \hline \end{array}$ b) $\begin{array}{r} 3456 \\ +\ 4622 \\ \hline \end{array}$ c) $\begin{array}{r} 5444 \\ +\ 4363 \\ \hline \end{array}$ ç) $\begin{array}{r} 2457 \\ +\ 6323 \\ \hline \end{array}$

4 Ditën e hënë fluturoi një aeroplan nga Shkupi për në Londër me 1563 udhëtarë. Të mërkurën udhëtuan në relacionin e njëjtë 1642 udhëtarë. Sa udhëtarë gjithsej kanë udhëtuar këto dy ditë nga Shkupi për në Londër?

Zgjidhje: _____

Përgjigje: _____

5 Shitësi i mishit, Simja, për një vit ka shitur 2567 kilogramë mish viçi, 3500 kilogramë mish pule dhe 2032 kilogramë mishqengji. Sa kilogramë mish ka shitur gjithsej për një vit ky shitës mishi?

Zgjidhje: _____

Përgjigje: _____

6 Plotësoni kullat me numra, ashtu që numri në secilin prej drejtkëndëshave të jetë shuma e numrave të shënuar në dy drejtkëndëshat mbi të cilët qëndron ai!





7 Andi u nis nga shtëpia për në stadiumin e qytetit dhe eci 2465 metra. Për të arritur deri arritur deri duhej të ecte edhe 1632 metra. Sa metra larg shtëpisë së tij ishte stadiumi?

Zgjidhje: _____

Përgjigje: _____

Të njehsohet shuma e numrave 4237 dhe 5763

	DHM	MQ	Q	Dh	Nj
		4	2	3	7
+		5	7	6	3
	1	1	1	1	
		10	10	10	10
	1	0	0	0	0

10 Nj = 1 Dh
10 Dh = 1 Q
10 Q = 1 MQ
10 MQ = 1 DHM

```
  1 1 1 1
    4 2 3 7
+   5 7 6 3
  1 0 0 0 0
```

8 Llogarti shumat

a) 6789 + 3211

b) 3714 + 6286

c) 5768 + 4232

ç) 6234 + 3766

9 Formo një numër katërshifror nga shifrat 6 dhe 7, ashtu që shifra e qindësheve të jetë 6, kurse shifrat e tjera të jenë 7! Pastaj formo një numër tjetër katërshifror nga shifrat 2 dhe 3, ashtu që shifra e mijësheve dhe shifra e dhjetësheve të jetë 2, kurse shifrat e tjera të jenë 3! Shkruaj numrat që i formove, kurse pastaj gjej shumën e tyre

☐ + ☐ = ☐

10 Gjyshi Vane shet lakra në treg. Sot, ka shitur 3456 kilogramë lakra, kurse dje ka shitur 588 kilogramë më shumë. Sa lakra ka shitur dje? Sa kilogramë lakra gjithsej ka shitur gjyshi Vane për të dy ditë?

ZBRITJA DERI NË 10000 ME KALIM

Rikujtohu në mënyrën e zbritjes me shkrim.

Njehso:

$$\begin{array}{r} 6000 \\ -\ 3456 \\ \hline \end{array}$$

Fillojmë me zbritjen e njësheve të të zbritshmit dhe të zbritësit.

Në këtë rast nuk mund të zbresim 6 nga 0, prandaj huazojmë një dhjetëshe nga dhjetëshet dhe e shënojmë huazimin nga dhjetëshet. Kemi 10 njëshe. Tani mund të zbresim 6 nga 10 njëshet. Mbeten katër njëshe. E shënojmë në kolonën e njësheve nga zbritja.

Procedurën e vazhdojmë në të njëjtën mënyrë: Një qindëshe e zëvendësojmë me 10 dhjetëshe. Meqë një dhjetëshe është përdorur në hapin e mëparshëm, mbeten 9 dhjetëshe. Tani mund të zbresim 5 nga 9 dhjetëshet, mbeten 4 dhjetëshe. Shënojmë në kolonën e dhjetësheve.

Procedura vazhdon me zbritjen e qindësheve në mënyrën e njëjtë sikur te dhjetëshet. Një mijëshe e zëvendësojmë me 10 qindëshe, njëra qindëshe tashmë është përdorur, mbeten 9 qindëshe, kështu që zbresim 4 qindëshe dhe mbeten 5 qindëshe që i shkruajmë në kolonën e qindësheve.

Tani te mijëshet mbetën 5, i zbresim 3 dhe mbeten 2 mijëshe në kolonën e mijësheve.

$$\begin{array}{r} 6000 \\ -\ 3456 \\ \hline 2544 \end{array}$$

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

MBLEDHJA DHE ZBRITJA DERI NË 10000

DHM	MQ	Q	Dh	Nj
	6 3	0 4	0 5	0 6
	5 3	9 4	9 5	10 6
	2	5	4	4

5 9 9 10

$$\begin{array}{r} 6000 \\ -\ 3456 \\ \hline 2544 \end{array}$$

Si kontrollohet saktësia e rezultatit të fituar gjatë zbritjes së dy numrave?

Rezultati nga zbritja kontrollohet duke mbledhur ndryshimin me zbritësin. Nëse fitohet i zbritshmi, rezultati i zbritjes është i saktë. Nëse nga i zbritshmi zbresim ndryshimin dhe fitojmë zbritësin, përsëri rezultati është i saktë!

Çfarë vëren, si operim,a janë të lidhura mbledhja dhe zbritja? Si?
6000 - 3456 2544

Kontrollim:

$$\begin{array}{r} 2544 \text{ (ndryshimi)} \\ +\ 3456 \text{ (zbritësi)} \\ \hline 6000 \text{ (i zbritshmi)} \end{array}$$

1 Njehso ndryshimet dhe kontrollo rezultatin e fituar.

a) 3000
- 1272

b) 4000
- 2934

c) 5000
- 3265

ç) 10000
- 5632

2 Shuma e dy numrave është 10000. Nëse njëri nga mbledhësit është 8465, sa është mbledhësi i dytë?

3 Kontrollo saktësinë e ndryshimeve të fituara!

a) 6000 – 4567 = 1 433 b) 4800 – 3169 = 1631 c) 5423 – 5118 = 305

4 Shuma e tri numrave është 7000. Mbledhësi i parë është 4502, kurse i dyti është 2345. Gjej mbledhësin e tretë!

5 Në një shitore ka 9000 lodra të ndryshme. Paradite janë shitur 1279 lodra, ndërsa pasdite për 89 më pak. Sa lodra kanë mbetur pa shitur?

MBLEDHJA DHE ZBRITJA E NUMRAVE AFËR DHJETËSHES DHE QINDËSHES SË PLOTË

Shiko, mendo dhe sqaro si do të arrish më lehtë deri te zgjidhja!

a) 3235 + 9 = ? b) 2454 – 11 = ?

A mundesh përmendsh?
Si e bëre?
Shpjegoje mënyrën tënde të zgjidhjes.

Nëse mbledhësit, i zbritshmi ose zbritësi, janë numra afër dhjetëshes ose qindëshes, ne përdorim mënyra që e lehtësojnë mbledhjen ose zbritjen me shkrim. Gjatë kësaj procedure, mund të llogarisim përmendsh (në mendje) duke i plotësuar ata deri te dhjetëshja ose qindëshja përkatëse.

MBLEDHJA DHE ZBRITJA DERI MË 10000

Për shembull:

Që një numri t'i shtosh 9, shto 10 e pastaj zbrit 1.

a) 3235 + 9 = 3244
(në fillim njehsohet
3235 + 10 = 3 245,
kurse pastaj 3245 – 1 = 3244)

Që të zbresësh 11 nga ndonjë numër, zbrit 10, kurse pastaj zbrit edhe 1.

b) 2454 – 11 = 2443
(në fillim njehsohet
2454 – 10 = 2444,
pastaj 2444 – 1= 2443)

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Plotëso tabelën:

		+9
a)	246	255
b)	572	
c)	838	
ç)	153	
d)	625	
dh)	497	
e)	364	
ë)	789	

2 Plotëso tabelën:

		-11
a)	627	616
b)	355	
c)	784	
ç)	462	
d)	279	
dh)	848	
e)	191	
ë)	533	

3 Mendo dhe shkruaj përmendsh procedurën e mbledhjes dhe të zbritjes:

a) Për të shtuar 12 mënyra është: _____
b) Për të shtuar 98 mënyra është _____
c) Për të shtuar 199 mënyra është: _____
ç) Për të zbritur 18 mënyra është: _____
d) Për të zbritur 102 mënyra është: _____
dh) Për të zbritur 502 mënyra është: _____

4 Te numrat e shënuar në boshtin numerik shto numrin 101 dhe shëno shumën

a) 374

b) 824

5 Numrat e shënuar në boshtin numerik zbriti për numrin 99 dhe shëno ndryshimin

a) 456

b) 833

6 Në një shfaqje teatrale në publik kishte 1567 spektatorë të rritur dhe 1008 fëmijë. Sa spektatorë ka pasur gjithsej në shfaqje?

Zgjidhje: _____

Përgjigje: _____

7 Arditi e mbushi me ujë pishinën me sasi prej 1500 litrave. Për ta mbushur plotësisht, i munguan edhe 499 litra ujë. Sa litra ujë kishte në pishinë?

Zgjidhje: _____

Përgjigje: _____

MËNYRA TË TJERA PËR MBLEDHJE DERI NË 10000

Të zgjedhim mënyrën më të lehtë për mbledhjen e numrave.

Të mendojmë!
Në sa mënyra mund ta fitoni numrin 24 duke mbledhur tre numra?
Shkruani mënyrat e ndryshme!

Shembulli 1:
Mblidhi numrat: 28, 7 dhe 2.
Fillo nga çifti që jep dhjetëshe të plotë.

Shembulli 2.
Njehso 145 + 13 Këto dy numra mund t'i mbledhim edhe nëse përdorim zbërthimin.

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

MBLEDHJA DHE ZBRITJA DERI NË 10000

24 i paraqitur si shumë e:
1. 9 + 8 + 7
2. 15 + 5 + 4
3. 18 + 2 + 4

.
.
.
. 15 + 5 = 20
20 + 4 = 24
15 + 5 + 4 = 24

10 + 5 + 5 + 4 = 24
10 + 10 + 4 = 24
20 + 4 = 24

I mbledhim numrat: 28, 7 dhe 2.

Në fillim mbledhim 28 + 2 = 30
Pastaj shtojmë 7.
30 + 7 = 37

28 + 7 + 2 = 37

145 = 100 + 40 + 5

13 = 10 + 3

145 + 13 = 100 + 50 + 8
= 158

1 Zgjidh tre nga këto numra. Mblidhi që të fitosh shumë më të vogël se 25

3	6	9	15
16	7	13	2
11	4	18	5

Në sa mënyra e bëre mbledhjen?

2 Njehso:

a) 495 + 8= _____

b) 794 + 9= _____

c) 8296 + 7= _____

ç) 6399 + 4= _____

3 Gjej shumën e numrave:

a) 167 + 342 = b) 3454 + 1232=



MBAJ MEND

PËR TË MBLEDHUR PËRMENDSH, MUND T'I RRUMBULLAKOJMË MBLEDHËSIT NË DHJETËSHEN OSE QINDËSHEN MË TË AFËRT.

Për shembull: 143 + 28 = 171

Veprimi 1
Numrin 143 e rrumbullakojmë në dhjetëshen e afërt dhe fitojmë numrin 140. 140 + 28 = 168 Numri 143 i rrumbullakuar në dhjetëshen më të afërt është 140. Fitojmë shumë për 3 njëshe më të vogël (pse?), prandaj shumës 168 i shtojmë 3. 168 + 3 = 171.

Veprimi 2
Numrin 28 e rrumbullakojmë në dhjetëshen më të afërt dhe fitojmë numrin 30. 143 + 30 = 173 Numri 28 i rrumbullakuar në dhjetëshen më të afërt është 30. Fitojmë shumë për 2 njëshe më të madhe se sa duhet (pse?) Prandaj nga shuma 173 zbriten dy njëshe: 173 - 2 = 171.

4 Njehso duke përdorur rrumbullakimin e mbledhësit të parë ose të dytë deri në dhjetëshen më të afërt:

a) 618 + 46 = b) 482 + 69 = c) 423 + 18 =

Veprimi: 332 + 212 = 544

Nëse mbledhësin e parë 332 e rrumbullakojmë deri në qindëshen e afërt, do ta fitojmë numrin 300.
300 + 212 = 512.
Kësaj shume i shtojmë 32 dhe fitojmë
512 + 32 = 544.

Nëse mbledhësin e dytë 212 e rrumbullakojmë deri në qindëshen e afërt, do ta fitojmë numrin 200.
332+200 = 532.
Kësaj shume i shtojmë 12 dhe fitojmë
532 + 12 = 544.

5 Njehso shumat duke përdorur rrumbullakimin e mbledhësit të parë dhe të mbledhësit të dytë deri në qindëshen më të afërt!

a) 723 + 104 = b) 597 + 410 = c) 405 + 189 =

6 Rrumbullako shumat duke rrumbullakuar njërin mbledhës në dhjetëshe ose qindëshe të plotë

a) 3356 + 105 = (3356 + 100) + 5 = _____

b) 4211 + 109 = _____

c) 7898 + 202 = _____

ç) 2675 + 401 = _____

d) 1006 + 808 = _____

7 Iva kishte 647 denarë. Nëna i dha edhe 102 denarë. Nga paratë e mbledhura, ajo vendosi të blente një libër prej 498 denarësh. Sa denarë i kanë mbetur?

MËNYRAT PËR ZBRITJE DERI NË 10000

Mënyrat (procedurat) që përdoren për mbledhjen përmendsh (në mendje) , mund të përdoren edhe për zbritje.

Për shembull: 153 – 38 = ?

Numrin 153 e rrumbullakojmë në dhjetëshen më të afërt dhe e fitojmë numrin 150.

Numrin 38 e rrumbullakojmë në dhjetëshen më të afërt dhe e fitojmë numrin 40.

Nga numri 150 e zbresim numrin 38:
150 - 38 = 112
Numrit 113 i shtohet numri
112 + 3 = 115

Nga numri 153 e zbresim numrin 40:
153 - 40 = 113
Numrit 113 i shtohet numri 2
113 + 2 = 115

MBAJ MEND

EDHE TE OPERIMI I IZBRITJES TË ZBRITSHMIN OSE ZBRITËSIN MUND TA RRUMBULLAKOJMË NË DHJETËSHEN OSE QINDËSHEN MË TË AFËRT

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Njehso duke rrumbullakuar të zbritshmin dhe zbritësin në dhjetëshen ose qindëshen më të afërt:

a) 512 – 99 =
b) 698 – 59 =
c) 816 – 189 =
ç) 999 – 13 =

2 Duke rrumbullakuar zbritësin në dhjetëshen ose qindëshen e plotë, Njehso ndryshimet:

a) 532 – 299 = (532 – 300) + 1 = _____
b) 965 – 196 = _____
c) 603 – 398 = _____
ç 560 – 302 = _____
d) 985 – 201 = _____

3 Zgjidh nga një numër prej secilit grup.

a) Shfrytëzo numrat dhe shkruaj shprehje numerike ku do të përdorësh zbritjen. Njehso ndryshimin!
b) Përsërite këtë edhe një herë.
c) Vazhdo derisa t'i përdorsh të gjithë numrat.

132	445		
	389	212	

71	37	
	78	19

Zbulojmë ende strategji për zbritje të numrave..

642 – 210 = 432

Do të përdorim zbërthimin e të zbritshmit dhe zbritësit.

Shkruajmë 642 – 210 =

= (600 + 40 + 2) – (200 + 10 + 0) = (600 – 200) + (40 – 10) + (2 - 0) = 400 + 30 + 2 = 432

4 Këto janë çmimet e biçikletave lodra.

179 den.	289 den.	158 den.	259 den.	182 den.	237 den.

Njehso për sa është më e shtrenjtë:

a) Biçikleta e kaltër nga e kuqja: _____

b) Biçikleta e bardhë nga e gjelbërta _____

c) Biçikleta e zezë nga ajo ngjyrë kafe _____

5 Maja mori gjashtë kartela me shifra: 5, 9, 2, 6, 1 dhe 8 dhe me to formoi dy numra treshifrorë: 961 dhe 852.

Njehso ndryshimin e tyre:

961 – 852 = _____

Me shifrat e njëjta , formo edhe dy numra të tjerë treshifrorë dhe njehso ndryshimin e tyre. Formo edhe numra katërshifrorë. Shkruaj numrat dhe pastaj llogarit ndryshimin e tyre.

PËRSËRISIM, USHTROJMË

1. Formo një numër katërshifrorë nga numrat 5 dhe 3, ashtu që shifra e parë, shifra e mijësheve, të jetë 5, kurse shifrat e tjera 3! Formo edhe një numër katërshifrorë nga shifrat 4 dhe 2 ashtu që shifra e parë, shifra e mijësheve, të jetë 2, kurse shifrat e tjera 4! Mblidh dy numrat!

2. I zbritshmi është 10000 kurse zbritësi është 4573. Njehso ndryshimin!

3. Shuma e tri numrave është 10000. Numri i parë është 3560 kurse i dyti 4034. Gjej numrin e tretë.

4. Marija e hodhi zarin gjashtë herë dhe i fitoi numrat: 1, 3, 2, 6, 4 dhe 5 Nga këta numra formo dy numra treshifrorë dhe pastaj mblidhi. Nga numri më i madh i formuar, zbrite numrin më të vogël.

5. Plotëso tabelën:

	+ 200	- 600	+ 320	- 80
5400				
2165				
4567				

6. Mendova një numër. Nëse e zvogëloj për ndryshimin e numrave 650 dhe 370 do ta fitoj numrin 255. Cili është ai numër?

VETIA KOMUTATIVE DHE ASOCIATIVE E MBLEDHJES

Njehso shumën e numrave 3450+1230, kurse më pas njehso edhe këtë shumë 1230+3450.

Çfarë vëren?

MBLEDHJA DHE ZBRITJA DERI NË 10000

3450 + 1234 = 1230 + 3450

4684 4684

MBAJ MEND

TE OPERIMI ME MBLEDHJE, NËSE MBLEDHËSIT I NDËRROJNË VENDET, SHUMA NUK NDRYSHON.
KJO ËSHTË VETIA KOMUTATIVE E MBLEDHJES!
A+B=B+A

1 Krahaso shumat. Te cilat shprehje numerike është zbatuar vetia komutative?

2350 + 540 ☐ 540 + 2350

338 + 5022 ☐ 338 + 5220

220 + 4220 ☐ 4222 + 220

6234 + 120 ☐ 120 + 6234

2 Njehso shumën e numrave 4500 + 300 + 120.

(4500 + 300) + 120 = 4800 + 120 = **4920**

4500 + (300 + 120) = 4500 + 420 = **4920**

MBAJ MEND

TE OPERIMI I MBLEDHJES, NËSE MBLEDHËSIT GRUPOHEN NË MËNYRA TË NDRYSHME, SHUMA NUK NDRYSHOHET.
KJO ËSHTË VETIA ASOCIATIVE E MBLEDHJES!
(A + B) + C = A + (B + C)

3 Mblidh numrat. Për mbledhje më të shpejtë, mund t'i ndryshosh vendet e mbledhësve.

a) 3451 + 600 + 1240 =

b) 632 + 2510 + 88 + 100 =

c) 12 + 934 + 68 + 2 406 =

ç) 3766 + 300 + 50 =

4 Në cilat shprehje numerike paraqitet vetia asociative? Vendos shenjat ose <, >, = për të krahasuar!

5632 + (200 + 400) ☐ (5632 + 200) + 400 1338 + 2002 ☐ 2002 + 1338

(100 + 80) + 3520 ☐ 80 + (100 + 3520) 300 + (550 + 200) ☐ (300 + 550) + 200

5 Zgjidhe mënyrën më të lehtë dhe më të shpejtë t'i llogarisësh shumat!

a) 280 + 400 + 120 =

b) 560 + 2400 + 87 + 200 =

c) 2000 + 900 + 30 + 170 =

ç) 400 + 300 + 3500 + 1500 =

6 Duhet të njehsohet ndryshimi 3677 – 2282 - 225. Ana dhe Aliu e njehsohen kështu:

Ana : 3677 – 2282 – 225 = (3677 – 2282) – 225 = _____ – 225 = _____

Aliu: 3677 – 2282 – 225 = 3677 – (2282 – 225) = 3677 – _____ = _____

Dikush prej tyre ka gabuar. A mund ta konstatosh personin që ka gabuar? Ku është gabimi?

ZBATIMI I VETISË KOMUTATIVE DHE ASOCIATIVE GJATË MBLEDHJES



1 Përdor vetinë komutative ose asociative që të mbledhësh më lehtë:

500 + 30 + 324 =

125 + 1000 + 2 325 =

400 + 3600 + 100 =

5000 + 630 + 200 =

6500 + 500 + 2000 =

2300 + 1200 + 4500 =

2 Babai i Emës shkoi në treg dhe bleu 1500 gramë qershi, 800 gramë më tepër dredhëza sesa qershi, 400 gramë më pak pjeshka se sa dredhëza. Nga sa gram bleu prej secilit lloj të pemëve? Gjithsej sa gram pemë bleu babai i Emës?

Qershi _____

Dredhëza _____

Pjeshka _____

Gjithsej pemë të blera _____

3 Shkruaj pasardhësit e numrave 3457, 5111 dhe 1315 e më pas mblidhi ata! Grupo që të llogarisësh më shpejtë.

4 Plotëso katrorët e zbarzur ashtu që shuma e numrave në rreshta dhe kolona të jetë 10000.

6500		
	6500	
		6500

MBAJ MEND

NUMRAT ÇIFT MBAROJNË ME SHIFRAT: 0, 2, 4, 6 DHE 8

MBAJ MEND

NUMRAT TEK MBAROJNË ME SHIFRAT: 1, 3, 5, 7 DHE 9

MBAJ MEND

MBAJ MEND GJATË MBLEDHJES SË DY NUMRAVE ÇIFT OSE DY NUMRAVE TEK, SHUMA ËSHTË NUMËR ÇIFT. GJATË MBLEDHJES SË NJË NUMRI ÇIFT ME NJË NUMMËR TEK, SHUMA ËSHTË NUMËR TEK.

VARSHMËRIA E SHUMËS NGA MBLEDHËSAT TEK APO ÇIFT

Cilët numra janë çift e cilët janë tek?

Të rikujtohemi!
Pa marë parasysh se sa shifra ka një numër, shifra e tij e fundit tregon se ai numër është çift ose tek.

Shembulli 1: Ivani i tërhoqi shifrat 2, 5, 1 dhe nga 4 kartelat me shifra.
Prej tyre formoi numrat:

1254 2145 5142 4521

Pastaj i përpiloi dhe i zgjidhi detyrat:

1254 + 5142 = 6396

2145 + 4521 = 6666

Çka vëreni?

Të dy mbledhësit janë numra çift, edhe shuma është numër çift.
Të dy mbledhësit janë numra tek, kurse shuma është numër çift.

Ivani vazhdoi të gjejë shuma nga numrat e formuar:

1254 + 2145 =3399

5142 + 4521 = 9663

Çka vëreni?

Njëri nga mbledhësit është numër çift, e tjetri tek. Shuma është numër tek.

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Pa llogaritur, përgjigju nëse shuma do të jetë numër çift ose tek. Pastaj llogarit dhe vërteto përgjigjen tënde!

4362 + 1544 = 6202 + 3103 = 5234 + 1200 =

5673 + 2345 = 7721 + 1632 = 2805 + 2800 =

2 Në një qendër për mësim të gjuhëve, në kursin për gjuhë angleze u regjistruan 2146 nxënës, në kursin për gjuhë gjermane u regjistruan 1503 nxënës, kurse në kursin për gjuhë franceze u regjistruan 2200 nxënës.

2146 + 1 503 + 2200 = 5849

Sa nxënës gjithsej janë regjistruar në qendrën për mësim të gjuhëve?
Në qendrën për mësim të gjuhëve janë regjistruar gjithsej 5849 nxënës.
A është shuma numër çift apo tek?
Shuma është numër tek.
Çfarë vëren?
Njëri nga mbledhësit është numër tek kurse dy të tjerët janë numra çift.

3 Njehso shumën e numrave të dhënë, prej të cilave tri janë çift dhe tri janë tek.

4333 + 1521 + 3101 = 2224 + 5642 + 1000 =

5211 + 2303 + 1003 = 7200 + 3544 + 1022 =

Çfarë vërehet? Pse?

4 Çfarë ndodh me shumën kur të mbledhësh katër numra tek?

Shkruaj një shembull: _____

Pse ndodh kjo?_____

Çfarë ndodh me shumën kur të mbledhësh pesë numra tek?

Shkruaj 3 shembuj:

1.

2.

3.

Shkruaj pse.

VARSHMËRIA E NDRYSHIMIT NGA I ZBRITSHMI DHE ZBRITËSI TEK APO ÇIFT

Nëse zbresim dy numra, si do të jetë ndryshimi? Prej çfarë varet kjo?

Për shembull:
Në kuzhinën e shkollës drekuan të hënën 1242 nxënës, të martën 1015, të mërkurën 1123, kurse të enjten 1240 nxënës.

Tamara njehsoi ndryshimet ndërmjet numrit të nxënësve që kanë drekuar në kuzhinën e shkollës dhe rezultatet i shënoi në tabelë. Plotëso përfundimet.

	Njehsim	Konkluzion
Ndryshimi ndërmjet numrit të nxënësve që drekuan të hënën dhe të enjten	1242 – 1240 = 2	zbritshmi dhe zbritësi janë numra çift, ndryshimi është numër çift.
Ndryshimi ndërmjet numrit të nxënësve që drekuan të mërkurën dhe të martën	1123 – 1015 = 108	zbritshmi dhe zbritësi janë _____, ndryshimi është numër çift
Ndryshimi ndërmjet numrit të nxënësve që drekuan të hënën dhe të martën	1242 – 1015 = 227	_____ Ndryshimi është 227 dhe është numër tek.
Ndryshimi ndërmjet numrit të nxënësve që drekuan të enjten dhe të mërkurën	1240 – 1123 = 117	_____ Ndryshimi është 117 dhe është numër tek.

MBAJ MEND

GJATË ZBRITJES SË DY NUMRAVE ÇIFT OSE DY NUMRAVE TEK, NDRYSHIMI ËSHTË NUMËR ÇIFT. GJATË ZBRITJES, NËSE I ZBRITSHMI ËSHTË NUMËR ÇIFT, KURSE ZBRITËSI ËSHTË NUMËR TEK, OSE E KUNDËRTA, NDRYSHIMI ËSHTË NUMËR TEK.

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Njehso ndryshimin e këtyre tri numrave çift dhe tri numrave tek.

8223 – 1121 – 3101 =

7346 – 2340 – 2000 =

6213 – 2303 – 1001 =

8300 – 1244 – 1002 =

2 Aktivitete me zbritje:
Shkruaj nga dy shembuj me:

Zbritje të dy numrave katërshifrorë tek

Zbritje të tri numrave katërshifrorë

Zbritje të katër numrave katërshifrorë

MBLEDHJA DHE ZBRITJA DERI NË 10000

134 + ☐ = 237

237 – ☐ = 134

MBAJ MEND

MBLEDHËSI I PANJOHUR GJENDET NËSE NGA SHUMA ZBRITET MBLEDHËSI I NJOHUR.

MBAJ MEND

ZBRITËSI I PANJOHUR GJENDET NËSE PREJ TË ZBRITSHMIT ZBRITET NDRYSHIMI.

MBAJ MEND

I ZBRITSHMI I PANJOHUR GJENDET NËSE NDRYSHIMI MBLIDHET ME ZBRITËSIN.

Llogarisim ndryshimin 7500 - 6000 = 1500 . Vlera e fituar, do të thotë numri 1500 është mbledhësi i panjohur. E vendosim në vendin e duhur dhe e kontrollojmë a është shuma e saktë. Vërtetim: 1500 + 6000 = 7500

NJEHSIMI I NUMRIT TË PANJOHUR GJATË MBLEDHJES DHE ZBRITJES

Për gjetjen e mbledhësit të panjohur, shfrytëzohet lidhja ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes. 134 + = 237 = 237 – 134.

Si do të veprojmë nëse e kemi të panjohur njërin prej mbledhësve, kurse shuma dihet? Cila mënyrë e mbledhjes do të zbatohet? Zbato mënyrën !

☐ + 4000 = 6000
☐ = 6000 – _____
☐ = _____

◯ + 3200 = 8200
◯ = _____ – 3200
◯ = 5000

8000 – ◯ = 2000
◯ = 8000 – 2000
◯ = 6000

237 – ☐ = 134
☐ = 273 – 134
☐ = _____

◯ – 6000 = 2500
◯ = 2500 + 6000
◯ = _____

☐ – 103 = 134
☐ = 134 + 103
☐ = _____

Si do ta vërtetojmë saktësinë e zgjidhjes?

P.sh: ◯ + 6000 = 7500

Kontroll: 1500 + 6000 = 7500

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Njehso numrin e panjohur, kurse pastaj kontrollo rezultatin:

3450 + ◯ = 6450 ◯ + 1220 = 3440 5000 – ◯ = 2450

2 Njehso numrat e panjohur dhe plotëso tabelat:

mbledhësi	3456	4200	★
mbledhësi	1200	★	2222
shuma	★	6400	6666

zbritësi	6700	9800	★
i zbritshmi	3300	★	1500
ndryshimi	★	7600	7500

3 Njehso:

5300 – ☐ = 2700 8732 + ☐ = 9000

☐ – 5300 = 2700 ☐ – 6732 = 2400

4 Plotëso vendet e zbrazëta me numrat që mungojnë!



5 Shkruaj numrat që mungojnë që të fitosh një shumë të saktë.

	4	8	3	6
+	1		2	
		3		4

		9	0	
+	2	5		6
	4		8	1

	7		3	4
+		3	9	
	9	9		1

	3	6	2	
+	2		6	3
		1		2

6 Mbledhësi i parë është 3450, kurse shuma është 5240. Gjej mbledhësin e panjohur.

7 I zbritshmi është 4900, kurse ndryshimi është 2500. Gjej zbritësin.

8 Mbledhësi i dytë është 4816, mbledhësi i tretë është 1128, kurse shuma është 9680. Gjej mbledhësin e parë.

9 Kam mendar një numër. I shtova 4321 dhe e fitova numrin 5609. Cili është ai numër?

10 Marta ka një shumë të caktuar denarësh. Nëse shpenzon 349 denarë, asaj do t'i mbeten edhe 567 denarë. Sa denarë ka Marta?

11 Aliu ka 1025 fotografi me sportistë. Një numër të caktuar fotografish ia dha Elit dhe i mbetën edhe 899. Sa fotografi mori Eli?

1 Tri shoqe kanë luajtur një lojë kompjuterike. Zejna kishte 1290 pikë. Valeria kishte 200 pikë më tepër se Zejna, kurse Emina kishte 450 pikë më pak se Valeria.

a) Sa pikë kishte Valeria?

b) Sa pikë kishte Emina?

c) Sa pikë kishin gjithsej të tria së bashku?

2 Dejani dëshiron të blejë një palë çizme për dimër që kushtojnë 5000 denarë. Në arkën e vet të kursimeve ai ka 3956 denarë. Edhe sa denarë duhet të mbledh Dejani që t'i blejë çizmet?

3 Në një fabrikë prodhohet lëng prej vishnjave. Nga gjithsej 6500 kilogram, mbetën edhe 1245 kilogram vishnja. Sa vishnja janë harxhuar?

4 Gjyshja Dara kishte thasë të vegjël me miell në kuzhinë.

A 1320 g B 1105 g C 1545 g Ç 1005 g

Njehso dhe përgjigju:

a) Cilat nga dy thasët së bashku kanë 2110 g miell?

b) Sa është ndryshimi i sasisë së miellit nga thasët C dhe Ç?

c) Sa miell ka gjithsej në thasët A, B dhe Ç?

ç) Nga sasia e miellit në thasët B dhe C zbrite sasinë e miellit nga thasët A dhe Ç.

5 Gjyshja e Jovanës shkoi në treg dhe bleu 1100 gram luleshtrydhe, 900 gram më tepër qershi sesa luleshtrydhe, 300 gram më pak mjedra sesa luleshtrydhe. Nga sa gramë fruta bleu prej secilit lloj??

Luleshtrydhe _____
Qershi _____
Mjedra _____

6 Markoja, Agnesa dhe Jusufi luanin një lojë kompjuterike. Marko fitoi 2300 pikë, Agnesa fitoi 600 pikë më shumë se Marko, kurse Jusufi fitoi 1200 pikë më pak se Agnesa. Nga sa pikë fitoi secili prej tyre? Sa pikë gjithsej fituan të gjithë së bashku?

Marko_____
Agnesa_____
Jusufi _____
Të tre së bashku kanë fituar: _____

7 Gjatë pushimeve verore, Marija vendosi të shkojë mysafire te shoqja e saj në Gjermani. Rrugës ndërroi disa mjete udhëtimi. Me autobus kaloi 1700 kilometra, me tren kaloi 700 kilometra më shumë sesa me autobus, kurse me aeroplan kaloi aq kilometra sa kaloi së bashku me autobus dhe tren. Nga sa kilometra kaloi Marija me secilin mjet të udhëtimit?
Sa rrugë kaloi Marija që të arrijë deri te shoqja e saj?

Autobus	Tren	Aeroplan

TEMA 3

DYFISHIMI DHE PËRGJYSMIMI I NUMRAVE DERI NË 10000

DYFISHIMI I NUMRAVE ME MIJËSHE, QINDËSHE DHE DHJETËSHE TË PLOTË

ZGJIDHIM PROBLEME ME DYFISHIM

PËRGJYSMIMI I NUMRAVE ME MIJËSHE, QINDËSHE DHE DHJETËSHE TË PLOTA

ZGJIDHIM PROBLEME – DYFISHIMI DHE PËRGJYSMIMI

DYFISHIMI I NUMRAVE ME MIJËSHE, QINDËSHE DHE DHJETËSHE TË PLOTA

MBAJ MEND

TË DYFISHOJMË NJË NUMËR, DO TË THOTË TA MBLEDHIM ATË NUMËR ME VETVETEN OSE TA SHUMËZOJMË ME DY

T'i dyfishojmë numrat:

1000 + 1000 = 2000
2000 + 2000 = 4000
3000 + 3000 = 6000
4000 + 4000 = 8000
5000 + 5000 = 10000

Me shumëzim, dyfishimi i numrit 3400 bëhet si në vijim:

3400 ·2 = ?

3000 · 2 = 6000
400 · 2 = 800

6000 + 800 = 6800

Të rikujtohemi!

Ç'është dyfishimi?

Për shembull:
Që ta dyfishojmë numrin 2000, duhet të llogarisim si në vijim:
2000 + 2000 ose **2000 · 2**,
dhe kjo është e barabartë me **4000**.

Shpesh e përdorim edhe fjalën dyfish.

Për shembull: **Dyfishi i 2000 është 4000**.

Ta dyfishojmë numrin 3400.
Do ta zbërthejmë numrin në mijëshe dhe qindëshe:
3400 = 3000 + 400
Më parë do ta dyfishojmë numrin 3000:
3000 + 3000 = 6000
Pastaj do ta dyfishojmë numrin 400:
400 + 400 = 800
Në fund, do t'i mbledhim shumat e fituara:
6000 + 800 = 6800
Pra, dyfishi i 3400 është 6800.

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Dyfisho numrat sipas shembullit:

2400: dyfishi i 2000 është 4000 dhe dyfishi i 400 është 800, domethënë dyfishi i 2400 është 4800.

5200: dyfishi i ____ është _____ dhe dyfishi i ____ është _____, domethënë dyfishi i _____ është _____.

1300: dyfishi i ____ është _____ dhe dyfishi i ____ është _____, domethënë dyfishi i _____ është _____.

4500: dyfishi i ____ është _____ dhe dyfishi i ____ është _____, domethënë dyfishi i _____ është _____.

2 Zmadho, dyfisho numrat e dhënë:

a) 2100 b) 1630 c) 4700 ç) 3620

3 Plotëso tabelën me numrat që mungojnë:

100, 200, 400, _____, _____,_____,_____.

4 Plotëso tabelën me numrat që mungojnë

Hyrje	Dyfisho	Dalje
4700	→	
1200	→	
1750	→	
2300	→	
1110	→	
3240	→	
4010	→	

ZGJIDHIM PROBLEME ME DYFISHIM

1 Nënës i duhen këta përbërës për të gatuar një ëmbëlsirë për 6 persona. Njehso dhe shkruaj nënës sa sasi i nevojitet nga secili përbërës për të bërë një ëmbëlsirë për dy herë më shumë persona.

2 Fillo me numrin 500 dhe dyfisho atë katër herë në mënyrë të njëpasnjëshme. Cilin numër e fitove?

3 Sa herë në mënyrë të njëpasnjëshme duhet ta dyfishosh numrin 10 derisa të fitosh njënumër që do të jetë më i madh se 500?

4 Njehso dhe dyfisho:

1200 + 2300	dyfisho	
2500 – 1200	dyfisho	
6400 – 3000 + 600	dyfisho	

5 Marija kishte 325 sheqerka. Pasi i dha e ëma edhe po aq sheqerka, Marija tani ka _____ sheqerka.

6 Rruga nga Koçani deri në Shtip është e gjatë 32 kilometra. Sa kilometra kalon autobusi që udhëton në relacionin Koçan – Shtip - Koçan?

a) 16 km
b) 32 km
c) 48 km
ç) 64 km

7 Kiko dhe Ana, Marija dhe Mario ishin dy ekipe që e përfaqësuan klasën në garat shkollore për kuiz shkollor nga projekti "Shkollat që e përparojnë shëndetin".
Kiko fitoi 450 pikë në kuiz nga gjuha angleze, kurse Ana fitoi dyfish më tepër pikë se Kiko.
Marija fitoi 460 pikë në testin nga gjuha angleze, kurse Mario fitoi 30 pikë më pak se dyfishi i pikëve të Marijës.
Cili ekip ishte më i mirë në garat në kuiz?

8 Arsimtari Agim i ka ndjekur mungesat e nxënësve gjatë muajve nëntor dhe dhjetor. Në nëntor ka pasur 118 mungesa të arsyeshme dhe 12 të paarsyeshme, kurse në dhjetor ka pasur dyfish më tepër mungesa të arsyeshme se numri i përgjithshëm i mungesave të nëntorit.
Sa mungesa të arsyeshme ka në dhjetor?
Sa mungesa të paarsyeshme ka në dhjetor, nëse numri i përgjithshëm i mungesave në nëntor e dhjetor është 390?

PËRGJYSMIMI I NUMRAVE ME MIJËSHE, QINDËSHE DHE DHJETËSHE TË PLOTA

Për çfarë mendon kur e dëgjon fjalën ndarje, përgjysmim, imtësim?

A mund ta sqarosh?

A mund të përdoret ndonjë metodë e ndarjes edhe te numrat?

Për shembull:
Dyfishi i 2000 është 4000.
Numri 4000 i përgjysmuar është 2000.

T'i përgjysmojmë numrat:
1000 i përgjysmuar është 500.
2000 i përgjysmuar është 1000.
3000 i përgjysmuar është 1500.
4000 i përgjysmuar është _____.
5000 i përgjysmuar është _____.

Ta përgjysmojmë numrin 4800.
Do ta zbërthejmë numrin në mijëshe dhe qindëshe:
4800 = 4000 + 800 Numri 4000 i përgjysmuar është 2000. Numri 800 i përgjysmuar është 400. Në fund do t'i mbledhim të gjitha pjesët

2000 + 400 = 2400

Përgjysmimi i numrit 4800 është njëlloj sikur ta pjesëtojmë këtë numër me 2,.

4800 : 2 = ?
4000 : 2 = 2000
800 : 2 = 400
2000 + 400 = 2400

Domethënë, nëse e përgjysmojmë numrin 4800, e fitojmë numrin 2400.

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Përgjysmoi numrat sipas shembullit:
Gjysma e 2800 është gjysma e 2000 dhe gjysma e 800
dhe fitohet: 1000 +400 = 1400
Gjysma e 6600 është gjysma e ____ dhe gjysma e ___
dhe fitohet: ____ + ___ = _____
Gjysma e 9200 është gjysma e ____ dhe gjysma e ___
dhe fitohet: ____ + ___ = _____
Gjysma e 5600 është gjysma e ____ dhe gjysma e ___
dhe fitohet: ____ + ___ = _____

2 Nëse fillon prej numrit 1200, sa herë duhet ta përgjysmosh, që të fitosh numër më të vogël se 100? Shkrua secilin hap të përgjysmimit.

3 Një agjenci turistike ka ofertë speciale për pushime verore me gjysëm çmimi.
Njehso çmimin e ri të ofertës për secilin destinacion.

Destinacioni	Çmimi i vjetër për një natë	Çmimi i përgjysmuar për një natë
Greqi	2400 den.	
Shqipëri	2300 den.	
Mali i Zi	3720 den.	
Kroaci	5300 den.	
Turqi	5630 den.	
Ohër	2800 den.	
Strugë	2540 den.	

4 Në vizatimin më poshtë paraqitet largësia e përgjithshme nga pika A deri te pika B dhe e kundërta. Njehso largësinë nga pika A deri te pika B.



5 Beni nga arka e kursimit nxori 7830 denarë. Gjysmën e shumës së parave i shpenzoi për t'i blerë nënës një dhuratë për ditëlindje. Sa denarë i kanë mbetur?

6 Në një garë për vallëzim morën pjesë 1090 të ritur dhe 810 fëmijë. Gjysma e të gjithë garuesve nuk u plasuan në gjysëmfinale. Sa garues morën pjesë në gjysëmfinalen e garës?

7 Njehso dhe përgjysmo:

7400 + 1640	përgjysmo	
8300 – 3300	përgjysmo	
1800 + 5000	përgjysmo	

ZGJIDHIM PROBLEME – DYFISHIMI DHE PËRGJYSMIMI

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Tabela e shahut ka 64 katrorë të bardhë dhe të zi, prej të cilëve gjysma janë të bardhë. Sa katrorë të zi ka tabela?

a) 23

b) 32

c) 42

ç) 64

2 Çmimi i një palltoje gjatë stinës së dimrit ishte 5400 denarë. Pas kalimit të kësaj stine, çmimi është përgjysmuar. Cili ka qenë çmimi i ri i palltos pas mbarimit të stinës së dimrit?

3 Në një kuti ka pasur toptha të kuq, të kaltër dhe të verdhë. Të kuq kanë qenë 1250 toptha, të verdhë kanë qenë dyfish më tepër sesa të kuq, kurse të kaltër dy fish më pak sesa të kuqtë e të verdhët së bashku. Sa toptha ka pasur gjithsej në kuti?

4 Distanca nga Tetova deri në Shkup është 42 kilometra. Lara ka udhëtuar nga Tetova për në Shkup dhe përsëri është kthyer nga Shkupi në Tetovë. Sa kilometra ka kaluar Lara për një ditë?
Sa kilometra ka kaluar për dy ditë?

5 Në leximoren e bibliotekës ka 4680 libra. Në hapësirat e tjera të bibliotekës ka edhe sa gjysma e librave të leximores. Sa libra ka gjithsej në bibliotekë?

6

këpucë	papuçe	atlete	sandale	çizme
4160 den.	1060 den.	2300 den.	1520 den.	4200 den.

a) Njehso dhe shkruaj çmimin e dy palëve nga secili lloj i mbathjeve.

b) Sa është gjysma e çmimit për secilin lloj të mbathjeve?

7 Përbërësit e poshtëshënuar janë të nevojshëm për përgatitjen e ëmbëlsirës për 6 veta. Sa sasi nga përbërësit nevojitet nëse kjo ëmbëlsirë do të ishte për tre veta?

Përbërësit:	
vezë	4
miell	8 **gota**
qumësht	$\frac{1}{2}$ **gotë**

8 Elifi do të shkruajë letra për 18 shokë. Për gjysmën e letrave i duhet nga 1 fletë, kurse për të tjerat, dyfish më shumë fleta. Sa fleta gjithsej i duhen Elifit për t'i shkruar letrat?

TEMA 3



SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI

SHUMËZIMI I NUMRAVE NJËSHIFRORË DERI MË 100. SHUMËFISHAT

SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME NUMRIN 7

SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME NUMRIN 8

SHUMËZIMI I DHJETËSHEVE TË PLOTA PREJ 10 DERI NË 90 ME NUMËR NJËSHIFRORË

SHUMËZIMI I NUMRAVE DYSHIFRORË ME NUMËR NJËSHIFRORË

SHUMËZIMI I NUMRAVE DYSHIFRORË ME NUMËR NJËSHIFRORË

PJESËTIMI I NUMRAVE TRESHIFRORË ME 10

SA MËSUAM – SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI I NUMRIT TRESHIFROR ME 10

ZGJIDHIM DETYRA PROBLEMORE

PJESËTIMI I NUMRIT DYSHIFROR ME NUMËR NJËSHIFROR, ME MBETJE

RAPORTI - PROPORCIONI

SHPREHJET NUMERIKE

NJEHSIMI I SHUMËZUESIT, TË PJESËTUESHMIT DHE PJESËTUESIT TË PANJOHUR

SHUMËZIMI I NUMRAVE NJËSHIFRORË DERI MË 100. SHUMËFISHAT

Të rikujtohemi....

Në fotografi kemi 20 katrorë.

Si janë rradhitur?

Nga sa katrorë ka në secilin rresht?

Nga sa katrorë ka në secilën kolonë?



Nëse e shkruajmë numrin e katrorëve në secilin rresht, atëherë do ta fitojmë numrin e përgjithshëm të katrorëve.
4 + 4 + 4 + 4 + 4 = 20.

Si janë në këtë shumë mbledhësit?



Shkurtimisht e shkruajmë 5 · 4 =20. Mbledhja e mbledhësve të njëjtë ndryshe quhet edhe shumëzim. Numri 5 dhe numri 4 quhen **shumëzues**, kurse numri 20 quhet **prodhim**.

1

Mendo dhe shkruaj përgjigjen



Sa rreshta janë ngjyrosur?

Sa katrorë janë ngjyrosur në secilin rresht?

Sa katrorë gjithsej janë ngjyrosur?

Përshkrua ilustrimin me shumëzim.

Përshkrua ilustrimin me mbledhje

2

Rrjetin katror sipas kërkesave duhet ta ngjyrosim dhe të fitojmë rezultatin e shumëzimit.

$8 \cdot 3 =$

$9 \cdot 3 =$

$5 \cdot 8 =$

$4 \cdot 7 =$





Të rikujtohemi

$3 \cdot 6 = 6 \cdot 3$

Sqaro mendimin tënd. Çfarë konstatove?

3 a) Në tabelën me qindëshe, ngjyrosi me të verdhë prodhimet që do t'i fitosh gjatë shumëzimit me 2.

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
31	32	33	34	35	36	37	38	39	40
41	42	43	44	45	46	47	48	49	50
51	52	53	54	55	56	57	58	59	60
61	62	63	64	65	66	67	68	69	70
71	72	73	74	75	76	77	78	79	80
81	82	83	84	85	86	87	88	89	90
91	92	93	94	95	96	97	98	99	100

Çfarë vëren?

b) Në tabelën e njëjtë me të kaltër rretho prodhimet që do t'i fitosh gjatë shumëzimit me numrin 4.

Çfarë shablloni fitove gjatë zgjidhjes së detyrës b) ?

Prodhimet që fitohen gjatë shumëzimit të një numri me 2 i quajmë **shumëfish** të 2.

4 Shkruaj shumëfishat e numrit 2 që i takojnë dhjetëshes së pestë. Pastaj, shkruaj shumëfishat e numrit 2 që i takojnë dhjetëshes së nëntë

Prodhimet që fitohen gjatë shumëzimit me 4 i quajmë ndryshe edhe shumëfisha të numrit 4.

5 Shkruaj shumëfishat e numrit 4 që i takojnë dhjetëshes së dytë dhe të tretë. A janë këta numra shumëfisha të numrit 2? Mendo pse!

Në tabelën me qindëshe, gjej numrat që fitohen gjatë shumëzimit me 3, 6 dhe 9.

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
31	32	33	34	35	36	37	38	39	40
41	42	43	44	45	46	47	48	49	50
51	52	53	54	55	56	57	58	59	60
61	62	63	64	65	66	67	68	69	70
71	72	73	74	75	76	77	78	79	80
81	82	83	84	85	86	87	88	89	90
91	92	93	94	95	96	97	98	99	100

- Ngjyrosi shumëfishat e 3 me të gjelbërt, të 6 me të kaltër dhe të 9 me ngjyrë vjollcë.
- Sqaro procedurën e gjetjes së shumëfishave të 3, 6 dhe 9.

6 Cili nga pohimet në vijim është i saktë? Përdore tabelën me qindëshe!

a) Shumëfishat e numrit 3 janëedhe shumëfishat e numrit 9.
b) Shumëfishat e numrit 9 janëedhe shumëfishat e numrit 3.
c) Shumëfishat e numrit 6 janë njëkohësisht edhe shumëfishat e numrit 2 dhe 3.
ç) Të gjithë shumëfishat e numrit 10 janë shumëfisha edhe e numrit 5.
d) Shumëfishat e numrit 9 janë numra tek.)

5 Goni mendoi një numër nga dhjetëshja e katërt. Ai numër është edhe shumëfishi i 2, 3, 4, 6 dhe 9 njëkohësisht . Cilin numër e mendoi Goni? Përdor ndihmën e tabelës qindëshe.

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
31	32	33	34	35	36	37	38	39	40
41	42	43	44	45	46	47	48	49	50
51	52	53	54	55	56	57	58	59	60
61	62	63	64	65	66	67	68	69	70
71	72	73	74	75	76	77	78	79	80
81	82	83	84	85	86	87	88	89	90
91	92	93	94	95	96	97	98	99	100

SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME NUMRIN 7

Ivani jeton në një ndërtesë katër katëshe. Në secilin kat ka nga 7 dritare. Sa dritare ka gjithsej ndërtesa?

Ndërtesa fqinje ka gjithsej 21 dritare. Në secilin kat ka nga 7 dritare. Sa kate ka ndërtesa?





7 + 7 + 7 + 7 = ☐

4·7= ☐

Në 4 kate ka ☐ dritare

SHUMËZUESI I PARE	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
SHUMËZUESI I DYTË	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7
Prodhimi										



21-7=14 14-7=7 7-7=0

21:7= ☐ sepse ☐ ·7=21

21 dritare janë shpërndarë në ☐ kate

I pjesëtueshmi	7	14	21	28	35	42	49	56	63	70
Pjesëtuesi	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7
Herësi										

1 Në bibliotekën e shkollës kanë sjellë 63 libra. Librat i kanë rradhitur në 7 rafte. Nga sa libra kanë vendosur në secilin raft?

Përgjigje: $63 : 7 = 9$ sepse $9 \cdot 7 = 63$

Çfarë vëren? Çfarë operacione matematikore janë shumëzimi dhe pjesëtimi?

A mund ta fitosh tabelën e pjesëtimit me 7 nëse e shfrytëzon tabelën e shumëzimit me 7?

2 Llogarit:

$2 \cdot 7 = \square$ $\quad$ $5 \cdot 7 = \square$ $\quad$ $8 \cdot 7 = \square$

$7 : 1 = \square$ $\quad$ $21 : 7 = \square$ $\quad$ $28 : 7 = \square$

$6 \cdot 7 = \square$ $\quad$ $9 \cdot 7 = \square$

$42 : 7 = \square$ $\quad$ $63 : 7 = \square$

3 Njehso dhe krahaso!

$7 \cdot 8 \ \square \ 7 \cdot 6$ $\quad$ $7 \cdot 4 \ \square \ 7 \cdot 3$

$63 : 7 \ \square \ 70 : 7$ $\quad$ $1 \cdot 7 \ \square \ 7 \cdot 1$

$42 : 7 \ \square \ 14 : 7$ $\quad$ $10 \cdot 7 \ \square \ 5 \cdot 2$

4 Darko dhe Mia duhet t'i shkruajnë saktë zgjidhjet e detyrave që të arrijnë te shokët e tyre Bojan, Sara dhe Eroll për të shkuar në shëtitje. Le t'u ndihmojmë që të arrijnë te shokët e tyre.

7 · 8	=	56	56	:	8	=	7	7	+	18	=						
																	:
3	·			=	9	·			=	2	-			=	5		
=																	
	:	9	=			+	26	=			:	7	=				
																	+
	=	10	+			=	5	·			=	8	:			=	27
:																	
5	=			·	14	=			:	4	=			+	6	=	
																	:
	=	5	:			=	5	+			=	5	·			=	3
·																	
6	=			+	8	=			:	4	=			+	28		
															=		
	=	25	+			=	7	·			=	9	:				
:																	
5	=			·	7	=			:	6	=			+	4	=	
																	:
										63	=	7	·			=	2

5 Gjeje përgjigjen e saktë:

a) 9 · 9

83
89
81

b) 7 · 8

65
56
66

c) 4 · 6

42
34
24

SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME NUMRIN 8

Në bibliotekën e shkollës në 4 rafte janë rradhitur nga 8 libra.
Sa libra ka gjithsej në rafte?



$8 + 8 + 8 + 8 = \square$

$4 \cdot 8 = \square$

Në katër rafte ka nga $\square$ libra

Shumëzuesi i parë	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Shumëzuesi i dytë	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8
Prodhimi										



$16 : 8 = 2$ sepse $2 \cdot 8 = 16$

I pjesëtueshmi	8	16	24	32	40	48	56	64	72	80
Pjesëtuesi	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8
Herësi										

Zgjidhe shembullin.
Mësuesi kishte 16 ngjyra. Ato ua ndau në mënyrë të barabartë 8 nxënësve. Nga sa ngjyra ka marrë secili prej nxënësve?



1

Njehso:

$2 \cdot 8 =$ $7 \cdot 8 =$ $4 \cdot 8 =$ $8 \cdot 8 =$

$16 : 8 =$ $32 : 8 =$ $40 : 8 =$ $64 : 8 =$

2

Gjeje katrorin me prodhimin e saktë!

$5 \cdot 8$		
45	50	40

$7 \cdot 8$		
55	56	57

$10 \cdot 8$		
60	70	80

$4 \cdot 8$		
23	32	33



3

Njehso dhe lidhi me prodhimin e saktë!

$6 \cdot 8 =$	56	$1 \cdot 8 =$
$2 \cdot 8 =$	16	$4 \cdot 8 =$
$4 \cdot 8 =$	64	$3 \cdot 8 =$
$7 \cdot 8 =$	8	$6 \cdot 8 =$
$3 \cdot 8 =$	32	$7 \cdot 8 =$
$8 \cdot 8 =$	24	$2 \cdot 8 =$
$5 \cdot 8 =$	48	$9 \cdot 8 =$
$1 \cdot 8 =$	72	$5 \cdot 8 =$
$10 \cdot 8 =$	40	$10 \cdot 8 =$
$9 \cdot 8 =$	80	$8 \cdot 8 =$

4

Plotëso:





STRATEGJIA PËR SHUMËZIM MENDOR TË DHJETËSHEVE DHE QINDËSHEVE TË PLOTA ME NUMËR NJËSHIFROR

1 Në këto figura janë paraqitur monedha dhe bankënota të njëjta. Gjeje shumën e të hollave të paraqitura në secilën prej fotografive:

$2 + 2 + 2 + 2 = 4 \cdot 2 =$ ____

$50 + 50 + 50 + 50 =$ ____ $\cdot$ ____ $=$ ____



$200 + 200 + 200 + 200 =$ ____ $\cdot$ ____ $=$ ____

Çfarë vërejte gjatë shumëzimit? A mund të shpjegosh si shumëzohet dhjetëshja apo qindëshja e plotë me numër njëshifror?

$5 \cdot 4 = 20$ $\quad$ $5 \cdot 40 = 200$ $\quad$ $5 \cdot 400 = 2000$

Të rikujtohemi:
Kur e shumëzoj numrin dyshifror me 10, atij numri i shtoj një zero pas shifrës së njësheve.

$5 \cdot 10 = 50$

$5 \cdot 100 = 500$

$5 \cdot 10 = 50$

Si do të shumëzoj dhjetëshe të plotë më numër njëshifror?
$50 \cdot 5 = (5 \cdot 10) \cdot 5 = (5 \cdot 5) \cdot 10 = 25 \cdot 10 = 250$

Si do të shumëzoj qindëshe të plotë me numër njëshifror?
$500 \cdot 5 = (50 \cdot 10) \cdot 5 = (50 \cdot 5) \cdot 10 = 250 \cdot 10 = 2500$

2 Plotëso vendet e zbrazëta me prodhimet e fituara. Ndiq shembujt.

x	50	20	60	30	80	40	70	10	100	90
2	100	40								
3	150		180							
4		80								
5										
10				300						

3 Njehso dhe shkruaj!

$3 \cdot 2 =$ $3 \cdot 3 =$ $1 \cdot 9 =$ $6 \cdot 4 =$

$3 \cdot 20 =$ $3 \cdot 30 =$ $1 \cdot 90 =$ $6 \cdot 40 =$

$3 \cdot 200 =$ $3 \cdot 300 =$ $1 \cdot 900 =$ $6 \cdot 400 =$

4

Njehso:

$80 \cdot 4 =$	$7 \cdot 90 =$	$400 \cdot 1 =$	$6 \cdot 4 =$
$6 \cdot 20 =$	$5 \cdot 30 =$	$200 \cdot 3 =$	$6 \cdot 80 =$
$3 \cdot 500 =$	$4 \cdot 30 =$	$6 \cdot 90 =$	$2 \cdot 400 =$

5

Plotëso tabelën me numrat që mungojnë!

Shumëzu esi i parë	7		4	300		60	40	2	3		5
Shumëzu esi i dytë		90		3	200	8	5		200	70	
Prodhimi	630	720	320		1000			400		350	300

6

Shkruaj numrat që mungojnë në drejtkëndësha. Secili numër në drejtkëndësh fitohet si prodhim i numrave nga drejtkëndëshat mbi të cilët qëndron.





7 Në një aksion ekologjik për pyllëzim morën pjesë 60 arsimtarë dhe katër herë më tepër nxënës. Sa nxënës morën pjesë në aksion?

Përgjigje: _____

Sa pjesëmarrës gjithsej morën pjesë në aksion?

Përgjigje: _____



MË SHUMË STRATEGJI PËR SHUMËZIMIN MENTAL

1 Rruga lokale nga Krusheva deri në Prilep është e gjatë 21 kilometra. Për një ditë, këtë rrugë e kanë kaluar 40 automobila. Sa kilometra gjithsej kanë kaluar të gjithë automobilat së bashku?

Nëse e përdor strategjinë e zbërthimit, do të veprosh në këtë mënyrë:

$21 \cdot 40 = 21 \cdot (4 \cdot 10) = (21 \cdot 4) \cdot 10 = 84 \cdot 10 = 840$ ose $21 \cdot 40 = 840$

Automobilat kaluan rrugë prej gjithsej 840 kilometrave.

2 Njehso:

$26 \cdot 20 =$

$300 \cdot 20 =$

$30 \cdot 98 =$

$40 \cdot 42 =$

$75 \cdot 50 =$

3 Në 30 furra buke janë shpërndarë nga 65 shporta me bukë.

Sa shporta me bukë janë shpërndarë gjithsej?

4 73 punëtorëve mëditja do t'u ritet për 60 denarë.

Sa denarë duhen gjithsej që të paguhet ritja e mëditjes?

$23 \cdot 200 = 23 \cdot 2 \cdot 100 = 46 \cdot 100 = 4600$

P.sh: 23 punëtorëve, që kanë punuar me përkushtim atë ditë, është vendosur që t'u paguhen nga 200 denarë shtesë. Sa para nevojiten për t'u realizuar pagesa e shtesës?

5 Duke vepruar sipas shembullit, njehso:

$400 \cdot 18 =$ $22 \cdot 300 =$

Detyra logjike

6 Luka ka monedhë 10 denarëshe. Maja ka monedhë me vlerë dhjetë herë më të madhe se vlera e monedhës së Lukës, kurse Leo ka monedhë me vlerë 100 herë më të madhe se vlera e monedhës së Lukës. Ana ka një monedhë që ka vlerë 10 herë më të vogël se vlera e monedhës së Lukës. Çfarë të hollash (bankënota ose monedha) ka secili prej fëmijëve? Sa është shuma e të hollave që i kanë së bashku të gjithë?

7 Në një paketim vezësh ka 30 vezë. Bujari duhet të mbushë 200 paketime me vezë. Sa vezë iu deshën Bujarit që t'i mbushë paketimet? Edhe sa vezë duhet të paketojë Bujari, nëse në fillim ka pasur 10000 vezë? Në atë rast, sa paketime me vezë do të mbush gjithsej?

SHUMËZIMI I NUMRIT DYSHIFRORË ME NUMËR NJËSHIFRORË

Rikujtohu! Si shumëzohet shuma e mbledhur me numër?

Mënyra e parë:

$(4 + 3) \cdot 2 = 4 \cdot 2 + 3 \cdot 2 = 8 + 6 = 14$

Mënyra e dytë:

$(4 + 3) \cdot 2 = 7 \cdot 2 = 14$

Në klasë ka 32 nxënës. Për sot, secili prej tyre duhet të ketë nga 4 fletore në çantën e vet. Sa fletore gjithsej kanë të gjithë nxënësit? 32 nxënës.

Secili nxënës ka 4 fletore.

Kjo si shumëzim paraqitet kështu $32 \cdot 4$.

Por, si njehsohet?

Do të zbatojmë zbërthimin e shumëzuesit dyshifror në mbledhës kurse pastaj, secilin mbledhës do ta shumëzojmë me shumëzuesin e dytë.

Prodhimet e fituara do t'i mbledhim.

$32 \cdot 4 = (30 + 2) \cdot 4 = (30 \cdot 4) + (2 \cdot 4) = 120 + 8 = 128$

1 Zbërtheje numrin dyshifrorë e pastaj njehso prodhimin

a) $53 \cdot 9 =$ (_____ · _____) + (_____ · _____) = _____ + _____ = _____

b) $44 \cdot 5 =$ (_____ · _____) + (_____ · _____) = _____ + _____ = _____

c) $56 \cdot 3 =$ (_____ · _____) + (_____ · _____) = _____ + _____ = _____

ç) $87 \cdot 2 =$ (_____ · _____) + (_____ · _____) = _____ + _____ = _____

d) $33 \cdot 9 =$ (_____ · _____) + (_____ · _____) = _____ + _____ = _____

dh) $93 \cdot 3 =$ (_____ · _____) + (_____ · _____) = _____ + _____ = _____

Shfrytëzojmë tabelën për shumëzim.

Të llogarisim 6 ·49 duke përdorur tabelën.

·	40	9
6	240	54

240 + 54 = 294
Zgjidhje: 6 · 49 = 294

2

a) Njehso 5

·		

_____ + _____ = _____

Zgjidhje: 5 · 59 = _____

b) Njehso 9 ·35 duke
 përdorur tabelën.

·		

_____ + _____ = _____

Zgjidhje: 9 · 35 = _____

c) Njehso 6 ·73 duke
 përdorur tabelën.

·		

_____ + _____ = _____

Zgjidhje: 6 · 73 = _____

3

Esadi dhe Jovani kishin bërë porositë për shokët e tyre të klasës, se kush çka do të pijë në ditëlindjen e Jovanit. Çmimet e pijeve janë dhënë në tabelë. Sipas porosive të marra ata duhej të llogarisin se sa të holla u nevojiten për ta paguar llogarinë.

Lëng portokalli	Kënaçe lëng i gazuar	Lëng limoni të shtrydhur	Limonadë
59 den.	45 den.	63 den.	57 den.
Lëng ananasi	Shishe me ujë mineral	Lëng boronice	Lëng limete
76 den.	68 den.	54 den.	39 den.

Llogaritjen e kishin bërë në disa mënyra: Zgjidh mënyrën tënde të llogaritjes dhe ndihmoi Esadin dhe Jovanin.

a) 4 kanaçe me lëng të gazuar

b) 6 gota lëng të shtrydhur limoni

c) 5 gota lëng portokalli

ç) 3 gota lëng limete

d) 7 shishe me ujë mineral

dh) 9 gota lëng boronice

e) 5 gota lëng ananasi

ë) 4 gota limonadë

4 Tino, Vale dhe Aleni blenë bileta për në kinema që kushtonin 218 denarë. Sa paguan për të gjitha biletat?

SHUMËZIMI I NUMRAVE TRESHIFRORË ME 10

MBAJ MEND

KUR NJË NUMËR I DHËNË SHUMËZOHET ME NUMRIN 10, AI NUMËR BËHET 10 HERË MË I MADH.
SHIFRA E NJËSHEVE BËHET SHIFËR E DHJETËSHEVE.
SHIFRA E DHJETËSHEVE BËHET SHIFËR E QINDËSHEVE. SHIFRA E QINDËSHEVE BËHET SHIFËR E MIJËSHEVE.

1 Njehso:

a) 235 · 10 =

b) 806 · 10 =

c) 755 · 10 =

ç) 692 · 10 =

d) 473 · 10 =

dh) 171 · 10 =

2 Simona, çdo ditë gjatë gjithë vitit në arkën e kursimit ka vendosur nga 10 denarë. Ditën e fundit të vitit, Simona i numëroi të hollat.
Sa të holla ka mbledhur Simona?
Çka mund të blejë ajo me ato të holla?
Diskuto, hulumto, mblidh të dhënat për çmimet.

3 Njehso prodhimin, duke përdorur tabelën e zbërthimit.

a) 426 · 10 =

426	·10
400	4000
20	200
6	60

Prodhim: 4260

b) 354 · 10 =

	·10
300	
50	

c) 874 · 10 =

	·10
800	

ç) 789 · 10 =

d) 985 · 10 =

dh) 542 · 10 =

4 Në një klub sportiv arritën 10 kuti me topa. Në secilën kuti kishte nga 125 topa. Sa topa arritën gjithsej në klub?

PJESËTIMI I NUMRAVE TRESHIFRORË ME 10

MBAJE MEND

Kur një numër i dhënë pjesëtohet me numrin 10, ai numër bëhet 10 herë më i vogël se numri i dhënë. Shifra e mijësheve bëhet shifër e qindësheve. Shifra e qindësheve bëhet shifër e dhjetësheve. Shifra e dhjetësheve bëhet shifër e njësheve.
Për shembull: 5140 : 10 = 514

Të rikujtohemi:
70 : 10 = 7
100 : 10 = 10
160 : 10 = (100 + 60) : 10 = 100 : 10 + 60 : 10 = 10 + 6 = 16

A mund të pjesëtojmë përmendsh një numër me dhjetëshe ose me qindëshe?

50 : 10 = 5
500 : 10 = 50
5000 : 10 = 500

700 : 100 = 7
7000 : 100 = 70

Si është kryer pjesëtimi? Sqaro!

Për shembull:

130 : 10 = 13
580 : 10 = 58
840 : 10 = 84

1 Njehso:

a) 540 : 10 = b) 650 : 10 = c) 350 : 10 =

ç) 720 : 10 = d) 890 : 10 = dh) 250 :10 =

2 Njehso:

a) 420 : 10 = **b)** 930 : 10 = **c)** 750 : 10 =

ç) 320 : 10 = d) 110 : 10 = **dh** 270 :10 =

e) 140 : 10 = ë) 150 : 10 = f) 520 : 10 =



3 Njehso:

600 : 10 = 780 : 10 = 2300 : 100 =

b) 4500 : 10 = c) 6800 : 100 =

Ç'ndodh nëse pjesëtuesi është dhjetëshe e plotë? Si do të pjesëtojmë 350:70? Mundohu ta zbulosh. Përdor mënyra të ndryshme.

4 Njehso dhe vështro:



a) 750 : 5 =

b) 750 : 50 =

c) 7500 : 50 =

ç) 7500 : 500 =

5 Njehso dhe lidhi me numrin përkatës – herësin:

3800 : 100	720
7200 : 10	6
650 : 50	40
3600 : 90	38
4800 : 800	13

SA MËSUAM – SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI I NUMRIT TRESHIFROR ME 10

SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI

2 Njehso:

a) $155 \cdot 10 =$

b) $406 \cdot 10 =$

c) $728 \cdot 10 =$

ç) $397 \cdot 10 =$

d) $647 \cdot 10 =$

dh) $280 \cdot 10 =$

1 Kur një numër i dhënë shumëzohet me numrin 10, atëherë fitohet një numër 10 herë _____ nga numri i dhënë.
Shifra e njësheve bëhet shifër e dhjetësheve.
Shifra e _____ bëhet shifër qindësheve.
Shifra e qindësheve bëhet shifër e _____

Çfarë qëndron si shifër e njësheve?

_____

_____

Numri i fituar, a e ka numrin e njëjtë të shifrave sikur numri i dhënë?

_____

_____

3 Bashkësia e klasës në shkollën ku mësonin 726 nxënës, për ta stolisur korridorin e shkollës për Vitin e Ri prej çdo nxënësi mblodhi nga 10 denarë. Sa të holla mblodhën nxënësit?

4 Pjetri 10 ditë nget biçikletën. Për çdo ditë ai ka kaluar me biçikletë nga 958 metra. Sa metra ka ngarë Pjetri biçikletën për këto 10 ditë?

5 Në librari shitet një libër interesant. Çmimi i tij është 40 denarë. Plotëso tabelën! A mund të marrësh me mend pse të premten nuk është shitur asnjë libër?

	Të hollat nga shitja e librit	Numri i librave të shitur	Paraqite përllagaritjen
E hënë	680		
E martë	760		
E mërkurë	560		
E enjte	400		
E premte	0		

6 Një nxënës hedh tri zare. Nga numrat e fituar formon një numër treshifrorë. Dy nxënës të tjerë, numrin treshifrorë e shumëzojnë me 10, prej të cilëve njëri përdor shumëzimin me shkrim, kurse tjetri e shumëzon përmendsh numrin e fituar treshifrorë me 10.

Rezultatet e fituara i shkruajnë në tabelë.

Për shembull: I fitojnë shifrat 3, 4, 2 dhe e formojnë numrin 342. Gjej numrin që fitohet nga shumëzimi 342·10 ?

Së pari plotëso tabelën, kurse pastaj vazhdo me hedhjen e zareve.

·10	Shumëzim me shkrim	Shumëzim përmendsh
463		
126		
325		
515		
128		
282		
315		
432		

Pas mbarimit të lojës, me nxënësit diskutojmë se cila mënyrë ishte më e shpejtë.

7 Vështro! 5140 : 10 = 514. Përgjigju!
Kur një numër i dhënë pjesëtohet me 10, fitohet një numër _____
pesë herë më i vogël se numri i dhënë.
Shifra e mijësheve bëhet shifër e _____
Shifra e qindësheve bëhet _____
Shifra e njësheve fitohet me zhvendosjen e shifrës së
_____
Numri i fituar a e ka numrin e njëjtë të shifrave sikurse numri i dhënë? Pse?

_____

_____

8 Eli kishte 4300 denarë në 4 bankënota nga 1000 denarë dhe 3 monedha nga 100 denarë. Bleu fanellë që kushtoi 10 herë më pak se shuma e të hollave që kishte. Nga paratë e mbetura ka blerë edhe pantallona që i kushtuan 10 herë më pak se shuma e parave që kishin mbetur.

Sa kushton fanella e Elit?

_____

Sa kushtojnë pantallonat e saj?

_____

Sa para i mbetën pa shpenzuar?

_____

Sa bankënota dhe monedha me vlerë më të madhe mund ta paraqesin shumën e re të denarëve që ka Eli?

_____

ZGJIDHIM DETYRA PROBLEMORE

SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI

1 Nxënësit e klasës së katërt u ftuan të marin pjesë në garën për përpunimin e habitateve të reja të kafshëve në kopshtin zoologjik. Duhet ta paramendojnë dhe vizatojnë hapësirën për jetesë, por edhe të llogarisin se sa material nevojitet për t'u rrethuar habitatet e reja.

Plotëso tabelën:
Format kanë gjatësi të njëjtë në secilën anë.
Sa anë kanë format e habitateve të rrethuara?
Sa material për rrethim duhet të blihet? Po nëse rrethohet dyfish për shkak të sigurisë së vizitorëve?
Nëse materiali kushton 10 denarë për një metër, sa të holla nevojiten?

Format 2D të hapësirës	Gjatësia e anëve (metra)	Numri i anëve	Gjatësia e materialit të nevojshëm për rrethim	Çmimi i përgjithshëm i i kostove të materialeve	Çmimi për rrethim të dyfishtë
Trekëndëshi	87 m	3	$87 \cdot 3 = 261$	$261 \cdot 10 = 2610$	$2610 + 2610 = 5220$
Katrori	67 m				
Pesëkëndëshi	56 m				
Gjashtëkëndëshi	49 m				
Shtatëkëndëshi	43 m				
Tetëkëndëshi	46 m				
Nëntëkëndëshi	27 m				
Dhjetëkëndëshi	19 m				

Dizajno propozimin tënd! Njehso çmimin e kostos së materialit për rrethim njëfish dhe dyfish. Diskutoni në klasë. Zgjedhni propozimet më kreative dhe më ekonomike!

2

Ndërtojmë akuariumin!

Në kopshtin zoologjik ndërtohet një akuarium i ri. Duhet të blihen lloje të reja peshqish me një buxhet prej 10000 denarëve.
Vendos cilët peshq do t'i blesh. Zgjedh lloje të ndryshme të peshqve! Zgjedh, së paku nga 10 peshq prej secilit lloj.

Njehso çmimin e përgjithshëm që duhet paguar për zgjidhjen e bërë. A do të kesh të holla të mjaftueshme?

Përzgjedhja e peshqve dhe çmimi i tyre është dhënë në tabelë:

Pendëkuqi 40 den.	Peshku zebër 70 den.	Peshku me pika 90 den.	Pendëverdhi 50 den.
Peshku zebërkuq 30 den	Gara rufa 60 den.	Peshku tigrik 80 den.	Pendërreze 100 den.

Bëje listën e peshqve menumrin, çmimin e tyre dhe çmimin e përgjithshëm të kostos.
Krijo një tabelë për prezantim më të lehtë. Prezento para klasës dhe arsyeto zgjedhjen tënde. (mund të tregosh edhe ndonjë veti të peshqve të zgjedhur nëse gjen informacione rreth tyre...)
Le të prezantojnë zgjedhjet e veta edhe nxënësit e tjerë.
Në fund, votoni! Përzgjidhni atë zgjedhje që është më ekonomike dhe me më shumë lloje peshqish!



SHUMËZIMI I NUMRAVE ME NUMËRNJËSHIFROR ME NDIHMËN E ZBËRTHIMIT

SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI

Në një koshere kishte 314 bletë.
Sa bletë ka gjithsej në 4 koshere?
E zbërthejmë numrin në qindëshe, dhjetëshe dhe njëshe 314 = 300+10+4

314·4=(300+10+4)·4=(300·4)+(10·4)+(3·4)=1200+40+16=1256

1 Njehso prodhimet, duke zbërthyer shumëzuesit!

$321 \cdot 3 = (300 + 20 + 1) \cdot 3 =$
$456 \cdot 4 =$
$7 \cdot 640 =$
$987 \cdot 8$
$222 \cdot 5 =$

2 Në Shtip ka 5 shkolla fillore. Në secilën shkollë ka nga 852 nxënës. Sa nxënës ka gjithsej në Shtip?

3 Në një pemishte janë mbjellë 6 rreshta me 138 fidanë mollë, 8 rreshta me 203 fidanë kumbulla dhe 7 rreshta me 199 fidanë vishnja.

Nga sa fidanë prej secilit lloj ka në pemishte?

Sa fidanë ka gjithsej në pemishte?

4 Sa është prodhimi i numrave 576 dhe 9?

Po i numrave 8 dhe 612?

Cili prodhim është më i madh dhe për sa?

PJESËTIMI I NUMRIT DYSHIFROR ME NUMËR NJËSHIFROR, PA MBETJE

SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI

Në dy rafte duhet të radhiten 8 fjalorë dhe 6 enciklopedi, ashtu që të ketë numër të njëjtë librash nga
secili lloj. Nga sa libra dhe prej cilit lloj do të ketë në secilin prej rafteve?

Mënyra e parë: $(8 + 6) : 2 =$
$8 : 2 + 6 : 2 = 4 + 3 = 7$
Mënyra e dytë: $(8 + 6) : 2 =$
$14 : 2 = 7$

1. Shumën e numrave 9 dhe 6 zvogëloje për 3 herë!
2. Shumën e numrave 50 dhe 35 zvogëloje për 5 herë!
3. Ndryshimin e numrave 32 dhe 16 zvogëloje për 8 herë!

Çmimi i 3 palë çorapeve është 42 denarë. Sa kushton një palë çorape, nëse të gjitha çorapet e kanë çmimin e njëjtë?

$42 : 3 = (30 + 12) : 3 = 30 : 3 + 12 : 3 = 10 + 4 = 14$
Secila palë e çorapeve kushton nga 14 denarë.

Pjesëtimi mund të bëhet edhe me metodën e pjesëtimit me shkrim.

1. Fillojmë me pjesëtimin e shifrës së dhjetësheve 4 me 3. 4 e përmban një herë 3, andaj te herësi shkruajmë 1.
Shumëzojmë 3 me 1, atë prodhim e shkruajmë nën 4 dhe e gjejmë ndryshimin. Ai është 1 dhe e shkruajmë në vendin e dhjetësheve.

2. Pranë këtij numri e zbresim shifrën e njësheve nga i pjestueshmi, ajo është 2. E përsërisim procedurën nga hapi paraprak. Tani caktojmë sa 3 përmban numri 12. Ajo është 4, këtë numër e shkruajmë si shifër të njësheve te herësi. E gjejmë prodhimin e numrave 4 dhe 3, që është 12 dhe e zbresim nga 12. Ky ndryshim është 0. Këtu pjesëtimi përfundon.
Fituam herësin 14 dhe shkruajmë 42: 3 = 14.

DHM
42:3=14
-3
12:3
-12
0

1 Bëje pjesëtimin me shkrim dhe gjeje herësin!



96 : 8 =	56 : 4 =	84 : 7 =

2 Në bibliotekën e shkollës ka 93 libra të ndarë në 3 rafte njëlloj. Nga sa libra ka në secilin raft?

3 Është dhënë një grup me numra dyshifrorë dhe një grup me numra njëshifrorë. Për secilin numër dyshifrorë, shiko se me cilin numër njëshifrorë mund të pjesëtohet? Këtë bëje me ndihmën e boshtit numerik!





4 Iva shkoi në shëtitje me shokët e saj të shkollës. Udhëtuan të vendosur në 3 autobusë me nga 32 nxënës.
Sa nxënës kanë shkuar në shëtitje?
Në hotelin ku u vendosën, fjetën në dhoma dykrevatëshe. Sa dhoma gjithsej ishin të zëna nga nxënësit?



Nëse do të mësosh më tepër, zbato njohuritë e mëparshme!

Si do ta gjesh herësin 462:3 duke bërë zbërthimin e të pjesëtueshmit?
Si do ta bësh mënyrën e zbërthimit? Mendo, provo zbërthimin dhe sqaro!

462 : 3 = (300 + 150 + 12) : 3 = 300 : 3 + 150 : 3 + 12 : 3 = 100 + 50 + 4 = 154

5 Njehso herësin me zbërthimin e të pjesëtueshmit!

549 : 9 =
804 : 4 =
672 : 3 =
784 : 8 =

6 Ana ka 903 fotografi dhe ato duhet t'ua ndajë në pjesë të barabarta Ivës, Ardit dhe Enës. Nga sa fotografi do të marrë secili prej fëmijëve?

7 Numrin 1000 ndaje në 5 pjesë të barabarta.

8 I pjesëtueshmi është 936, kurse pjesëtuesi është 4. Sa është herësi?

9 Shitësi në librari fitoi 808 denarë nga shitja e lapsave. Nëse një laps kushton 8 denarë, sa lapsa ka shitur?

10 Ndryshimin e numrave 1018 dhe 280 zvogëloje për 6 herë!

11 Aida shkoi në shitore dhe bleu 4 kg patate, 5 kg domate dhe 3 kg tranguj. Për patatet pagoi 124 denarë, për domatet 265 denarë, kurse për trangujt 243 denarë. Nga sa denarë pagoi Aida për një kilogram nga secili lloj i perimeve?

12 Me rastin e ditëlindjes, nëna i bleu Anës 4 pako me gjithsej 156 çokollata dhe 5 pako me gjithsej 115 sheqerka. Nga sa çokollata kishte në secilën pako? Nga sa sheqerka kishte në një pako?

PJESËTIMI ME MBETJE I NUMRIT DYSHIFROR ME NUMËR NJËSHIFROR

1 Shkojmë për vizitë në një restorant pranë liqenit të Ohrit!

Gjatë ekskursionit shkollor do të vizitohet Ohri dhe do të drekohet në një restorant buzë liqenit. Në secilën tavolinë të restorantit mund të ulen më së shumti 6 veta. Sa tavolina nga 6 veta duhen gjithsej nëse drekojnë 52 nxënës dhe arsimtarë? A do të mbeten karrige bosh? Njehso, trego llogaritjen dhe sqaro përgjigjen.

Udhëzim: Numri 52 a është shumëfish i numrit 6? Cili është numri më i vogël më afër numrit 52 që e përmban numrin 6? Sa mbetet deri te numri 52? Ai numër, është më i vogël apo më i madh se 6?

52 : 6 = (48 + 4) : 6 = 48 : 6 + 4 : 6 = 8 + 4 : 6
Numrin 4 e quajmë mbetje gjatë pjesëtimit të 52 me 6. Mbetja gjithmonë është më e vogël se pjesëtuesi.

Si e caktojmë mbetjen duke e përdorur mënyrën e pjesëtimit me shkrim?

Dhj
52:6=8
-48
4 - mbetje
4<6

Njehso në rast se në tavolinë mund të ulen edhe nga 4 ose nga 8 veta.

2 Nga sa monedha prej 10 denarësh më së shumti mund të ketë në secilën tubë prej:

a) 47 denarëve _____ ç) 75 denarëve _____

b) 99 denarëve _____ d) 15 denarëve _____

c) 84 denarëve _____ dh) 37 denarëve _____

Sa dhe cilat monedha mund t'i zgjedhësh për ta plotësuar shumën e parave që është tepricë?

_____

3 63 banane u janë ndarë 5 fëmijëve. Secili fëmijë ka marrë numrin e njëjtë të bananeve. Sa banane kanë mbetur pa u ndarë?

4 Në klasën e parë kanë qenë të regjistruar gjithsej 73 filloristë. Nëse në bankë mund të ulen më së shumti 2 nxënës, sa banka gjithsej nevojiten për t'u ulur të gjithë filloristët? A do të ulet secili nxënës pranë një shoku?



5 Në aeroport ka pasur gjithsej98 udhëtarë që nevojitej të shpërndahen nëpër taksi. Në secilin taksi kanë mundur të sistemohen më së shumti 4 udhëtarë. Sa taksi do të nevojiten që të barten të gjithë udhëtarët nga aeroporti? Sa udhëtarë do të mbeten në taksinë e fundit?

6 Në një shkollë është organizuar gjatë fundjavës një piknik në vendin më të afërt për piknik. Në vendin për piknik, nxënësit janë vendosur nëpër tenda për 5 veta. Sa tenda janë hapur në vendin për piknik, sipas ditëve? Të dhënat janë shënuar në tabelën në vijim:

Dita	Numri i përgjithshëm i nxënësve	Numri i tendave	Prezanto përllogaritjen
E shtunë	95		
E diel	73		

RAPORTI – PROPORCIONI

SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI

Shiko hartën gjeografike. Si do t'i lexosh të dhënat në hartë? Si do ta caktosh largësinë ndërmjet dy qyteteve nga shteteve të ndryshme me ndihmën e hartës? Cili informacion do të ndihmojë për këtë?

Secila hartë gjeografike përmban informacione për raportin ndërmjet largësisë në hartë dhe largësisë reale në natyrë. Prandaj mund të themi se harta na jep një pasqyrë për gjendjen reale të zvogëluar për raportin e dhënë.

1 Legjenda në hartë tregon se 1cm në hartë është 4 km në realitet. Largësia ndërmjet dy qyteteve në hartë është 8 cm. Sa është largësia reale ndërmjet dy qyteteve?

a) 2 km b) 8 km c) 16 km ç) 32 km

A ke bërë eksperiment duke vëzhguar nga mikroskopi? A mund të sqarosh se si është e mundur të shihet „e padukshmja"? Përdor zmadhimin e fotografisë reale dhe të asaj nga mikroskopi (raport).

Ndonjëherë raporti përdoret edhe në situata reale. Shqyrto dhe zgjidh problemet në vijim duke i përdorur operacionett e shumëzimit dhe pjesëtimit:

2 Tea, Kire dhe Arditi këmbejnë fotografi kafshësh, sportistësh dhe personazhesh vizatimore në këtë mënyrë:



a) Tea ka 5 fotografi kafshësh. I ka këmbyer me fotografi të personazheve vizatimore. Sa do të marrë?

b) Kire do të këmbejë 8 fotografi kafshësh me fotografi sportistësh. Sa do të marrë?

c) Arditi ka 6 fotografi kafshësh dhe do t'i këmbejë për më shumë fotografi. Çfarë do të bëjë Arditi?

ç) Tea këmben 15 fotografi kafshësh me fotografi sportistësh. Sa fotografi do të marrë Tea?

d) Kire këmben 8 fotografi të personazheve vizatimore me fotografi sportistësh. Sa do të marrë?

3 Në një punëtori rrobaqepësie janë qepur 10 këmisha të njëjta. Rrobaqepësi ka shpenzuar gjithsej 500 cm pëlhurë. Sa pëlhurë nevojiten që të qepen 3 këmisha?

4 Për prodhimin e 20 litrave lëng, janë përdorur 20 litra ujë, 10 kilogramë sheqer, 10 kilogramë pemë. Nga sa prej përbërësve nevojiten që të prodhohen 4 litra lëng?



5 Në një libër të ilustruar ujku është vizatuar me lartësi 10 cm, dhelpra me lartësi 8 cm, kurse qeni me lartësi 9 cm. Vizatimet janë në raport $\frac{2}{3}$. Sa është lartësia reale e këtyre tri kafshëve? Cila kafshë është më e lartë?

		
Lartësia reale e ujkut: _____	Lartësia reale e dhelprës: _____	Lartësia reale e qenit: _____

6 Në një magazinë arritën 1000 kilogramë sheqer, 500 kilogramë kripë dhe 2000 kilogramë miell. Një tregtar ka kërkuar $\frac{1}{5}$ e asaj sasie. Nga sa kilogramë sheqer, kripë dhe miell ka blerë tregtari nga magazina?

7 Lartësia e kafshëve në fotografi është paraqitur më e vogël në raport me lartësinë e tyre reale.
Të mundohemi ta gjejmë lartësinë e tyre reale duke i shfrytëzuar thyesat e shënuara poshtë secilës fotografi.

Kaprolli 18 cm Kjo është $\frac{1}{4}$ e lartësisë reale. Lartësia reale është ___	Gorila 8 cm Kjo është $\frac{1}{20}$ e lartësisë reale. Lartësia reale është ___	Tigri 9 cm Kjo është $\frac{1}{10}$ e lartësisë reale. Lartësia reale është ___	Përtaci-Ksenarta 12 cm Kjo është $\frac{1}{4}$ e lartësisë reale. Lartësia reale është ___
Dhelpra e kuqe 8 cm Kjo është $\frac{1}{6}$ e lartësisë reale. Lartësia reale është ___	Luani 9 cm Kjo është $\frac{1}{10}$ e lartësisë reale. Lartësia reale është ___	Shqiponja 7 cm Kjo është $\frac{1}{3}$ e lartësisë reale. Lartësia reale është ___	Ketri 3 cm Kjo është $\frac{1}{4}$ e lartësisë reale. Lartësia reale është ___
Rakuni 6 cm Kjo është $\frac{1}{6}$ e lartësisë reale. Lartësia reale është ___	Majmuni 10 cm Kjo është $\frac{1}{10}$ e lartësisë reale. Lartësia reale është ___	Ariu 7 cm Kjo është $\frac{1}{3}$ e lartësisë reale. Lartësia reale është ___	Panda 8 cm Kjo është $\frac{1}{4}$ e lartësisë reale. Lartësia reale është ___
Deveja 10 cm Kjo është $\frac{1}{6}$ e lartësisë reale. Lartësia reale është ___	Lepuri 5 cm Kjo është $\frac{1}{10}$ e lartësisë reale. Lartësia reale është ___	Lemur 8 cm Kjo është $\frac{1}{3}$ e lartësisë reale. Lartësia reale është ___	Gjirafa 5 cm Kjo është $\frac{1}{4}$ e lartësisë reale. Lartësia reale është ___

a) Cila kafshë është më e lartë dhe sa është lartësia e saj?

b) Cila nga kafshët është më e ulët dhe sa është lartësia e saj?

c) A ka kafshë me lartësi të njëjtë dhe cilat janë ato?

ç) Cila është lartësia reale e devesë, ndërsa luani sa është i lartë?

d) Krahaso lartësinë e lepurit dhe ketrit. Çfarë vërejte?

SHPREHJET NUMERIKE

SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI



Në dritaren e dhomës së saj, Ana ka 3 saksi me nga 3 manushaqe dhe një saksi me 2 manushaqe.

Sa lule ka gjithsej Ana në dritaren e dhomës së saj?

Ana: Unë do ta llogaris kështu:
$3 + 3 + 3 + 2 =$ ____
Kire: Unë do ta llogaris kështu:
$(3 + 3 + 3) + 2 =$ ____
Aliu: Kurse unë do ta llogaris kështu:
$3 \cdot 3 + 2 =$ ____ $+ 2 =$ ____
Eda: Unë mendoj ta llogaris kështu
$2 + 3 \cdot 3$ ____ $+ 9 =$ ____ .

Të gjithë arritën rezultatin e njëjtë dhe të gjithë bënë përllogaritjen e saktë, por në mënyra të ndryshme.

Ana e ka harruar dritaren hapur. Ka fryer erë e fortë dhe dy saksi janë thyer. Sa lule kanë ngelur në dritare?

Ana e njehsoi kështu:
$11 - 3 - 3 =$ ____
Kire e njehsoi kështu:
$11 - (3 + 3) =$ ____ $-$ ____ $=$ ____
Nuk na duhen kllapa, ka thënë Arditi.
$11 - 2 \cdot 3 = 11 -$ ____ $=$ ____ .
Eda e njehsoi në këtë mënyrë:
$11 - 3 \cdot 2 =$ ____ $-$ ____ $=$ ____ .

Çfarë vëreni?

MBAJ MEND

Në shprehje numerike së pari llogaritet shprehja në kllapa. Nëse nuk ka kllapa, së pari kryhen e operacionet e shumëzimit dhe pjesëtimit, pastaj, mbledhja dhe zbritja

Renditja e kryerjes së operacioneve në shprehjet numerike me më shumë operacione:
1. Shumëzim ose pjesëtim
2. Mbledhja ose zbritja
3. Renditja e kryerjessë operacioneve ndryshon në qoftë se ka shprehje në kllapa. Atëherë ka përparësi llogaritja e shprehjes/ shprehjeve në kllapa!

1 Njehso:

$3 + 4 \cdot 2 + 5 = ?$

$\square + \square + \square = \square$

$(3 + 4) \cdot 2 + 5 = ?$

$\square \cdot \square + \square = \square$

$3 + 4 \cdot (2 + 5) = ?$

$\square + \square \cdot \square = \square$

2 Njehso:

$4 + 5 \cdot 3 =$ _____

$4 + 3 \cdot 5 + 2 =$ _____

$(4 + 5) \cdot 3 =$ _____

$4 + 3 \cdot (5 + 2) =$ _____

$8 \cdot 4 - 3 =$ _____

$8 \cdot (4 - 3) =$ _____

3 Njehso:

Numrin 6 zmadhoje për 4 herë!

_____

Prodhimin e numrave 9 dhe 4 zmadhoje për 14!

_____

Prodhimin e numrave 7 dhe 3 zvogëloje për 9!

_____

Numrin 4 zmadhoje për 6, kurse numrin e fituar zmadhoje për 2 herë!

_____

Ndryshimin e numrave 50 dhe 45 zmadhoje për 4 herë!

_____

Ndryshimin e numrave 50 dhe 45 zmadhoje për 4!

_____

4 Në një shkollë pushimi i vogël zgjat 5 minuta, kurse pushimi i madh 20 minuta. Sa minuta zgjasin të gjitha pushimet në shkollë, nëse nxënësi ka 4 orë?

5 Në familjen e Onurit ka 3 fëmijë. Onuri ka 8 vjet. Vëllai i tij është dy herë më i vjetër se ai, kurse motra është 2 vjet më e re se Onuri. Nga sa vjet kanë vëllai dhe motra e Onurit? Sa vjet kanë gjithsej të tre fëmijët?

Zgjidhje: _____

_____

Përgjigje: _____

_____



6 Njehso vlerën e shprehjes numerike duke patur kujdes për radhitjen e kryerjes së operacioneve.

a) $3 \cdot 7 + 5 =$ $\quad$ $7 + 2 \cdot 6 =$

$6 \cdot 6 - 4 =$ $\quad$ $47 - 5 \cdot 6 =$

b) $16 : 4 + 9 =$ $\quad$ $9 + 30 : 5 =$

$36 : 4 - 8 =$ $\quad$ $7 - 28 : 7 =$

c) $6 + 4 \cdot 2 - 3 =$ $\quad$ $5 + 7 - 32 : 4 =$

$6 \cdot 8 - 9 \cdot 2 + 7 =$ $\quad$ $70 : 7 + 19 - 72 : 8 =$

7 Sa këmbë kanë së bashku katër qen dhe tre shpezë?



8 Numrin 56 zvogëloje për herësin e numrave 49 dhe 7.

9 Në kampionatin e futbollit, për fitore merren 3 pikë, për rezultatin baraz 1 pikë, kurse për humbje nuk fitohen pikë. Një ekip futbolli ka fituar 11 pikë. Sa ndeshje i'u desh të luante së paku që t'i fitonte ato pikë?



10 Ana ka bërë vargun e numrave në këtë mënyrë:

3 → 8
4 → 10
5 → 12

Me anë të cilit rregull Ana i ka fituar numrat?

a) shumëzo me 1 dhe shto 5
b) shumëzo me 2 dhe shto 2
c) shumëzo me 3 dhe zbrit 1
ç) shumëzo me 4 dhe zbrit 4

Shkruaj edhe disa anëtarë në vargun me numra!

11 Ana dhe Emiri, që jetojnë në të njëjtën ndërtesë, çdo ditë i kalojnë 7 kilometra deri në shkollë dhe 7 kilometra kur kthehen nga shkolla. Ata shkojnë në shkollë 5 ditë të javës. Të hënën, të mërkurën dhe të premten, kthehen në shtëpi, hanë ushqim dhe shkojnë të luajnë në parkun e qytetit që është 5 kilometra larg ndërtesës së tyre, kurse pastaj kthehen për darkë në shtëpi. Sa kilometra kalojnë çdo javë?



12 Bankënota prej 50 denarëve duhet të këmbehet në monedha 2 dhe 5 denarëshe. Numri i monedhave është 16. Po të bëhet ky këmbim, nga sa monedha 2 denarëshe dhe nga sa monedha 5 denarëshe do të përdoren?

13 Shuma e numrave 24 dhe 16 e zmadhuar 2 herë është:

a) 60

b) 40

c) 80

ç) 70

14 Ndryshimi i numrave 52 dhe 24 i zvogëluar 4 herë është:

a) 3

b) 6

c) 7

ç) 2

NJEHSIMI I SHUMËZUESIT, TË PJESËTUESHMIT DHE PJESËTUESIT TË PANJOHUR

SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI

MBAJ MEND

Shumëzimi dhe pjesëtimi janë operacione inverse.

Për të gjetur shumëzuesin e panjohur, shfrytëzohet lidhja ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit.

10 · ☐ = 30

☐ = 30 : 10

☐ = 3

1 Si do të veprojmë nëse e kemi të panjohur njërin prej shumëzuesve, kurse e dimë prodhimin e tyre?

☐ · 40 = 600

☐ = 600 : 40

☐ =

◯ · 3 = 87

◯ = _____ : 3

◯ =

Shumëzuesi i panjohur gjendet nëse prodhimin e pjesëtojmë me shumëzuesin tjetër.

2

8 0 : ◯ = 20

◯ = 80 : 20

◯ = 4

Pjesëtuesi i panjohur gjendet nëse të pjesëtueshmin e pjesëtojmë me herësin.

◯ : 6 = 250

◯ = 250 · 6

◯ = 1500

I pjesëtueshmi i panjohur gjendet nëse e shumëzojmë pjesëtuesin me herësin.

3

Prodhimi i dy numrave është 425, kurse njëri prej shumëzuesve është 5. Përcakto shumëzuesin tjetër.

4 Në një kuti ka pasur 816 gota plastike. Shitësja nga kutia ka nxjerë 9 herë numrin e njëjtë të gotave dhe i ka radhitur në rreshta. Nga sa gota ka në secilin rresht?

5 Cili numër i zmadhuar për 6 herë e jep numrin 450?

6 Ivana mendoi një numër. Kur e pjesëtoi atë me numrin më të madh çift të dhjetëshes së parë e fitoi numrin 429. Cilin numër e mendoi Ivana?

TEMA 3

MBLEDHJA DHE ZBRITJA E THYESAVE

MBLEDHJA DHE ZBRITJA E THYESAVE ME EMËRUES TË NJËJTË

PËRDORIMI I BARABARSISË SË THYESAVE PËR MBLEDHJEN DHE ZBRITJEN E THYESAVE TË RREGULLTA

DUKE I SJELLË NË EMËRUES TË NJËJTË

GJETJA E PJESËS SË NUMRAVE DERI NË 100

NUMRAT DHJETORË PJESËTIMI I NUMRAVE DERI NË 1000 ME 10 DERI NË NJË DHJETORE

SITUATA PROBLEMORE NGA JETA E PËRDITSHME QË ZGJIDHEN PËRMESOPERACIONEVE ME NUMRA

ME EMËRUES TË NJËJTË

MBAJ MEND

Shuma e thyesave me emërues të njëjtë është thyesë me të njëjtin emërues, kurse numëruesi përcaktohet si shuma e numëruesve të mbledhësve.

1 Sara, për të mbështjellë dhe dekoruar një dhuratë për ditëlindje, bleu 6 metra shirit. $\frac{2}{5}$ e shiritit e harxhoi për mbështjellje të kutisë, kurse e përdori për të lidhur fjongon. Sa shirit harxhoi Sara për të dekoruar dhuratën?



Si do ta caktosh shumën?
A mund të të ndihmojë muri me thyesa?

$$\frac{2}{5} + \frac{1}{5} = \frac{2+1}{5} = \frac{3}{5}$$

E sata pjesë e shiritit ka mbetur e pashfrytëzuar? Shfrytëzo murin e thyesave!

Nëse gjithë shiritin e llogarisim si tërësi, atëherë mund ta ndajmë në 5 pjesë të barabarta dhe tërësia paraqet 5 pjesë. Shkruajmë:

$$1 = \frac{5}{5}$$

$$\frac{5}{5} - \frac{3}{5} = \frac{5-3}{5} = \frac{2}{5}$$

MBAJ MEND

Ndryshimi i thyesave me emërues të njëjtë është thyesë me po atë emërues, numëruesi fitohet si ndryshim i numëruesve të të zbritshmit dhe zbritësit.

2

Mblidhi thyesat, - pastaj paraqite shumën në mënyrë grafike me ngjyrosje.

$\frac{6}{12} + \frac{3}{12} =$

$\frac{3}{7} + \frac{1}{7} =$

$\frac{5}{9} + \frac{2}{9} =$

$\frac{6}{12} + \frac{4}{12} =$

$\frac{5}{16} + \frac{9}{16} =$

$\frac{12}{14} + \frac{2}{14} =$

3

Njehso shumën e thyesave.

$\frac{4}{12} + \frac{5}{12} = _$

$\frac{3}{9} + \frac{2}{9} = _$

$\frac{1}{7} + \frac{3}{7} = _$

$\frac{1}{5} + \frac{2}{5} = _$

$\frac{2}{10} + \frac{5}{10} = _$

$\frac{3}{13} + \frac{4}{13} = _$

$\frac{3}{8} + \frac{1}{8} = _$

$\frac{4}{11} + \frac{3}{11} = _$

4 Cakto shumën e thyesave! Si mund ta shkruash ndryshe?

$\frac{7}{12} + \frac{9}{12} =$ $\frac{9}{22} + \frac{8}{22} =$

$\frac{5}{15} + \frac{9}{15} =$ $\frac{12}{25} + \frac{9}{25} =$

5 Zbriti thyesat në vazhdim. Përdore murin me thyesa!

$\frac{7}{9} - \frac{1}{9} =$ $\frac{4}{6} - \frac{1}{6} =$ $\frac{6}{8} - \frac{1}{8} =$

$\frac{6}{9} - \frac{1}{9} =$ $\frac{5}{7} - \frac{1}{7} =$ $\frac{3}{5} - \frac{1}{5} =$

$\frac{3}{6} - \frac{1}{6} =$ $\frac{5}{8} - \frac{1}{8} =$ $\frac{4}{7} - \frac{1}{7} =$

$\frac{5}{9} - \frac{1}{9} =$ $\frac{2}{5} - \frac{1}{5} =$ $\frac{2}{6} - \frac{1}{6} =$

$\frac{4}{9} - \frac{1}{9} =$ $\frac{4}{8} - \frac{1}{8} =$ $\frac{3}{7} - \frac{1}{7} =$

$\frac{5}{12} - \frac{1}{12} =$ $\frac{4}{3} - \frac{1}{3} =$

$\frac{7}{14} - \frac{3}{14} =$ $\frac{14}{18} - \frac{12}{18} =$

$\frac{6}{9} - \frac{1}{9} =$ $\frac{6}{15} - \frac{3}{15} =$

$\frac{7}{10} - \frac{2}{10} =$ $\frac{8}{20} - \frac{4}{20} =$

$\frac{6}{12} - \frac{4}{12} =$ $\frac{4}{7} - \frac{3}{7} =$

6 Cakto shumën e thyesave! Si mund ta shkruash ndryshe?

$\frac{9}{16} + \frac{7}{16} =$ $\frac{5}{12} + \frac{7}{12} =$ $\frac{8}{25} + \frac{20}{25} =$

7 Cila është thyesa me emërues të njëjtë që mungon te shprehjet numerike?

$\frac{6}{10} - \frac{\square}{\square} = \frac{2}{10}$ $\frac{4}{8} - \frac{\square}{\square} = \frac{1}{8}$ $\frac{5}{7} - \frac{\square}{\square} = \frac{3}{7}$

SHFRYTËZIMI I BARABARSHMËRISË SË THYESAVE PËR MBLEDHJEN DHE ZBRITJEN E THYESAVE TË RREGULLTA ME SJELLJEN E TYRE NË EMËRUES TË PËRBASHKËT

MBLEDHJA DHE ZBRITJA E THYESAVE

1 Zbrit thyesat e mëposhtme. Shfrytëzo murin me thyesa.



Pjesa e ngjyrosur: _____



Pjesa e ngjyrosur: _____

Çfarë vëren? Si janë thyesat e fituara? _____



Pjesa e ngjyrosur: _____



Pjesa e ngjyrosur: _____

Krahaso thyesat e fituara. _____

2

Shikoj murin me thyesa. Gjej thyesa të barabarta.
Për shembull: $\frac{1}{2} = \frac{2}{4} = \frac{3}{6} =$

Sqaro!

A mund të caktosh shumën e thyesave $\frac{1}{2} + \frac{1}{4}$ Duke e shfrytëzuar murin me thyesa?

Po sa është ndryshimi $\frac{1}{2} - \frac{1}{4}$?



3

Me ndihmën e murit me thyesa, gjej shumat dhe ndryshimet:

$\frac{1}{2} + \frac{2}{6} =$ ____ $\frac{1}{5} + \frac{3}{10} =$ ____ $\frac{1}{4} + \frac{5}{8} =$ ____

$\frac{1}{2} - \frac{1}{6} =$ ____ $\frac{9}{12} - \frac{2}{6} =$ ____ $\frac{2}{3} - \frac{4}{6} =$ ____

4

Markoja dhe Pjetri kanë shkuar në restorant për të ngrënë pica. Kamerieri ua solli nga një picë. Picat e të dyve ishin të ndara në pjesë të ndryshme. Shkruaj, çfarë pjese të picës kanë ngrënë secili prej tyre!





Markoja ka ngrënë _____ Pjetri ka ngrënë _____

Sa pjesë të picës kanë ngrënë gjithsej Markoja dhe Pjetri? A kanë mundur të hanë një picë të tërë?

_____

5 Aleku dhe Mia kanë blerë nga një çokollatë. Aleku e ndau çokollatën e vet në 5 pjesë të barabarta dhe hëngri 3 pjesë prej tyre. Mia e ndau çokollatën e saj në 10 pjesë të barabarta dhe hëngri 7 nga ato.
Cili prej tyre ka ngrënë pjesën më të madhe të çokollatës?

Çfarë pjese të çokollatës?

Udhëzim: Shfrytëzo murin me thyesa.

6 Bojani dhe Markoja vendosën të luajnë basketboll me shokët e tyre në sallën sportive. Pas përfundimit të ndeshjes, prindërit e tyre i pyetën se nga sa kosha kanë shënuar. Bojani është përgjigjur se ka $\frac{2}{5}$ shënuar nga numri i përgjithshëm i koshave, kurse Kire tha se ka shënuar $\frac{4}{10}$.

Cili prej tyre ka shënuar më shumë kosha, nëse të dy kanë luajtur për ekipin e njëjtë?

GJETJA E PJESËVE TË NUMRAVE DERI NË 100

TË RIKUJTOHEMI

Rikujtohu çka paraqet vija thyesore te shënimi i thyesës! Çka paraqesin numëruesi dhe emëruesi?

Numëruesi

$$\frac{2}{8}$$

Vija thyesore

Emëruesi

Sa është $\frac{2}{8}$ e 64?
64 e ndajmë në 8 pjesë të barabarta dhe fitojmë 64: 8 = 8.
Tani do të marrim 2 pjesë, pra 2 · 8 =
16. Domethënë, $\frac{2}{8}$ e 64 është 16.

1 Marko ka sjellë një kuti me sheqerka dhe ua ndau shokëve të tij. Në kuti kishte 24 sheqerka. Nga ato $\frac{1}{4}$ ia dha Anës, $\frac{1}{6}$ ia dha Eminit dhe $\frac{1}{3}$ ia dha Ardës. Nga sa sheqerka ka marrë secili prej tyre?

Sa sheqerka i kanë mbetur Markos?

Ana ka marrë nga 24 ose 24: 4 = 6 sheqerka.
Emini ka marrë _____
Arda ka marrë _____
Për Markon kanë mbetur _____

2 Ajshja kishte një koleksion prej 96 stilolapsash. Nga ato $\frac{1}{6}$ ishin stilolapsa të kaltër, $\frac{3}{12}$ stilolapsa të bardhë dhe $\frac{2}{8}$ ishin stilolapsa të kuq. Sa stilolapsa të kaltër, sa të bardhë dhe sa të kuq kishte Ajshja?

Në çfarë raporti ishin stilolapsat e bardhë dhe të kuq?

3 Në klasën e Orhanit mësonin 35 nxënës që mësonin tri gjuhë të huaja: gjuhë angleze, gjuhë italiane dhe gjuhë gjermane. Nga ta $\frac{1}{5}$ mësonin gjuhë angleze, $\frac{3}{7}$ mësonin gjuhë italiane, kurse nxënësit e tjerë mësonin gjuhë gjermane.

Nga sa nxënës prej klasës së Orhanit mësonin secilën prej gjuhëve?

NUMRAT DHJETORË PJESËTIMI I NUMRAVE DERI MË 1000 ME 10 DERI NË NJË DHJETORE

1 Nën secilën fotografi shkruaje pjesën e ngjyrosur në formë të thyesës dhe në formë të numrit dhjetor.



Thyesa: _____

Numri dhjetor: _____



Thyesa: _____

Numri dhjetor: _____



Thyesa: _____

Numri dhjetor: _____



Thyesa: _____

Numri dhjetor: _____



Thyesa: _____

Numri dhjetor: _____

$$\frac{6}{10} = 0{,}6$$

pjesa e plotë

pjesa dhjetore

presja dhjetore



2 Sa është $\frac{3}{5}$ shënuar si numër dhjetor?



Çfarë vëren? A mund ta sqarosh?

3 Plotëso vendet e zbrazëta në tabelë duke shënuar numër dhjetor të barabartë me thyesën e dhënë ose thyesë që i përgjigjet numrit të dhënë dhjetor.

Thyesa	Numri dhjetor
$\frac{3}{5}$	
	0,7
	0,3
$\frac{1}{2}$	
$\frac{1}{10}$	

Si do të pjesëtojmë me 10 numra që nuk janë dhjetëshe ose qindëshe të plota? Do të përdorim numër dhjetor për të shënuar mbetjen gjatë pjesëtimit të numrit të dhënë me numrin 10.

46 : 10 = 4,6
Gjegjësisht (40 + 6) : 10 = : 10 + 6 : 10 = 4,6
Sepse 6: 10 = $\frac{6}{10}$ = 0,6

Ngjashëm, 315 : 10 = 31,5

4 Njehso herësit dhe paraqiti me numër dhjetor:

56 : 10 = _____ 73 : 10 = _____ 302 : 10 = _____

467 : 10 = _____ 917 : 10 = _____

MBAJ MEND

Kur pjesëtojmë me numrin 10 një numër që nuk është dhjetëshe e plotë, pas shifrës dhjetëshe vendoset presje dhjetore, kurse shifra e njësheve bëhet shifër e të dhjetave.



5 Ana ka blerë 25 kg oriz. E paketoi në 10 thasë të vegjël. Nga sa kilogramë oriz ka në secilin thes?
(**Udhëzim:** Ndaje të plotën në 10 pjesë të barabarta. Përdor numrin dhjetor.)

6 Edini ka fituar 78 pikë në testin e matematikës. Testi kishte 10 detyra dhe secila detyrë është vlerësuar me numër të njëjtë pikësh. Nga sa pikë është vlerësuar secila detyrë e testit të matematikës?

SITUATA PROBLEMORE NGA JETA E PËRDITSHME QË ZGJIDHEN ME OPERACIONET ME NUMRA

MBLEDHJA DHE ZBRITJA E THYESAVE

Vlladimiri dhe prindërit e tij ishin për të blerë në qendrën tregtare. Në shitoren për veshje sportive ai zgjodhi atlete dhe tuta.
Atletet kushtonin 1500 denarë, kurse tutat 2000. Pasi që kishte zbritje të madhe, llogarinë që e paguan ishte e përgjysmuar.

Në shitoren për veshmbathje secili prej tyre ka zgjedhur dhe ka blerë pantallona. Pantallonat e Vlladimirit kushtonin 800 den. Kurse prindërit e tij, për pantallonat e tyre paguan gjithsej 1000 denarë më shumë sesa për pantallonat e Vlladimirit.
Pastaj në supermarket i kanë blerë këto produkte: 2kg pjeshka me çmimin 38 denarë për kilogram, 1,5kg domate me çmimin 40 denarë për kilogram, 3l qumësht me çmimin 52 denarë për një litër, 1,4kg peshk me çmimin 100 denarë për kilogram, dy shishe nga 1l sapun të lëngshëm nga 80 denarë për litër ku për shishen e dytë vlen çmimi i përgjysmuar me aksion.

Sa të holla kanë paguar në shitoren për veshje sportive?

Sa së të holla kanë kushtuar pantallonat e nënës?

Sa sa të holla kanë paguar për tri palë pantallona?

Sa të holla kanë harxhuar për mbathje dhe veshje?

Cila prej produkteve në supermarket ishte me çmimin më të lartë?

Sa të holla kanë paguar gjithsej në supermarket?

Sa kushtoi shishja e dytë me sapun të lëngshëm?

Nëqendrën tregtare familja e Vlladimirit shpenzoi denarë

Përgatitja e turshive:
Në familje planifikohet r përgatitja e turshive.
Ndihmoni edhe ju!

1. Vendosni çfarë duhet përgatitur!
2. Gjeni recetën për përgatitje (ajvari, turshie, lakër armeje...)
3. Përshtatni recetat sipas numrit të personave.
4. Bëni tabelën për produktet dhe sasitë e tyre të nevojshme!
5. Shkoni në treg ose kërkoni dhe merrni informacione për çmimet e produkteve që duhet t'i siguroni që të keni zahirenë e nevojshme. .
6. Caktoni buxhetin për shpenzimet.
7. Bëni njehsim mbi vlerën e çmimeve.
8. Në njehsim përfshini edhe shpenzimet e rrumbullakuara për dru, energji elektrike, ujë, ...
9. Nga ajo që keni paraparë për çfarë jeni të sigurt se mund ta bëni? Ndërsa çfarë ndoshta do ta bëni? Për çfarë do të vendosni mos ta bëni?
10.Bëni tabelën me njehsim, paraqitni me diagram dhe prezantojeni.

TEMA 4

MATJA

1 GJATËSIA

2 MASA

3 MATJA E LËNGJEVE

4 KOHA

5 PERIMETRI DHE SYPRINA

MATJA

GJATËSIA, MASA, VËLLIMI, KOHA, PERIMETRI DHE SIPËRFAQJA E FORMAVE 2D

PËR TEMËN

Në këtë temë, do t'i zgjeroni njohuritë për masat dhe matjet. Ju do t'i mësoni njësitë për matjen e gjatësisë, masës, vëllimit, kohës, perimetrit dhe sipërfaqes së formave 2D. Do të jeni në gjendje edhe të hulumtoni se si të matni gjatësinë, masën, vëllimin, kohën, perimetrin dhe syprinën e formave 2D duke përdorur instrumentet e duhura matëse.

SFIDA TË MUNDSHME

Ndodh shpesh që nxënësit ta harrojnë ekuivalencën e njësive të masës (për shembull: sa mililitra ka në një litër). Matja është një temë që nuk mësohet aq shpesh. Përsëritni këto fakte më shpesh dhe do t'u rikthehemi gjatë gjithë vitit. Disa nxënës mund të ngatërrojnë termat masë dhe peshë. Ne do të ndjekim përkufizimet përkatëse, të pasura me shembuj.



MATERIALET E NEVOJSHME DHE INSTRUMENTET MATËSE:

Vizorja, shkopinj me gjatësi të ndryshme, metri, laseri për matjen e gjatësisë, shiriti matës, makara me pe, pajisjet për peshim (peshore, pesha të ndryshme për peshim nën dhe mbi 1 kg, peshore deri në 1 kg, me ndarje në çdo 10 g dhe shenja për çdo 100 g); peshore (peshore digjitale dhe terezi), gota dhe lugë plastike për matje, qese për akull, kallëpe ëmbëlsirash, gota matëse, enë matëse, enë me forma dhe vëllime të ndryshme, orë (digjitale, analoge dhe prej rëre), kronometri, kalendari, orare udhëtimesh, fotografi, letra me katrorë në cm, kartela me orë, litari.

FJALORI i koncepteve të reja

- Njësitë matëse të gjatësisë: kilometri (km), metri (m), decimetri (dm), centimetri (cm), milimetri (mm); njësitë matëse të masës: kilogrami (kg), grami (g);
- njësitë matëse për lëng: litri (l), decilitri (dl), centilitri (cl), mililitri (ml);
- njësitë matëse të kohës: sekonda (s), minuta (min), ora(h), dekada, shekulli;
- Perimetri dhe sipërfaqja e formave 2D: perimetri, sipërfaqja e formave drejtkëndore, njësia katrore



TEMA 4

GJATESIA

METRI, CENTIMETRI

DECIMETRI

MILIMETRI

KILOMETRI

ZGJIDHJA
E SITUATAVE
PROBLEMORE ME
GJATËSINË



MATIM GJATËSI – METRI, CENTIMETRI

Sa është e gjatë klasa?
Cilën njësi matëse kemi përdorur gjatë matjes?
Matni bankën. Sa është e gjerë dhe sa e gjatë?
A mund ta matni tabelën?

Vlerësojmë dhe hulumtojmë



Largësinë midis vijave të shënuara me numra e shprehim me cm

_____ .

GJATËSIA

MBAJ MEND

NJËSIA THEMELORE PËR MATJEN E GJATËSISË ËSHTË METRI.

Me çfarë e masim gjatësinë e lapsit?

Me vizore me **centimetra** maten gjatësitë më të shkurtra.



MBAJ MEND

100 CENTIMETËR = 1 METËR
100 cm = 1 m

Vizato disa segmente në fletore. Mat gjatësinë e tyre dhe shkruaje në tabelë.
Për shembull: Segmenti $\overline{AB}$ është i gjatë 4 cm, ne shkruajmë $\overline{AB}$ = 4 cm.



	CENTIMETRA – cm
$\overline{AB}$	
$\overline{DC}$	
$\overline{EF}$	

1 **Krahaso gjatësitë e mëposhtme:**

88 cm ◯ 98 cm 6 cm ◯ 0,6 m >

40 cm ◯ 5 m 350 m ◯ 35 cm <

76 cm ◯ 65 m 128,5 m ◯ 285 cm =

2 Maria ka kaluar tri shtigje me biçikletën e saj. Shtegu i parë ishte i gjatë 350 m, i dyti 200 m dhe i treti 420m. Sa metra gjithsej ka kaluar Maria me biçikletën e saj?



3 Sara ka matur gjatësinë e tabelës duke përdorur një vizore të gjatë 30 cm. Tabela ishte 6 cm më e shkurtër se 9 herë gjatësia e vizores. Sa ishte gjatësia e tabelës?



MASIM GJATËSINË – DECIMETRI

A mund ta matësh derën? Gjatësinë prej 10 cm mund ta paraqesim dhe me **decimetër**. Sa decimetra të vizores ka në gjatësinë e fletores?

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

GJATËSIA

MBAJ MEND

DECIMETRI ËSHTË NJËSI PËR GJATËSI 10 HERË MË TË VOGËL SE METRI.

1 m = 10 dm = 100 cm
1 dm = 10 cm

60 cm = 6 dm
8 m = 80 dm
54 cm = 5 dm dhe 4 cm

1 Shndërro gjatësitë e mëposhtme në decimetra, centimetra dhe metra.

3 dm 5 cm = _____ cm 5 m 7 dm = _____ dm

2 dm 7 cm = _____ cm 1 m 9 dm = _____ dm

2 Shndërro:

47 m = ( ) dm 620 dm = ( ) m

79 dm = ( ) cm 980 cm = ( ) dm

5 dm 7cm = ( ) cm 4m 5 dm = ( ) dm

3 Një copë litar, i gjatë 60 dm, duhet të pritet në 3 pjesë të barabarta. Sa është gjatësia e secilës pjesë?

Përgjigje: _____ dm.

GJATËSIA

MASIM GJATËSINË – MILIMETRI

Milimetri është njësi për gjatësi 10 herë më e vogël se centimetri.
Sa milimetra ka në një metër?
Sa milimetra ka në një decimetër?

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

MBAJ MEND

1 m = 10 dm
1 m = 100 cm
1 m = 1000 mm

1 cm = 10 mm



1 Paraqit gjatësitë e lapsave në milimetra, centimetra dhe decimetra.



60 mm = cm = 0,6 dm

2 Vizato një vijë të thyer që përbëhet nga tri segmente me gjatësi: 15 mm, 1 dm dhe 18 cm. Paraqit shumën e gjatësive në milimetra.

MASIM GJATËSINË – KILOMETRI

GJATËSIA

Gjatësia prej 1000 m është
një **kilometër** (1 km).
Kilometri është njësi matëse me të cilën
maten gjatësi më të mëdha.
Me se e masim largësinë midis dy qyteteve?

Vlerësojmë dhe
hulumtojmë

√ MBAJ MEND

1000 m = 1 km

1 Ana, Maria dhe Iva janë shoqe. Ato vendosën të dilnin me biçikleta. Për të arritur te Maria, Ana dhe Iva duhet të kalojnë një distancë të caktuar. Sa kilometra duhet të kalojnë Ana dhe Iva për të arritur te Maria?
Kur kanë arritur te Maria, ato u pajtuan që të gjitha së bashku, duke ngarë biçikletat, të kalojnë pranë shtëpisë së Anës, që ajo të ndalet në shtëpi, kurse Maria dhe Iva të vazhdonin shtegun në mënyrë që edhe Iva të ndalet te shtëpia e vet. Në fund, edhe Maria shkoi në shtëpi.
Sa kilometra kaloi secila prej tyre?
Sa kilometra kanë kaluar të gjitha së bashku?



2 Përdorni Google Maps për të përcaktuar distancën ndërmjet qyteteve, të paraqitur në kilometra:
Shkup – Ohër _____
Koçan – Gjevgjeli _____
Kriva Pallankë – Manastir _____
Tetovë – Prilep _____
Cili destinacion është më i gjati dhe cili është më i shkurtri për të udhëtuar?



GJATËSIA

MATJA E GJATËSINË - ZGJIDHJA E UATAVE SITUATAVE PROBLEMORE ME GJATËSINË

1 Shndërro njësitë matëse:

a) 1,5 cm = ____ mm b) 6500 m = ____ km

c) 50 cm = ____ m ç) 500 m = ____ km

d) 4,3 km = ____ m dh) 3,2 m = ____ cm

2 Beti me trotinetin e saj ka kaluar tri shtigje. Shtegu i parë ishte i gjatë 1,4 km, i dyti 2,8 km dhe i treti 0,9 km. Sa metra gjithsej ka kaluar Beti me trotinetin e saj??

Shtegu i parë _____ m
Shtegu i dytë _____ m
Shtegu i tretë _____ m



3 Rretho nën secilën nga fotografitë se me çilën njësi matëse do të ishte më e përshtatshme të masni gjatësinë.

m km cm	lartësia e lapsit	m km cm	lartësia e shtëpisë
 m km cm	lartësia e gjirafës	m km cm	lartësia e dardhës
m km cm	gjatësia e gjilpërës	m km cm	gjatësia midis qyteteve
m km cm	gjatësia e gjarprit	m km cm	lartësia e palmës

TEMA 4

MASA

MASIM MASËN - KILOGRAMI

MASIM MASËN - GRAMI

MASIM MASËN – NJËSITË MATËSE PËR MASËN

MASIM MASËN - ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE ME MASËN



MASA

MASIM MASËN – GRAMI

Me çfarë njësie të masës matet çokollata?
Le të shohim peshoren! Kilogramët janë shënuar me numra. Ka vija midis secilit numër për kilogram. Ato gjithashtu tregojnë njësi më të vogla matëse se kilogrami. Me peshore mund të matet masa edhe në gram.

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

MBAJ MEND

GRAMI ËSHTË NJËSI MATËSE E MASËS 1000 HERË ME E VOGËL SE KILOGRAMI.

MBAJ MEND

1 kg = 1000 g

500 g = $\frac{1}{2}$ kg OSE

GJYSMË KILOGRAMI

1 Këto peshore matin në gramë. Njehsoni sa gramë peshojnë frutat dhe perimet e matura, duke marrë parasysh masën e dhënë të secilës prej tyre.



Portokalli dhe domatja:_____

Luleshtrydhet:_____

Molla dhe dredhëzat:_____

Dardha, speci dhe domatja: _____

Lulelakëra dhe banania: _____

Domatja dhe ananasi:_____

75 g



125 g

120 g

750 g

10 g

900 g



150 g

100 g

250 g



50 g

MASA

MASIM MASËN – KILOGRAMI

MBAJ MEND

Njësi matëse për masën është **kilogrami** – 1kg.

Të rikujtohemi!
A mendoni shpesh se sa e kanë masën objektet, njerëzit?

Çfarë njësie matëse përdorni për të shprehur masën?

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Me numrat nga 1 deri në 4 shëno artikujt nga më i lehti te më i rëndi!

2 Me çfarë do ta masnit masën e kafshëve?



Masa (pesha) e objekteve, njerëzve dhe kafshëve matet me **peshore.** Ka peshore të ndryshme. Cili është ndryshimi ndërmjet tyre?



3 Masa e objekteve nuk varet nga madhësia e tyre.
Çfarë peshon më shumë: një kilogram hekur apo një kilogram pambuk?
Cila ka peshë më të madhe: një vezë apo një tullumbace e fryrë?





4 Gjej shembuj dhe shënoji. Krahasoji ato me shembujt e nxënësve të tjerë.

MASA

MASIM MASËN – NJËSITË MATËSE PËR MASËN

MBAJ MEND

ÇDO OBJEKT KA MASË. NJËSITË MATËSE PËR MASËN JANË KILOGRAMI DHE GRAMI. ATA SHKRUHEN

1 KILOGRAM — 1 kg
1 GRAM – 1 g

1 kg = 1000 g



MBAJ MEND

500 g = $\frac{1}{2}$ GJYSMË KILOGRAMI OSE SIÇ SHKRUHET ME NUMËR DHJETOR **0,5 KILOGRAM**

PËR SHEMBULL: 1 kg E 500 GRAMË MUND TË SHKRUHET SI 1,5 k

Shiko rreth vetes dhe trego një objekt.

Gjej dy objekte, ku njëri është më i lehtë, kurse tjetri më i rëndë se ai.

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Shkruaj shkurtesat:

a) 3 kilogramë: _____

b) 500 gramë: _____

c) 5 kilogramë: _____

ç) 850 gramë _____

2 Shkruaj masat, duke përdorur shënimin dhjetor me një shifër dhjetore:

a) 2 kilogramë e 500 gramë: _____

b) 500 gramë: _____

c) 4 kilogramë e 300 gramë: _____

ç) 6 kilogramë e 400 gramë: _____

3 Me shenjat e krahasimit krahaso masat <, =, > :

40 g ◯ 4 kg 1 kg ◯ 15 g 25 g ◯ 5 kg 1000 g ◯ 1 kg

4 Pastiçieri për një tortë ka përdorur 1 kg miell, 250 g sheqer, 20 g kakao, 400 g çokollatë, 20 g puding dhe 1000 g luleshtrydhe

Çfarë ka përdorur më shumë?

_____

Çfarë ka përdorur më pak?

_____

Cili është dallimi ndërmjet masës së luleshtrydheve dhe masës së sheqerit?

_____

MASA

MASIM MASËN - ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE ME MASËN

1 Gjyshja Jeta dhe gjyshi Bardhi kanë shkuar në treg dhe kanë blerë fruta e perime. Gjyshja mbante qesen me fruta në të cilën kishte: 1 kg mollë, 500 g qershi dhe 2 kg rrush. Gjyshi mbante qesen me perime në të cilën kishte: 2 kg speca, 1 kg e 500 g karota dhe 2 kg domate.

Përgjigju:
-Sa ka peshuar qesja e gjyshes dhe sa peshon qesja e gjyshit?
-Cila qese kishte masë më të madhe?
- Çfarë mase do të kishte qesja e gjyshit nëse nuk do të blinin speca?
- Çfarë mase do të kishte qesja e gjyshes nëse në të do të kishte vetëm qershi dhe rrush?
- Sa është masa e të dyja qeseve së bashku?



2 Një grup nxënësish nga klasa e katërt u peshuan dhe i morën vlerat e mëposhtme:

Simja 36 kg e 500 g, Marta 28 kg, Agroni 30 kg e 300 g, Orhani 26 kg e 200 g, Vesna 27 kg.

Kush ka masë më të madhe se Orhani?	
Kush ka masë më të vogël se Marta?	
Sa është masa e përbashkët e Simes dhe Agronit?	
Sa është diferenca e masës së Martës me atë të Orhanit?	
Sa është masa e të gjithë nxënësve së bashku?	

TEMA 4

MATJA E LËNGJEVE

MASIM LËNGJET – LITRI

MASIM LËNGJET – DECILITRI DHE CENTILITRI

MASIM LËNGJET – MILILITRI

MASIM LËNGJET – ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE GJATË MATJES SË LËNGJEVE

MATJA E LËNGJEVE

MBAJ MEND

HAPËSIRA E ZËNË NGA LËNGU NË NJË ENË QUHET VËLLIM I LËNGUT.

Ne çdo ditë blejmë produkte si: benzinë, ujë, qumësht, lëng, naftë etj.
Kur i blejmë, sasinë e kërkuar e shprehim në litra.

MBAJ MEND

NJËSIA PËR MATJEN E VËLLIMIT TË LËNGUT ËSHTË NJË **LITËR.** SHKRUAJMË **1 l**.

MASIM LËNGJET – LITRI

A ka formë qumështi?
Po uji?
Shpjego pse.



Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Shkruaj emrat e disa produkteve që i blen dhe janë në paketim prej një litri.

_____

_____

2 Mbushi me ujë disa enë me vëllim një litër, por me forma të ndryshme.

a) përmbajnë të gjitha enët të njëjtën sasi uji? **PO** **JO**

b) A ndikon forma e enës në vëllimin e ujit? **PO** **JO**

MASIM LËNGJE – DECILITRI DHE CENTILITRI

Nëse duam të masim sasi më të vogla të lëngjeve, përdorim njësi matëse që janë më të vogla se litri.

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

MATJA E LËNGJEVE

MBAJ MEND

ATO JANË **DECILITRI** DHE **CENTILITRI** DHE SHKRUHEN SI:

1 dl – NJË **DECILITËR**
1 l = 10 dl

1 cl – NJË **CENTILITËR**
1 l = 100 cl



1 l = 100 cl

1 l = 1 dl 1 dl 1 dl 1 dl 1 dl 1 dl 1 dl 1 dl 1 dl 1 dl

1 Shkruaj shkurtesat:

a) 3 decilitra: _____ b) 20 centilitra: _____

c) 5 centilitra: _____ ç) 8 decilitra _____

2 Me shenjat e krahasimit <, =, > krahaso masat e lëngjeve:

4 l ◯ 9 l 1 l ◯ 5 cl 25 cl ◯ 2 l 10 dl ◯ 1 l

3 Shndërro njësitë e mëposhtme matëse për lëngje në litra, centilitra dhe decilitra:

10 dl = ◯ l 1 l = ◯ cl

50 dl = ◯ l 600 cl = ◯ l

MATJA E LËNGJEVE

MASIM LËNGJET – MILILITRI

MBAJ MEND

NJË LITËR PËRMBAN 1000 MILILITRA

1 l = 1000 ml

MBAJ MEND

500 ML = GJYSMË LITRI OSE SIÇ SHIHET ME NUMËR DHJETOR 0,5 LITRA.

PËR SHEMBULL: 1 LITËR E 500 MILILITRA MUND TË SHËNOHET SI 1,5 l



Le ta shohim enën për matjen e lëngjeve. Me numra janë shënuar njësitë matëse të vëllimit të lëngut që nuk i kemi mësuar më parë.

Ato tregojnë njësinë e matjes së lëngut në MILILITËR.
Shkruhet 1 m.

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Shndërro njësitë e mëposhtme matëse të lëngut në litra ose mililitra:

1000 ml = ◯ l 3000 ml = ◯ l

5 l = ◯ ml $\frac{1}{2}$ l = ◯ ml

2 Me shenjat e krahasimit <, =, > krahaso njësitë e lëngjeve:

400 ml ◯ 1 l 5 l ◯ 5000 ml

25 l ◯ 250 ml 100 ml ◯ 1 l

3 Shkruaj shkurtesat e vëllimeve, duke përdorur shënimin dhjetor me një shifër dhjetore:

a) 3 litra e 500 mililitra:_____ b) 500 mililitra:_____

c) 5 litra e 400 mililitra:_____ ç) 6 litra e 400 mililitra:_____

4 Shkruaj sa mililitra ujë ka në secilën nga enët:

_____ ml _____ ml _____ ml _____ ml _____ ml



_____ ml _____ ml _____ ml _____ ml

5 Lexo fjalitë dhe vendos shenjën "+" në kolonën përkatëse.

	e mundur	e pamundur	e sigurt
Vëllimi i lëngut në shishe është më i madh se vëllimi i shishes.			
Dy shishe prej një litri kanë të njëjtën formë.			
Nëse dy enë kanë të njëjtin vëllim dhe ena e parë është plot, do të jetë plot edhe tjetra nëse e zbrazim lëngun në të.			
Nëse në një kovë ka 3 litra ujë, ne e dimë edhe vëllimin e kovës.			
4 litra qumësht i nxë ena që ka vëllimin e 3.5 litrave.			

MATJA E LËNGJEVE

MASIM LËNGJET – ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE GJATË MATJES SË LËNGJEVE

1 Një shishe prej dy litrash e mbushim me një litër ujë.
Edhe sa ujë duhet që të mbushet e tërë shishja?

2 Hatixhja duhet të pijë 20 ml shurup dy herë në ditë. Shurupi është i paketuar në një shishe 240 ml. Për sa ditë Hatixhja do ta pijë tërë shurupin?



3 Xhaxhai Agim vitin e kaluar ka bërë 350 l lëng portokalli. Këtë vit ka bërë 120 l më pak se vitin e kaluar.
Sa litra lëng ka bërë xhaxhai Agim këtë vit?

4 Anda bleu 30 kanaçe me lëng, secila nga 250 ml. Sa litra lëng bleu Anda?

TEMA 4

KOHA

MASIM KOHËN – ORA, MINUTA DHE SEKONDA

MASIM KOHËN – DEKADA,SHEKULLI

MASIM KOHËN - ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE ME KOHËN.

NJEHSIMI I INTERVALEVE KOHORE

MASIM DHE LEXOJMË KOHËN – ORARI DHE KALENDARI

KOHA

MASIM KOHËN – ORA, MINUTA DHE SEKONDA

MBAJ MEND

ORA E MAT KOHËN.

KOHA GJATË SË CILËS AKREPI I VOGËL KALON NGA NJË NUMËR TE NUMRI TJETËR QUHET **ORË.**

LËVIZJA E AKREPIT TË MADH NGA NJËRA VIJË TE TJETRA NA TREGON **MINUTAT.**

AKREPI MË I HOLLË I NUMËRON **SEKONDAT.**

1 ORË = 60 MINUTA

1 MINUTË = 60 SEKONDA

Ndërkohë që Antoni i shkruan detyrat e shtëpisë kalon një kohë e caktuar.
Ndërkohë që Gjylsheni luan me shokët kalon një kohë e caktuar.

Koha kalon vazhdimisht ..

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Lidhni orët me kohën të cilën e tregojnë.



Është ora 5 e 15 minuta	5:15
Është ora 10 e 30 minuta	4:45
Është ora 8	8:00
15 minuta para orës 5	10:30

2 Ivana u kthye në shtëpi nga shkolla në orën 11:00, kurse i vëllai Marko u kthye në orën 13:30. Pas sa kohe Markoja erdhi në shtëpi nga shkolla?

MASIM KOHËN – DEKADA, SHEKULLI

Çfarë mund të masim me dekada? Po me shekuj? A i ke hasur këto njësi matëse për kohën dhe ku?

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

KOHA

MBAJ MEND

PERIUDHA KOHORE PREJ 10 VJETËSH QUHET DEKADË.

1 DEKADË = 10 VJET

MBAJ MEND

PERIUDHA KOHORE PREJ 100 VJETËSH QUHET SHEKULL

1 SHEKULL = 100 VJET

1 Shndërro vitet në dekada:

70 vjet = ____ 55 vjet = ____

95 vjet = ____ 90 vjet = ____

2 Babai i Burakut është 40 vjeç, kurse babai i Naumit e mbushi dekadën e katërt. Prindi i kujt ka më shumë vjet?

3 Shndërro:

a) **në vjet**
2 shekuj = _____
52 javë = _____
730 ditë = _____
48 muaj = _____

b) **në muaj**
3 vjet = _____
$\frac{1}{3}$ e vitit = _____
12 javë = _____
1 dekadë = _____

c) **në ditë**
98 orë = _____
3 javë = _____
12 orë = _____

ç) **në minuta**
3 orë = _____
480 sekonda = _____
$2\frac{1}{3}$ orë = _____

KOHA

MASIM KOHËN - ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE ME KOHËN INTERVALE KOHORE

Kur është ditëlindja jote?
Po ditëlindja e shokut tënd?
Cili prej jush është më i vogël dhe për sa?
Edhe sa muaj e ditë do të kalojnë deri në ditëlindjen tjetër?

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Bekimi e kishte ditëlindjen më 12 dhjetor, kurse Zehra është 35 ditë më e madhe se Bekimi. Kur është ditëlindja e Zehrës?

2 Vizatoni akrepat e secilës orë në mënyrë që ora ta tregojë kohën e dhënë. Pastaj shkruani me fjalë kohën e saktë nën secilën orë.

1 : 11

2 : 46

12 : 17

5 : 33

18 : 47

21 : 03

4 Marku dhe Davidi kanë ranë dakord që të takohen në orën 11:00 në park. Marku ka ardhur në orën 10:50, kurse Davidi ka arritur në orën 11:15. Sa minuta Marku e ka pritur Davidin? Paraqiteni kohën e mbërritjes së secilit prej tyre në një orë me akrepa.

Davidi

Marku

3 Admiri shkoi në stërvitje futbolli në orën 16:20. Trajnimi zgjati 65 minuta. Në ç'orë e përfundoi trajnimin Admiri?

KOHA

LLOGARITJA E INTERVALEVE KOHORE

1. Drini ka filluar të lexojë në orën 10:10. Ai ka lexuar pa ndërprerje - 57 minuta, kurse më pas vendosi të bëjë pushim. Në ç'orë Davidi e ka ndërprerë leximin?

2. Babai i Ilirit është nisur për në punë në orën 07:15. Ai kthehet nga puna në orën 17:05. Sa kohë babai i Ilirit nuk është në shtëpi?

3. Dreni ka dalë në kopsht me gjyshen e tij për t'i ndihmuar asaj të mbillte lule. Ata filluan të punojnë në orën 11:08. Ata kanë punuar 3 orë e 56 minuta. Në ç'orë kanë përfunduar me punën?

4. Merjemi donte të shkonte në teatër. Ajo u tha prindërve të saj se do të kthehet në shtëpi menjëherë pas shfaqjes. Ajo doli nga shtëpia në orën 17:30. Deri te teatri ajo eci në këmbë 20 minuta. Shfaqja filloi 10 minuta pas mbërritjes së saj dhe zgjati 45 minuta. Menjëherë pas shfaqjes, ajo u nis për në shtëpi me taksi dhe udhëtoi 8 minuta. Në ç'orë u kthye Merjemi në shtëpi?

1 Për pushimet verore koha e Pjetrit ishte tërësisht e zënë. Muajin korrik e kishte të mbushur me shumë aktivitete, kështu që ai donte t'i shënonte të gjitha këto aktivitete në kalendar. Më 1 korrik ai ka shkuar në Shkollën verore të matematikës në Ohër me Seksionin e matematikës të shkollës dhe ka qëndruar atje për 1 javë.
Pas mbarimit të shkollës, ai menjëherë ka shkuar në Manastir ku ka qëndruar 2 ditë te shoku i tij, Davidi. U kthye në shtëpi, ku më 12 korrik e festoi ditëlindjen. Pas tri ditësh, ai ka shkuar për pushime me prindërit e tij në Turqi, ku ka qëndruar10 ditë. Nga Turqia në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka udhëtuar me aeroplan dhe ka arritur në shtëpi në ditën njëjtë.

Shëno të gjitha aktivitetet e Pjetrit në kalendarin e muajit korrik. Në cilën datë Pjetri e ka përfunduar seksionin e matematikës dhe ka shkuar në Manastir? Në cilën ditë e ka festuar ditëlindjen? Cilën ditë është nisur për në Turqi? Kur ka arritur Pjetri në Maqedonin e Veriut?

KORRIK



E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E diel
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31



2 Ana u zgjua në orën 6:45.
Përgatitjet për në shkollë i zgjatën 35 minuta.
Pastaj u nis për në shkollë.
Deri në shkollë eci në këmbë 18 minuta. Ora e parë e matematikës filloi në orën 8:00. Zgjati 40 minuta.
Ata patën pushim prej 5 minutash, kurse më pas filloi ora e anglishtes, e cila gjithashtu, zgjati 40 minuta.
Pas mbarimit të orës së dytë pasoi pushimi i gjatë, i cili zgjati 20 minuta.
Pastaj filloi ora e arsimit fizik.

Ana mbaroi mësimin në orën 12:20 dhe u nis për në shtëpi. Plotësoni tabelën që vijon:

Aktivitete	Ora e fillimit të aktivitetit	Ora e përfundimit të aktivitetit	Kohëzgjatja e aktivitetit
Zgjimi			
Përgatitja për në shkollë			
Nisja për në shkollë			
Matematika			
Gjuha angleze			
Ora e arsimit fizik			
Mbarimi i mësimit			
Mbërritja në shtëpi			

TEMA 4

PERIMETRI DHE SYPRINA

MASIM PERIMETRIN E FORMAVE 2D

KUPTIMI I SYPRINËS - LLOGARISIM SYPRINËN ME RRJET KATROR

VARËSIA MIDIS PERIMETRIT DHE SYPRINËS

PERIMETRI DHE SYPRINA

MASIM PERIMETRIN E FORMAVE 2D

MBAJ MEND

PERIMETRI ËSHTË SHUMA E GJATËSIVE TË BRINJËVE TË SECILËS FORMË 2D.

Drita ka një litar dhe bën forma të ndryshme 2D.
Të gjitha format që Drita i bëri me litar kanë të njëjtin perimetër. Pse?

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Genci nga peri bëri një trekëndësh, brinjët e të cilit janë të gjata 5, 4 dhe 3 centimetra. Sa i gjatë është peri i Gencit?



O = 5 cm + 4 cm+ 3 cm
O = 12 cm
Peri i Gencit është 12 cm.

Ema e mori perin e Gencit dhe me të bëri një katror. Sa e gjatë është brinja e katrorit? Si e zbuloi ajo? Sqaro!

2 Vizato një drejtkëndësh me gjatësi 5.5 cm dhe gjerësi 2.5 cm. Llogarisni perimetrin e tij. Si e llogaritët atë?

3 Llogarisni perimetrin e secilës prej figurave në fotografi:



4 Dame e ndihmoi gjyshin e tij ta rrethonte vreshtin. Vreshti duhej të rrethohej me shtylla betoni dhe me tel. Vreshti kishte formë drejtkëndëshi me gjatësi 15 metra dhe gjerësi 12 metra. Sa metra tel nevojiten për ta rrethuar vreshtin? Sa shtylla betoni do të nevojiten nëse vendoset 1 shtyllë në çdo 6 metra?

5 Dritarja me formë katrore është e mbështjellë me shirit mbrojtës të gjatë 36 dm. Sa është e gjatë secila anë e dritares? Bëj një skicë.



KUPTIMI I SYPRINËS - LLOGARISIM SYPRINËN ME RRJET KATROR



Ngjyrosi format që zënë një sipërfaqe më të madhe.

Çdo formë 2D është pjesë e rrafshit. Pjesa që e kufizon formën në rrafsh është sipërfaqja e saj.

Sipërfaqen mund ta matim, kurse numrin matës të saj e quajmë syprinë.

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

1 Vizato një trekëndësh që ka sipërfaqe më të madhe se ai që është dhënë.

Ky është rrjet me katrorë. Secili prej katrorëve në rrjet ka brinjë me gjatësi prej 1 cm (ose 1 dm, 1 m...) dhe themi se zë një sipërfaqe prej 1 centimetër katror (ose 1 decimetër katror ose një metër katror).

MBAJ MEND

SIPËRFAQJA E KATRORIT ME NJË (1)BRINJË ËSHTË NJË NJËSI KATRORE.



Në rrjetin katror mund të vizatojmë forma 2D dhe të masm sipërfaqen e tyre duke i numëruar katrorët që përbëjnë formën.
Çdo formë 2D ka një sipërfaqe të shprehur në **njësi katrore**.

2 Secili katror në rrjetin katror ka brinjë të gjatë 1 cm.
Përgjigje:
Drejtkëndëshi i kuq ka sipërfaqe të barabartë me _____.
Sipërfaqe më të madhe ka forma e ngjyrosur me ngjyrë _____
dhe është _____ centimetra katrorë.
A ka forma 2D që kanë sipërfaqe të barabartë?





3 Në rrjetin katror vizato, sipas udhëzimeve, formën 2D dhe ngjyrose:
a) formën 2D të gjelbër me syprinë 7 njësi katrore;
b) formën 2D të kuqe me syprinë 8 njësi katrore;
c) formën 2D të kaltër me syprinë 12 njësi katrore;
ç) formën 2D të verdhë me syprinë 4 njësi katrore.

Në sa mënyra mund t'i vizatosh format e kërkuara? Krahaso vizatimet e tua me vizatimet e shokut tuaj/shoqes suaj.

4 Ngjyros një formë drejtkëndore 2D me syprinë 24 njësi katrore, në mënyrë që numri i katrorëve në rreshtat dhe kolonat e rrjetit katror të jetë një numër çift. Sa forma të tilla drejtkëndore mund të ngjyrosësh? Shoku/shoqja juaj le të ngjyrosë një formë drejtkëndore 2D me një syprinë 24 njësi katrore, në mënyrë që numri i katrorëve sipas rreshtit të jetë një numër çift, kurse sipas kolonës një numër tek.

Shkëmbeni mendime për zgjidhjen e detyrës.

PERIMETRI DHE SYPRINA

(Nxënësit e vërejnë ndryshimin midis perimetrit dhe syprinës.)
Të njëjtën gjë e përsëritin me më shumë katrorë dhe drejtkëndësha.
Hulumtojnë, llogarisin, argumentojnë dhe prezantojnë ide dhe përfundime.)

VARËSIA NDËRMJET PERIMETRIT DHE SYPRINËS

Aktivitet:

Secili nxënës ka nga 4 katrorë të njëjtë prej letre. Mësuesi kërkon që ata t'i vendosin mbi bankë në mënyra të ndryshme, ashtu që katrorët të puthiten plotësisht në njërën nga brinjët. Nxënësit formojnë forma të ndryshme 2D.

Sa do të jetë syprina e formave të fituara? Po perimetri i tyre a ndryshon?

Vlerësojmë dhe hulumtojmë

ZGJIDHIM PROBLEME ME PERIMETRIN E SYPRINËS

1. Njehso perimetrin e drejtkëndëshit që ka brinjët fqinje me gjatësi 32 mm dhe 7 cm.

2. Katrori ka brinjë 70 mm, kurse drejtkëndëshi ka brinjë me gjatësi 55 mm dhe 8 cm. Cila formë ka perimetër më të vogël? Sa cm është më i vogël?

3 Në secilën prej formave të dhëna në rrjetin katror njehso syprinën dhe perimetrin, duke pasur parasysh që secili katror i rrjetit katror ka syprinën 1 centimetër katror.



4 Njehso syprinën dhe perimetrin e figurave të mëposhtme. Përpiqu që me vizatime shtesë të fitosh më shumë drejtkëndësha në secilën prej figurave.





ÇFARË DHE SA MËSUAM?

1 Tregim i përmbysur:

Gjyshe Millka u nis të shkojë në treg 100 orë larg shtëpisë së saj. Prandaj ajo eci në këmbë. Me vete ajo mbante një çantë të madhe, e cila nxinte 15 metra. Ajo bleu në treg 2 kilogramë qumësht, 1 litër karota, 2.5 litra portokaj dhe 3.8 metra speca.
Detyrë: Shkruaje tregimin me masat e sakta dhe sipas zgjedhjes tënde, shto produkte për ta mbushur çantën e gjyshes Millka.

2 Tryeza me formë katrore ka perimetër 480 cm. Ne duhet ta mbulojmë atë me një copë pëlhure në formë katrore me përmasën prej 80 cm.
A do të arrijë copa e pëlhurës ta mbulojë të gjithë tryezën?

TEMA 5

PUNA ME TË DHËNA

1. MBLEDHJA, ORGANIZIMI, RREGULLIMI DHE PARAQITJA E TË DHËNAVE
2. PROBABILITETI I NGJARJES

PUNA ME TË DHËNA

MBLEDHJA, ORGANIZIMI, RREGULLIMI DHE PARAQITJA E TË DHËNAVE, PROBABILITETI I ZHVILLIMIT TË NJË NGJARJEJE

PËR TEMËN

Në këtë temë, do të mësosh të dallosh të dhënat primare nga ato sekondare; të zgjidhësh mënyrën e mbledhjes së të dhënave (anketa, intervista, vëzhgimi, eksperimenti, interneti, revista etj.); të dallosh dhe të paraqesësh të dhënat me vizatime dhe tabela të dendurisë; të përpunosh një plan për mbledhjen, organizimin, prezantimin dhe interpretimin e të dhënave me diagrame, grafikë, tabela të dendurisë, piktograme dhe diagrame me shtylla dhe ta realizosh këtë.

Do të mësosh të vlerësosh mundësinë e zhvillimit të një ngjarjeje gjatë realizimit të një eksperimenti gjatë përditshmërisë.



SFIDA TË MUNDSHME

Për nxënësit/et është e vështirë të vendosin se sa dhe cilat pyetje t'i parashtrojnë. Përpiquni të përdorni kontekste të jetës reale me të cilat nxënësit mund t'i lidhin pyetjet e tyre.

Në këtë temë, nxënësit/et trajtojnë të dhëna "diskrete", do të thotë, të dhënat që rezultojnë nga numërimi i objekteve ose ngjarjeve të veçanta, në mënyrë që një shtyllë, grafik ose piktogram të jetë paraqitja e saktë. Boshtet e grafikëve dhe diagrameve shpesh nuk emërtohen, duke sjellë informacione të gabueshme. Vizatimi i shtyllave gjithashtu, është një ushtrim sfidues. Shkallët janë një aktivitet tjetër sfidues për nxënësit. Ata mund të zgjedhin një shkallë të papërshtatshme ose të numërojnë (shënojnë numrat) gabimisht në boshtet në grafik. Nxitini ata t'i kontrollojnë me kujdes. Sa herë që është e mundur, rekomandohet që nxënësit të përdorin letër me rrjet katror për të vizatuar grafikët, për shqyrtim dhe prezantim më të mirë të rezultateve.

MATERIALET E NEVOJSHME DHE INSTRUMENTET MATËSE:

Materiale për mbledhjen e të dhënave, qasje në programet kompjuterike për vendosjen, përpunimin dhe prezantimin e rezultateve, materiale për eksperimente, letra, tabela flipchart, printer, projektor, kompjuter.

FJALOR i termave të reja

- Të dhëna
- Informacioni
- Plani
- Organizimi
- prezantimi dhe interpretimi i të dhënave
- Diagrami
- Grafiku
- Tabela e dendurisë
- Piktogrami
- Diagrami me shtylla
- Diagrami linear
- Probabilitet i zhvillimit të një ngjarjeje
- Gjithmonë
- Kurrë (asnjëherë)
- Ndoshta

TEMA 5

PUNA ME TË DHËNA

MBLEDHJA, ORGANIZIMI, PREZANTIMI DHE INTERPRETIMI I TË DHËNAVE

PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË PROJEKTIT, MBLEDHJA E TË DHËNAVE, PREZANTIMI DHE LEXIMI I TË DHËNAVE NGA DIAGRAMET DHE GRAFIKËT

LEXIMI I TË DHËNAVE NGA DIAGRAMI LINEAR

ASNJËHERË, GJITHMONË, NDOSHTA, KA GJASA

BËJMË EKSPERIMENTE DHE PARASHIKOJMË REZULTATE

MBLEDHJA, ORGANIZIMI, PREZANTIMI DHE INTERPRETIMI I TË DHËNAVE

PUNA ME TË DHËNA

Si mund të mbledhim të dhëna?
Për çfarë na duhen?
Në çfarë mënyre mund t'i prezantojmë ato?



Vlerësojmë dhe hulumtojmë

AKTIVITETI HYRËS:

Duhet të shkohet në ekskursion shkollor për një ditë.
Shkolla duhet të vendosë se ku do të shkohet dhe çfarë do të vizitohet.
Për këtë qëllim, përgatisni një **anketë**.

Çfarë pyetjesh do të parashtroni?

Për shembull:
Cili është vendi juaj i preferuar?
Çfarë mund të vizitohet atje?
Sa larg është nga vendbanimi juaj?

Parashtroni më shumë pyetje. Mendoni se si do t'i merrni përgjigjet e pyetjeve në lidhje me procesin e mëtejshëm të **organizimit**.

PUNA ME TË DHËNA

Ndahuni në grupe dhe diskutoni përgjigjet e këtyre pyetjeve.
Një nxënës/e i/e grupit do të përpilojë një tabelë dhe do t'i shkruajë përgjigjet e pyetjeve.

Pyetja e parë

– zgjedhja e destinacionit të vizitës

Pyetja e dytë

-të zgjedhen të paktën 3 vende për t'u vizituar nga vendet e ofruara. (hulumtohet në internet)

Tyetja e tretë

–të gjendet distanca e secilit vend (duke përdorur Google Maps).

– Zgjedhni një mënyrë për t'i prezantuar të dhënat e marra në tabelë, diagram me shtylla ose piktogram.
– Sqaro pse e zgjodhe këtë mënyrë të prezantimit.
–Cila formë e tabelës ose diagramit i paraqet më së miri të dhënat e mbledhura?
– Përfshini këto informacione: përzgjedhja më e popullarizuar, zgjedhja më pak e popullarizuar.
– Secili nga grupet le t'i prezantojë të dhënat e tij.
–Në bazë të informacioneve të marra nga anketa e realizuar, zgjedhni destinacionin dhe vendet që dëshironi t'i vizitoni.

Destinacioni	Vizë lidhëse	Gjithsej

1 Nxënësit e klasës së katërt, gjatë një dite feste kombëtare, kur nuk shkohet në shkollë, e kaluan ditën me aktivitete të lira. Të nesërmen ata mblodhën informacione se si e kaluan ditën e pushimit dhe i paraqitën të dhënat si më poshtë:



Shëno me ✓ se me cilat informacione të mëposhtme pajtohesh.

1. 10 nxënës shkuan në shëtitje në mal.
2. Më shumë nxënës ishin në park sesa në kopshtin zoologjik.
3. Dy nxënës më pak bënë stërvitje në terrene sportive sesa ata që ishin në pishinë.
4. Zgjedhja më pak popullore e nxënësve është vizita në kopshtin zoologjik.
5. Më shumë se gjysma e nxënësve të klasës ishin në pishinë.
6. Në klasë ka 40 nxënës.

Sqaro përgjigjet e tua.
Pastaj, të paktën ofro dy pohime në lidhje me të dhënat e prezantuara në **grafikun me shtylla.**

2 Janë paraqitur mënyra të ndryshme të prezantimit të të dhënave. Cilat janë ato? Gjeji dhe shkruaji ato.



Pema	Numri
Pjeshka	𝍸 |||
Boronica	𝍸
Molla	𝍸 |
Dredhëza	|||











3 Për shkak të vendosjes së pemëve si ushqim plotësues për nxënësit, mësuesja u tha nxënësve të saj të tregojnë se cila është pema e tyre e preferuar.
Rezultatet paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Portokaj	
Molla	
Dardha	
Luleshtrydhe	
Shega	

a) Cili është fruti më i preferuar mes nxënësve të klasës?

b) Cili është fruti më pak i preferuar midis nxënësve të klasës?

c) Prezanto të dhënat nga tabela në një grafik me shtylla.

ç) Përcaktoje numrin e nxënësve në klasë, nëse 3 nxënës nuk morën pjesë në prononcimet për shkak të mungesës.

4 Ada dhe Millani bënë hulumtim midis nxënësve për sportin e tyre të preferuar. Ata i treguan rezultatet me piktogram.

I. Sa nxënës gjithsej morën pjesë në kërkim?

a) 15 b) 45 c) 35

II. Hendbolli është sporti më i preferuar i:

a) 5 nxënësve b) 10 nxënësve c) 15 nxënësve

5 Nxënësit e një shkolle u pyetën se çfarë shikojnë më shumë në kanalet televizive. Rezultatet e anketës paraqiten në tabelë:

Filma	24
Sport	24
Filma vizatimor	40
Muzikë	24
Programe edukative	12

a) Çfarë shikojnë më shumë nxënësit në kanalet televizive?

b) Çfarë shikojnë më pak nxënësit në kanalet televizive?

c) Prezanto të dhënat e tabelës me piktogram.

Përdor simbolin ★ cme të cilin do të zëvendësosh 4 nxënës.

PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT TË PROJEKTIT, MBLEDHJA E TË DHËNAVE, PREZANTIMI DHE LEXIMI I TË DHËNAVE NGA DIAGRAMET DHE GRAFIKËT

Çfarë do të zbulosh?









PUNA ME TË DHËNA

Si është klima jonë në krahasim me klimën e vendeve të tjera?

_____

_____

_____

_____

Sa gjuhë të huaja flasin nxënësit e shkollës suaj në krahasim me shkollat e tjera?

_____

_____

_____

Si udhëtojnë nxënësit deri në shkollë?

_____

Si të sillemi më mirë ndaj natyrës?

_____

A është e përafërt koha e vrapimit e atleteve (femrave) me kohën e vrapimit të atletëve (meshkujve)?

_____

Në cilën disiplinë këto kohë janë më të përafërta?

_____

1 hapi

Planifikimi i hulumtimit

Përcaktimi i pyetjes – çfarë dua të zbuloj/kontrolloj/konfirmoj?

Çfarë dua të zbuloj?
Bëj një listë me ide: 1. 2. 3. . . .
Zgjedh një pyetje për të cilën je i/e interesuar dhe shënoje. Pyetje:

2 hapi

Hulumtoj, kërkoj dhe mbledh informacione dhe të dhëna

Burimi	Çfarë zbulova
1.	
2.	
3.	

Për nevojat e hulumtimit, krijo pyetësor me pyetjet e mëposhtme:

1.
2.
3.

Do t'i pyes grupet e mëposhtme të njerëzve:

Grupi	Numri i të anketuarve	Arsyeja pse anketohen
1.		
2.		
3.		

3 hapi

Rezultatet e hulumtimit do t'i prezantojmë në tabelën e mëposhtme të dendurisë.

4 hapi

Prezantimi i të dhënave – bëhet me ndihmën e grafikëve dhe diagrameve.
Piktogram – paraqitja figurative e të dhënave
Diagram rrethor - kur të dhënat paraqiten si pjesë e një tërësie.

Grafiku me shtylla - kur ekziston nevoja për të parë ndryshimin ndërmjet të dhënave
Të dhënat do t'i prezantoj me diagramin e mëposhtëm:

5 hapi

Prezantimi dhe interpretimi i rezultateve të marra.

Pyetjen që e parashtruam ishte:

Arsyeja pse e parashtruam ishte për të gjetur...

Hulumtimi tregoi se...

Anketa na konfirmoi (ose nuk na konfirmoi) se ...

PUNA ME TË DHËNA

Bëj një aktivitet kërkimor duke e ndjekur procedurën e përshkruar.

Në bazë të përfundimeve tona, mund t'i parashtrojmë pyetjet/ sfidat e mëposhtme:

1.
2.
3.

Arritëm në përfundimin se...

1 **Lexojmë të dhëna nga diagramet**

Ana kreu një anketë për ngjyrat e preferuara të nxënësve në klasën e 4-t. Rezultatet paraqiten në diagramet që vijojnë:









Në cilën klasë e pëlqejnë më pak ngjyrën e kaltër?

a) Klasa 1
b) Klasa 2
c) Klasa 3
ç) Klasa 4



2 Mësuesi Ilir, i pyeti nxënësit e tij se cila ishte lënda e tyre e preferuar. Ai paraqiti përgjigjet e marra në diagramin rrethor që vijon:



Për të dhënat e njëjtat, Ana pastaj vizatoi disa diagrame me shtylla. Cili nga diagramet e mëposhtme i paraqet të dhënat e njëjta si në diagramin rrethor?

A



B



C



D



3 Në diagram mund të lexohet numri i nxënësve për çdo klasë në një shkollë.



Në çdo klasë në shkollë ka vend për 30 nxënës. Sa nxënës të tjerë mund të mësojnë në atë shkollë?

a) 20 b) 25 c) 30 ç) 35

4 Në grafik paraqitet numri i lapsave me ngjyrë të kaltër, të kuqe dhe të zezë të nxënësve në një klasë.



Për sa ka më shumë lapsa të kuq sesa lapsa të zinj?

a) 2 b) 4 c)6 ç) 8

SFIDA

Grafiku duhet të paraqesë pikët e Anës, Ivanit, Aliut dhe Merimës në detyrën me shkrim në matematikë. Ana mori më shumë pikë, pastaj ishte Aliu, Merima ishte e treta dhe Ivani mori më pak pikë. Por shtylla me pikët e Merimës është fshirë.
A mund ta vizatosh? Sa pikë mori Merima?



PUNA ME TË DHËNA

LEXIMI I TË DHËNAVE NGA DIAGRAMI LINEAR

Vlerësojm ë dhe përgjigjemi

Xhaxhi Petrit vozit kamion. Dita e tij e punës zakonisht zgjat 12 orë. Diagrami linear tregon ditën e tij të punës.



Shiko me kujdes! Përgjigju pyetjeve të mëposhtme:

1. Sa larg është xhaxhi Petriti nga shtëpia në orën 9?

2. Çfarë bën ai në periudhën nga ora 10 deri në orën 11?

3. Sa kilometra kaloi ai nga ora 11 deri në orën 12?

4. Sa orë nuk e nget kamionin?

5. Sa kilometra është larg shtëpisë në orën 13, 16 dhe 17 e 30 minuta?

6. Sa kilometra gjithsej udhëtoi xhaxhi Petriti me kamionin e tij atë ditë?

1 Regjistroni konsumin mesatar mujor të ujit të qytetarëve të një qyteti.





a) Në cilin muaj është konsumuar më shumë ujë?

b) Sa ishte konsumi mesatar i ujit në nëntor?

c) Sa u rrit konsumi i ujit në qershor në krahasim me majin?

ç) Sa herë ishte më i lartë konsumi i ujit në muajt e verës në krahasim me muajin nëntor?

2 Në diagramin linear paraqitentemperaturat e ajrit në Shkup gjatë 12 orëve.



Shiko me kujdes diagramin dhe përgjigju pyetjeve:

1. Sa është temperatura në orën 2 pasdite? Po në 17:30?

2. Anës i pëlqen të vrapojë në periudhën më të ftohtë të ditës. Çfarë do t'i rekomandosh sipas diagramit?

3. Petari dëshiron të bëjë ushtrime anës Vardarit në pjesën më të nxehtë të ditës. Cilat janë 4 orët më të mira për këtë?

4. Cila është temperatura që paraqitet më shpesh dhe sa gradë është ajo?

Parashtro disa pyetje të tjera që lidhen me diagramin. Gjej përgjigjet e pyetjeve të parashtruara.

ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE

PUNA ME TË DHËNA

1 hapi

Në një shkollë është e nevojshme që të rinovohet klasa e paraleles IV - 2. Nxënësit vendosën të ndihmojnë me llogaritjet dhe prokurimin e materialit të nevojshëm. Në dysheme do të vendoset parket i ri, në mure do të vendoset material izolues, kurse në tavan pllaka gjipsi. Çfarë bënë ata?

Hapi 1: Mbledhja e të dhënave dhe renditja e tyre Ata morën një metër dhe e matën gjatësinë dhe gjerësinë e dyshemesë dhe të mureve. Ata i shënuan të dhënat e matjes në një tabelë.

	dyshemeja	muri 1	muri 2	muri 3	muri 4	tavani	dera dhe dritarja
gjatësia	6 m	6 m	6 m	6 m	6 m	6 m	3 m
gjerësia	6 m	3 m	3 m	3 m	3 m	6 m	2 m
sipërfaqja							

Pastaj krijuan skicën e sipërfaqeve që i matën



Sipas të dhënave, si janë format 2D në skicën e klasës

2 hapi Llogaritjet

Parketi: P = 6 6=3m^2;
Pllaka gjipsi = parket (pse)

Materiali për izolim

1. mur:
2. mur:
3. mur:
4. mur:

Gjithsej:

dritare:
dera:

3 hapi Prezantimi dhe interpretimi i të dhënave

Të dhënat për materialin e kërkuar për rinovim, duke përfshirë materialin shtesë, janë prezantuar në diagramin me shtylla.



diagram me metra katrorë shtylla

4 hapi

(aktivitet shtesë) Llogaritja e shpenzimeve të përgjithshme të rinovimit. Çfarë do të bëni për t'i llogaritur këto shpenzime? Kërkoni informacione nga burime të ndryshme, hulumtoni.

Aktivitet i projektit:
Ndiqni rregullsinë e nxënësve në klasën tuaj. Në fund të muajit, jepni një përmbledhje me ndihmën e një tabele ose diagrami. Mblidhni informacione mbi temperaturën në vendbanimin tuaj në periudha të caktuara të ditës gjatë javës. Renditini dhe prezantoni të dhënat e temperaturës në vendin tuaj.
Për t'i prezantuar të dhënat, mund të përdorni disa vegla kompjuterike – Microsoft Excel, Calc, Stat Graf... Mundohu të mësosh të përdorësh ndonjërën prej tyre

TEMA 5

PROBABILITETI I NGJARJES

ASNJËHERË,
GJITHMONË ,
NDOSHTA, KA GJASA

BËJMË EKSPERIMENTE
DHE PARASHIKOJMË
REZULTATE

ASNJËHERË,GJITHMONË, NDOSHTA, KA GJASA

PROBABILITETI

1 Ilustrim i përmbysur

1. Shqyrtoni me kujdes ilustrimin. Çfarë vëreni?

2. A ka mundësi të ndodhë ajo që tregohet në ilustrim? Apo ndoshta është e pabesueshme?

3. Ku rriten palmat? A pritet që të ketë borë në degët e palmës?

4. Ndoshta mund të bëni një njeri bore pranë detit. A pajtoheni?

5. Si rriten pemët?

Procesi i shqyrtimit të një ilustrimi quhet vëzhgim. Vëzhgojmë zhvillimet e situatave në një kontekst të caktuar. A jetojnë shpezët nën ujë? Kjo është një ngjarje e pamundur. A shikon ndonjë ngjarje tjetër të pamundur? Përshkruaje.
Ngjarjet që nuk do të ndodhin kurrë në kontekstin e shqyrtuar më parë, quhen ngjarje të pamundura ose të pabesueshme.

2

Çfarë bën Ana? Përshkruaj. Nëse vëzhgojmë anën e monedhës së hedhur në sipërfaqen e tryezës, cilat ngjarje mund të ndodhin?

Çfarë nuk do të ndodhë kurrë? Çfa do të ndodhë gjithmonë?



Shkruani disa ngjarje që lidhen me rezultatin e hedhjes së një monedhe 1-denarëshe në një sipërfaqe të sheshtë:

– Një ngjarje që nuk do të ndodhë kurrë:

– Një ngjarje që mund të ndodhë:

– Një ngjarje që do të ndodhë gjithmonë:

3 Vëzhgoje aktivitetin e peshkatarit.
Çfarë po bën ai? Përshkruaj dy ngjarje: një që do të ndodhë gjithmonë dhe një që nuk do të ndodhë kurrë. Sqaro.

4 Tamara i shikonte trupat gjeometrikë kubin, piramidën dhe cilindrin e vendosur në tryezën e shkollës ngaanët e tyre të ndryshme (nga lart, nga poshtë, anash). Pastaj, ajo krijoi lidhje midis formave 3D dhe 2D.



Ku ka gabuar Tamara?

Çfarë nuk mund të lidhet kurrë, nëse vëzhgohen trupa gjeometrikë? Diskuto!

Lidhi format e sakta 2D me trupat gjeometrikë përkatës.

ENIGMA:

Toni qëndron përpara koshit të basketbollit i menduar. Pse?

Shkruani ngjarje që lidhen me atë që shihni në figurë. A do të ndodhin? Apo nuk do të ndodhin kurrë? Pse?



Sara mban një top në dorë dhe duhet ta lërë të rrokulliset nëpër rrugën e bërë.

Nga do të dalë topi?

Si arrite në këtë përfundim?

A jeni i sigurt për përgjigjen tuaj?





Në tri kuti ka topa. Ana nxjerr një top nga secila kuti. Diskutoni rezultatet e tërheqjes së topave nga secila prej kutive. Çfarë është e pamundur, çfarë është e sigurt dhe çfarë është e mundur të nxirret?

E pamundur _____

E sigurt _____

E mundur _____





☐ ☐ ☐

Duke i përdorur ngjyrat e njëjta nga aktiviteti i mëparshëm, shëno se cila prej ngjyrave është e mundur, e sigurt ose e pamundur për objektet e dhëna.

PROBABILITETI

BËJMË EKSPERIMENTE DHE PARASHIKOJMË REZULTATE

Planifikojmë, vlerësojmë, realizojmë, kontrollojmë dhe arrijmë në përfundime.

Aktiviteti 1: Hidhni një zar 10 herë. Shëno numrin e pikëve dhe plotëso tabelën pas eksperimentit.
A arrite të parashikosh ndonjë rezultat?
Sa "6" ju ranë? Çfarë "ra" më shumë?
Çfarë nuk "ra"?

Numri i pikëve	Numri i paraqitjeve
1	
2	
3	
4	
5	
6	



Çfarë shikon në figurë?

Për çfarë janë këto kube?

Çfarë bëni zakonisht me to?

Mundohu të rrokullisësh një kub/zar për të luajtur një herë dhe parashiko numrin e pikëve që merr. Ia dole mbanë? Provo përsëri.

Hedhja e një zari për të luajtur në një sipërfaqe të sheshtë është një eksperiment, kurse shfaqja e numrit të pikëve në faqen e sipërme të kubit është rezultat i këtij eksperimenti. Zakonisht themi "ra 1", "ra 2", ... "ra 6".

Mendo: a mund të ndodhë rezultati "ra 7"? Pse? Si do ta quajmë atë rezultat?

Aktiviteti 2: Vendosi letrat me shifra tek në një zarf dhe pa shikuar tërhiq një letër. Shiko se cila shifër është tërhequr dhe shkruaje. Të njëjtën gjë bëje me letrat me shifrat çift. Tërhiq një letër, shkruaje shifrën pranë së parës. Nga shifrat e tërhequra bëj një numër. Pranë secilës prej përgjigjeve, vendos gjithmonë, kurrë (asnjëherë), ndoshta... Shpjego zgjedhjen tënde



1	2	3
4	5	6
7	8	9

1. Numri i fituar është numër çift _____
2. Numri i fituar është numër tek _____
3. Numri i fituar ndahet me 5 _____
4. Numri i fituar është shkruar me shifra të njëjta _____
5. Numri i fituar është shkruar me shifra të ndryshm _____
6. Numri i e fituar është nga dhjetëshja e tretë _____

BËHU HULUMTUES

Krijo eksperimente të ndryshme. Realizoji ato. Diskuto për rezultatet e këtyre eksperimenteve. A mund të parashikohen ato paraprakisht? Shkruaj rezultatet e marra. Pastaj merr vendim që sigurisht do të të ndihmojë në procesin e mëtejshëm të hulumtimit.

SFIDA E PARASHIKIMIT:

Ana, Kirili, Tina, Kristijani dhe Nexhati trajnojnë sporte të ndryshme: gjimnastikë, futboll, basketboll, not dhe hendboll. Njëri prej tyre nuk fitoi ndonjë çmim në gjimnastikë dhe ai nuk është Kirili, por as Tina që trajnon futboll. Ana është basketbolliste e shkëlqyer, por ajo stërvitet dhe në një sport tjetër që luhet me top. Kristiani nuk është basketbollist dhe nuk ka fituar ndonjë çmim. Mendo dhe përgjigju se në cilin sport stërvitet secili prej fëmijëve.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

373.3.016:51(075.2)=18

MATEMATIKA për klasën e katërt / Tatjana Atanasova- Paçemska ... [и др.] ; [Ilustrese Anastasija Dimitrova ; përkthimi nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe Dalibor Sandev]. - Botimi II. - Shkup : Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë sëVeriut, 2023. - 354 стр. : илустр. ; 26 см

Превод на делото: Математика за четврто одделение. - Други автори:
Valdeta Alija, Violeta Popovska, Dobri Jovevski

ISBN 978-608-273-480-4

1. Atanasova- Paçemska, Tatjana [автор] 2. Alija, Valdeta [автор] 3.
Popovska, Violeta [автор] 4. Jovevski, Dobri [автор]

COBISS.MK-ID 61289989